



ZGJEDHJA E VLERAVE TË KURANIT

Të këqiat janë shfaqur në tokë e në det (bela, skamje,
katastrofa, humbje e bereqetit etj.),

Kështu që le ta shijojnë një pjesë të asaj që kanë
bërë, ndoshta tërhiqen (nga të këqijat).

(Kuran, 30:41)



**HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)**

Kur ne marrim parasysh urdhërat e Kuranit, na bëhet e qartë se cilat janë obligimet tona. Gjëja e parë më e rëndësishme për muslimanët është që të luftojnë në fushën intelektuale ashtu që vlerat e Kuranit e të Sunetit të triumfojnë ndaj mosbesimit. Shpëtimi i vetëm për të dobëtit, të pandihmët, të pastrehët dhe të varfërit është praktikimi i udhëzimeve të Kuranit, i cili i drejtohet gjithë njerëzimit. Sëkëndejmi, është detyrë e jona që të përhapim fjalën dhe të komunikojmë porosinë, dhe kjo është një komponentë vitale e adhurimit për të gjithë muslimanët.



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darwinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën.

Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



ZGJEDHJA E VLERAVE TË KURANIT



HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)



Për Autorin

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.



Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

PËR LEXUESIN

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfitur nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.


Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

	<i>Hyrje</i>	8
	<i>Pavendosmëria e njerëzve jobsimtarë</i>	12
	<i>Çka ndodh kur nuk ekziston frika nga Allahu ?</i>	24
	<i>Të jetuarit sipas Kuranit sjell drejtësinë e vërtetë</i>	38
	<i>Cila përvojë në jetën politike</i>	58
	<i>Ndikimi i pabesimit në ekonomi</i>	64
	<i>Vlerat e Religjionit na urdhërojnë që të mbrojmë ata që kanë nevojë dhe jetimët</i>	70
	<i>Degjenerimi moral në shoqëritë jobsimtare</i>	84
	<i>Vrasjet shkaktohen nga mosbesimi</i>	108
	<i>Luftërat nëpër botë</i>	114
	<i>"Zemërimi fanatik": Racizmi</i>	152
	<i>Mizoritë dhe çrregullimet në shoqëritë jobsimtare</i>	166
	<i>Konkluzione</i>	180
	<i>Ideja e Gabuar e Evolucionit</i>	184

Hyrje

*Ç'keni që nuk luftoni për
Zotin dhe për
(t'i shpëtuar) të paafitt:
burrat, gratë e fëmijët, të
cilët luten: “Zoti ynë!
nxirrna nga ky fshat
(Meka), banorët e të cilit
janë mizorë. Jepna nga
ana Jote shpëtim e
ndihmë!”?
(Surja Nisa': 75)*





Gjithandej globit, shumica e njerëzve janë në mesin e të shtypurve. Ata torturohen, theren, dhe jetojnë në varfëri të skajshme, janë të pastrehë, të detyruar të jetojnë të pambrojtur, dhe ballafaqohen me sëmundje, pa pasur ndonjë kujdes adekuat mjekësor. Ka edhe të tillë që nuk janë në gjendje të kenë as edhe një copë bukë. Ka të moshuar, që ballafaqohen me pakujdesi, braktisje ose mohim të kujdesit mjekësor. Pastaj, vijnë ata që përballen me diskriminim, dëbim nga shtëpitë dhe tokat e tyre, thjeshtë vetëm për shkak të përkatësisë së tyre etnike, gjuhës, racës ose fisit e madje ka edhe të atillë që përballen edhe me masakra. Fëmijë të pafajshëm, të pandihmë, të paushqyer, e të pambrojtur, detyrohen që të punojnë për pak para ose që të kërkojnë lëmoshë.

Një numër i madh i njerëzve jetojnë me frikë për jetën e tyre, shqetësohen për ekzistencën e tyre, ndërkohë që në botën e cila lulëzon mes varfërisë e shtypjes ka ekstravagancë, privilegje e pasuri të pafund. Ata që janë bekuar me “jetë të mirë” kalojnë afër të të pastrehëve, shohin këto pamje, dhe shikojnë në televizion skenat e atyre që janë me më pak fat se ata vetë. Nganjëherë për një moment të shkurtër ndjejnë keqardhje, por pastaj ndërrojnë kanalin, largohen nga imazhi, dhe për një kohë të shkurtër fshijnë tërësisht dhimbjen që u ngacmon vetëdijen.

Shumë nga ata që gëzojnë këtë dhuratë dhe komfor me të cilin janë bekuar, nuk mendojnë kurrë që të zgjerojnë përpjekjet e tyre për të shpëtuar ata me më pak fat. Ata besojnë se shpëtimi i këtyre njerëzve nuk varet nga ta, meqë ka shumë të tjerë që janë më të pasur e më të fuqishëm dhe në pozitë më të mirë për t'u ndihmuar atyre që kanë më pak fat.

Sidoqoftë, nuk mjafton vetëm prosperiteti dhe fuqia për të shpëtuar këta njerëz dhe për të bërë këtë botë vend të mirëqenies në të cilën do të mbizotëronin drejtësia, paqja, besueshmëria dhe mirëqenia. Pavarësisht ekzistimit të vendeve të zhvilluara anekënd botës, ka ende shumë vende, siç është Etiopia, ku njerzit për çdo ditë vdesin nga uria. Është e qartë se pasuria dhe fuqia e disa kombeve nuk është e mjaftueshme që në vetvehte të zgjidhë vuajtjet e thatësisë, varfërisë e të luftës civile.

Vetëm të qenit i ndërgjegjshëm mund të kanalizojë burimet dhe fuqinë drejt mirëqenies së të varfërve dhe të të dëshpëruarve. E vetmja mënyrë për të qenë i ndërgjegjshëm është të besuarit. Janë vetëm besimtarët ata që në mënyrë konstante jetojnë me ndërgjegjen e tyre.

Përfundimisht, ka një zgjidhje për padrejtësinë, kaosin, terrorin, masakrat, urinë, varfërinë dhe shtypjen në botë e ato janë: vlerat e Kuranit.

Kushtet e pafavorshme në rend të parë janë krijuar nga urrejtja, mëria, interesi vetjak, indiferenca dhe mizoritë, prandaj ato duhen zëvendësuar me dashuri, dhembshuri, mëshirë, zemërgjerësi, bujari, ndjeshmëri, tolerancë, dhe urëtsi. Tiparet e kësaj mëshire gjenden vetëm te ata që jetojnë krejtësisht sipas vlerave që na mëson Kurani fisnik, i cili është udhëzues i drejtpërdrejtë nga Krijuesi ynë. Në një ajet, Allahu (xh.sh.) i referon Kuranit veçorinë e udhëheqjes së njerëzimit nga errësira në dritë.

... **Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë. All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë. (Surja Ma'ida: 15-16)**

Në një ajet tjetër, Allahu thotë se, sikur e vërteta të bëhej sipas dëshirave njerëzore, çdo gjë do të ishte e zhytyr në korrupsion e konfuzion :

E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to. E megjithëse Ne atyre u sollëm (me këtë Kur'an) famën e tyre, ata u zbrapsën ndaj përkujtimit të vet. (Surja Muminun: 71)

Derisa e lexoni këtë fragment, miliona njerëz janë duke vuajtur, mërdhijnë, janë të uritur, ose përballen me dëbim nga atdheu i tyre. Për këtë arsye, njerëzit që kanë ndërgjegje duhet të mendojnë për këtë, dhe të veprojnë për të zgjidhur këto mundime, sikur ato të përjetoreshin nga vetë ata ose nga të dashurit e tyre. Ne duhet të veprojmë, si shpirtërisht ashtu edhe materialisht, për të lehtësuar vuajtjet dhe tiranitë. Në një ajet, Allahu urdhëron njerëzit e ndërgjegjshëm dhe besimtarët që të pranojnë këtë përgjegjësi:

Ç'keni që nuk luftoni për Zotin dhe për (t'i shpëtuar) të paafitit: burrat, gratë e fëmijët, të cilët luten: "Zoti ynë! nxirrna nga ky fshat (Meka), banorët e të cilit janë mizorë. Jepna nga ana Jote shpëtim e ndihmë!"? (Surja Nisa': 75)

Kur ne marrim parasysh urdhërat e Kuranit, na bëhet e qartë se cilat janë obligimet tona. Gjëja e parë më e rëndësishme për muslimanët është që të luftojnë në fushën intelektuale ashtu që vlerat e Kuranit e të Sunetit të triumfojnë ndaj mosbesimit. Shpëtimi i vetëm për të dobëtit, të pandihmët, të pastrehët dhe të varfërit është praktikimi i udhëzimeve të Kuranit, i cili i drejtohet gjithë njerëzimit. Sëkëndejmi, është detyrë e jona që të përhapim fjalën dhe të komunikojmë porosinë, dhe kjo është një komponentë vitale e adhurimit për të gjithë muslimanët.

Ata që nuk e ndjekin ndërgjegjen e vet, që janë indiferentë ndaj vuajtjeve të të tjerëve, ata që shpenzojnë pasurinë e tyre në gjëra të pavlera e të kota, ata që nuk tregojnë interesim për jetimët, ata që shikojnë ftohtë gruan, fëmijët ose pleqtë të cilët shtypen, dhe të cilët gëzohen vetëm kur ka imoralitet dhe shëmti në botë, sigurisht që do të japin llogari në jetën e përtejme:

A e sheh atë, që përgënjeshtrojnë përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër? Po, ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun. Dhe që nuk nxit për të ushqyer të varfërin. Pra, shkatërrim është për ata që fallen por të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm. Ata vetëm shtiren (sa për sy e faqe). Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua). (Surja al-Ma'un: 1-7)

Pavendosmëria e Njerëzve Jobesimtarë

*Lëri ata të hanë,
të dëfrehen dhe t'i
preokupojë shpresa (se do
të jetojnë shumë), e më
vonë do të kuptojnë.
(Surja Hixhr: 3)*





Në ditët tona, njerëzve seriozisht u mungon qëllimi në jetë. Pothuaj secili adapton një rrugë standarde të të jetuarit. Të ushqyerit e vetes, gjetja e një shtëpie për të banuar, krijimi i familjes, dhe posedimi i një vendi pune, janë vlerat e lëvduara të cilat çdokush i aspiron më së shumti. Në këtë mënyrë standardi i të jetuarit, qëllimi më i rëndësishëm në jetë, është të gjeturit e mënyrave për të jetuar më mirë dhe për të rritur fëmijtë.

Me qëllim të të kuptuarit më të mirë të pavendosmërisë dhe pakuptimshmërisë që përshkon jetërat e shoqërisë sonë, do të ishte e dobishme të shikojmë fushat e tjera të interesit, ndaras nga ato që u përmendën më lartë. Shumica e njerëzve kanë pikëpamje mjaft të kufizuara. Shpesh, rasti për të mos lëshuar pa e parë një Tv serial ose një film të njohur është ajo që i jep kuptim jetës së tyre. Për njerëzit e tillë, qëllimi më i mirë në jetë, nëse të tilla ka, do të mund të ishte anëtarësimi në ndonjë klub social.

Një grup tjetër i njerëzve është i preokupuar tërësisht me biznes. Tërë jetën e tyre, ata udhëtojnë nga zyra në shtëpi. Personi i cili e fillon karrierën e tij në moshën 20 vjeçare e bën të njëjtën punë për gati 40 vjet. Në ndërkohë, personi i tillë e gjen shpesh veten duke pritur ditët e premtë.

Ambicjet e personit të tillë janë që pa ndonjë problem të mbyllë tatimet mujore, të gjejë një rentë çdo muaj, dhe të sigurojë të ardhmen e fëmijëve të vet. Vështirë që ndonjë ngjarje kombëtare ose botërore ta eksitojë atë. Vetëm ajo që e prek biznesin e tij ka kuptim për të. Duke mos i peshuar kurrë ngjarjet, ai pranon me gatishtëri status quo-n. Ai ndjehet i shqetësuar vetëm kur çështje të caktuara sfidojnë biznesin e tij. Për të vënë në pah shqetësime e tija, ai deri në orët e hershme të mëngjesit merr pjesë në debate televizive ose biseda, duke mos arritur në ndonjë zgjidhje ose konkluzion të rëndësishëm. Të nesërmen, ai e fillon ditën e re, ashtu siç e kishte filluar edhe një ditë më herët.

Të rinjtë, gjithashtu, vuajnë nga pavendosmëria e njëjtë, dhe kanë mungesë të faktorëve esenciale që i japin kuptim jetës. Shumica e adoleshentëve madje as që e di se kush janë liderët e vendit të tyre, cilat janë vendimet politike që ata i marrin, ndikimin që e kanë këto vendime në mbrojtjen kombëtare, në ekonomi ose sistemin e arsimit apo të drejtësisë. Të pavëmendshëm plotësisht ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve të mëdha në botë, ata në mënyrë konstante shqetësohen lidhur me ngjarjet e parëndësishme e të kota. Kjo i lë ata të përjashtuar nga aftësitë për të konceptuar rëndësinë e shumë ngjarjeve të historisë botërore. Bisedat e tyre shpesh janë të kufizuara në lojrat e kompjuterit, bisedat përmes internetit, vardisjet, ngjarjet e vogla që ndodhin në shkollë, mashtrimet në ushtrimet shkollore, planet e fundjavës, veshjet ose lojërat e futbollit. Në anketat e revistave të cilat pyesin të rinjtë që të rendisin “qëllimet më të mëdha e të vlefshme për t’i ndjekur në jetë”, të qenit si ndonjë model i njohur ose të lozurit në kitarë, sikur ndonjë kitarist i ndonjë bendi të njohur, renditen ndër të parat.

Duke shkuar përpara, ata kurrë nuk mendojnë për të zgjeruar horizontet e tyre. Për shembull, ata madje as që mendojnë për të përmirësuar aftësitë e tyre retorike, thjeshtë sepse nuk e kanë asnjë ide të vetme për të biseduar me njerëz që kanë ndikim. Për më tepër, ata nuk lexojnë. Personi që ka një qëllim të caktuar ose pikëpamje botërore lexon për të pasuruar veten si dhe për të mësuar që t’i kundërvihet pikëpamjeve të ndryshme. Qëllimi i kësaj është të kuptuarit më mirë i ideologjive që mund të sfidojnë idetë vetjake dhe të identifikuarit e dobësive

individuale. Por, për personin pa ndonjë qëllim ose një botëkuptim për botën, ekzistimi i ideve të caktuara sigurisht që nuk do të ketë ndonjë kuptim. Për më tepër, këta njerëz as nuk njohin idetë aktuale dhe pikëpamjet e njerëzve të tjerë. Sot, në shumë shoqëri, njerëzit kanë një mungesë interesimi për të lexuar libra e gazeta, ndërkohë që ka një interesim të madh për tabloide, kolumne thashethënash në gazeta dhe programe televizive. Edhe pse shumica e njerëzve kanë mjaft kohë të lirë, ata priren ta kalojnë atë para televizioneve, duke shikuar seriale e programe të cilat nuk i shtojnë asgjë intelektit të tyre, dhe kjo është rezultat evident i të qenit pa ndonjë qëllim dhe i degjeneruar.

Mos pasja e një qëllimi në jetë dhe të qenit i pavëmendshëm ndaj sferave tjera të ekzistencës është kërcënim për njerëzimin. Sidoqoftë, para së gjithash, fakti që ndër njerëzit që pretendojnë një pozitë të veçantë në jetë, shumica mbrojnë pikëpamjet të cilave u mungojnë vlerat e vërteta dhe që janë të dëmshme për njerëzimin, paraqet kërcënim real. Kjo ndodh sepse liderët dhe mbrojtësit e ideve të rrezikshme gjejnë masat që janë plotësisht pa aftësi për të shquar rrezikun, dhe të cilët prandaj pranojnë çfarëdo supozimi pa ia nënshtruar atë shqyrtimit të pavarur.

Duke pasur parasysh këto rrethana, në orvatjet e tyre për të tërhequr përkrahës, anarkistët e terroristët, duke fshehur armiqësi të thella kundër vendit e kombit të tyre, nuk ndeshin asnjë rezistencë. Për shembull, në një kafiteri kolegji, ku, ata rrënjosin pikëpamjet e tyre në mënyrë shkatërruese, një adoleshent i ngeshëm sheh si nëpër mjegull përderisa të rinjtë rreth tij i ekzpozohen indoktrinimit. Ai kurrë nuk e kupton se së shpejti këta njerëz do të fillojnë të veprojnë nën kushtet e ndikimit të anarkizimit e terrorizmit dhe do të bëhen kriminelë të pamëshirshëm të cilët me gatishmëri mund të vënë duart në armë për t'i përdorur ato kundër policisë, ushtarëve dhe njerëzve të pafajshëm të vendit të tyre. Edhe nëse ai e kupton këtë kërcënim, ai mbetet indiferent ndaj rrezikut. Në çdo rast, ai vështirë që ka vetëdije ose ndjeshmëri të përgjegjësive që do ta çonte për të menaxhuar situatën me urti.

Në ajetin me të cilin Allahu i referohet pavendosmërisë së njerëzve kështu:

Lëri ata të hanë, të dëfrehen dhe t'i preokupojë shpresa (se do të jetojnë shumë), e më vonë do të kuptojnë. (Surja Hixhr: 3)

Një person i vëmendshëm vëzhgon se reagimet e shfaqura grupore ndaj çfarëdo lloj politike të re të adoptuar në universitete, shpesh dëshmojnë të jenë më shumë të dëmshme se sa të dobishme. Kjo është pasojë e pozicionit të grupit të caktuar, sepse grupi nuk mbron se çka është e drejtë e çka e keqe. Në anën tjetër, grupi tjetër, preferon të jetë i qetë dhe thjeshtë të injorojë këto ngjarje në vend që të thërrasë njerëzit në rrugën e drejtë, dhe t'i këshillojë ata që të mbajnë besnikërinë ndaj shtetit dhe të rrijnë larg rebelizmave. Ndërkohë, disa të tjerë shfaqen me keqdashje e armiqësi dhe duke marshuar me parrulla, gurë e shkopinj, demonstrojnë një lloj tjetër të shtypjes e tmerrit. Sidoqoftë, orvatjet e tyre janë pa dobi; ata nuk mbrojnë vlerat që i ka komunikuar Allahu, por demonstrojnë të gjitha llojet e sjelljeve që nuk përputhen me Kuran. Në një nga ajetet e Tij, Allahu përshkruan se orvatjet e jobesimtarëve në këtë botë janë të humbura:

Shembulli i veprave të atyre që nuk besuan është si hiri, të cilin me puih e shkapërderdh era në ndonjë ditë të stuhishme, e ata nuk mund të realizojnë asgjë nga veprat që kanë bërë, e ky është ai dështimi i madh. (Surja Ibrahim: 18)

Sigurisht se ekzistojnë rrugë që njerëzimi t'i shmanget një situatë të tillë: të siguarit se ata nuk do të bëhen persona të interesuar vetëm për të jetuar jetën e tyre dhe për të jetuar sa për të plotësuar nevojat e veta. Në këtë kuptim, këta njerëz duhet të inkurajohen që të bëhen individë qëllimi i të cilëve është të shërbyerit edhe i njerëzve të tjerë dhe marrja jo vetëm me problemet e tyre ose të vendit të tyre por gjithashtu, edhe me problemet e botës. Religjioni që Allahu e ka zgjedhur për njerëz dhe që e ka shpallur në Kuran tregon këtë qëllim bazë:

Përqëno vetëveten tënde sinqerisht në fe, i larguar prej çdo të kote, e feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) në natyrshmërinë e krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Surja Rum: 30)

Allahu, Krijuesi i njeriut, krijoi gjithashtu edhe religjionin që i shkon më së shumti përshtati atij dhe që siguron paqe e siguri maksimale për njeriun. Prandaj, asnjë filozofi ose ideologji e çfarëdolloji, përveç religjionit, nuk mund të ofrojë përsosmërinë dhe lumturinë që synojnë

njerëzit. Për këtë arsye, përkrahësve të ideve të gabuara duhet t'u thuhet pse janë në gabim dhe të tillëve duhet t'i ofrohen prova e udhëzime relevante me qëllim që t'i zëvendsojnë këto ide të gabuara me të vërteta.

Është esenciale që t'u tregojmë për Kuranin njerëzve që nuk kanë ndonjë qëllim dhe që rrijnë kot, si dhe atyre që verbërisht janë dhënë pas ideve të gabuara. Vetëm atëherë, ata do të shohin dhe do të kuptojnë se kjo botë është krijuar për një qëllim të caktuar. Në Kuran, Allahu na informon për qëllimin e Tij në krijimin e njeriut: **“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”** (Surja Dharijat: 56)

Të gjithë një ditë do të vdesin. Pastaj do të filloj jeta e vërtetë dhe e përrjetshme. Qëllimi i kësaj jete është të orvaturit për të qenë person të cilin Allahu e pëlqen dhe të cilin ai do ta pres në Parajsën e Tij. Sjellja, idealet, dhe besimet e çdo njeriu do ta përcaktojnë nëse ai do të kalojë tërë jetën e tij të përrjetshme në botën e përtejme në Ferr ose në Parajsë. Për këtë arsye, fakti që këta njerëz pa menduar kalojnë kohën në dembeli e punë të kota, duke ia kushtuar atyre jetën e sjelljet e tyre, thuhet jeta e tyre në tokë nuk ka asnjë kuptim, tregon se këta njerëz duhet që urgjentisht të lajmërohen dhe zgjohen nga pavëmendshmëria në të cilën jetojnë.

Duke qenë të vetëdijshëm se qëllimi ynë në jetë është që të fitojmë miratimin e Allahut, pëlqimin dhe Parajsën, ne nuk mund të jemi indiferentë ose të pandjeshëm ndaj cilësdo ngjarje që ndodh rreth nesh. Ne e dimë se çdo ngjarje është një rast për të fituar aprovimin e Allahut, dhe prandaj ne gjithmonë do të veprojmë në pajtim me këtë. Ne ndjejmë brejtje të ndërgjegjes sa herë që jemi dëshmitarë të padrejtësive ose shtypjes në rrethin ku jetojmë, ose në botë. Për shembull, ne ndjejmë përgjegjësi për secilin vogëlush pa shtëpi, që jeton në vështirësi, dhe që i duhet të kalojë jetën në rrugë në dimrin e ftohtë. Në pajtim me urdhërin e Allahut në ajetin, “Pra, mos e përul jetimin! Dhe as lypësin mos e përzë (pa ia vënë veshin).” (Surja Duha: 9-10), ne do t'i trajtojmë ata mirë. Ne do të përpiqemi që të gjejmë rrugë për t'i mbrojtur ata nga rrethanat e pafavorshme në të cilat ata jetojnë. Por, ne e dimë se këta fëmijë nuk mund të shpëtohen nga orvatjet tona ose të atyre pak njerëzve që sillen në pajtim me Kuranin. Për këtë arsye, ne do të luftojmë që vlerat e Kuranit e të Sunetit të përhapen ndër njerëz.

Egoizmi është shkaktuar nga pavendosmëria

Pavendosmëria i bën njerëzit dhe shoqëritë të njëlojtë, egoistë e indiferentë. Ata priren për t'i kushtuar vëmendje vetëm interesave të tyre dhe nuk reagojnë ose tregojnë interesim për ngjarjet që ndodhin rreth tyre. Personi, qëllimi unik i të cilit është të jetojë jetën e tij, ndër të gjitha ngjarjet që mund të ndodhin rreth tij, i vëren vetëm ato që kanë të bëjnë me jetën e tij dhe nuk brengoset për asgjë tjetër. Për shembull, në rast të plasjes së ndonjë lufte kombëtare në vendin me të cilin ai tregton, ai do të brengoset vetëm për paratë që do t'i humbasë. Ai kurrë nuk mendon për njerëzit që masakrohen, foshnjat që vriten dhunshëm dhe për jetën e frikshme e të rëndë në atë vend. Këto fotografi të dhimbshme nuk paraqiten kurrë në mendjen e tij. Duke ndjekur vetëm paratë, ai kurrë nuk mendon për të ndihmuar në një mënyrë ose ndonjë tjetër ata njerëz. Ky është, sidoqoftë, vetëm një nga shembujt e indiferencës të cilën shumica e njerëzve e konsiderojnë të arsyeshme, dhe e marrin si të garantuar.

Gati çdo ditë, gazetat dhe televizioni u kushtojnë hapësirë rrëfimeve nga çdo kënd i botës, nga vende të cilat i janë ekspozuar vuajtjeve e dhunës së padurueshme. Çrregullimet dhe mosbesimi, burim i të cilave është mos zbatimi i vlerave të Kuranit dhe Sunetit janë arsye për shumicën e këtyre përvojave të hidhura. Qoftë në Palestinë, Indonezi, Kosovë, Çeçeni, ose në ndonjë vend tjetër në botë, ju shihni imazhe të njerëzve si zvarriten nëpër tokë ose dëbohen para syve të fëmijëve të tyre. Ngjashëm, çdokush di për fëmijtë e vegjël që gjuajnë me dëshpërim gurë për të mbrojtur vetveten. Edhe pse shohin këto skena të tmerrshme, sidoqoftë, njerëzit shkojnë të flejnë dhe vazhdojnë të jetojnë jetën e tyre të zakonshme meqë personaliteti i tyre nuk është cënuar. Duke mos pasur

Përveç atyre që falen, të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre. Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë në një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp. Edhe ata që e besojnë bindshëm ditën e gjykimit. Edhe ata që i frikësohen dënimit nga Zoti i tyre. (Surja Ma'arixh: 22-27)

shprehinë për të menduar “me të madhe” dhe duke pasur mungesë të vlerave superiore dhe vetëdije, mizoritë e tilla nuk i vënë në lëvizje këta njerëz.

Të imagjinuarit e vetes në lëkurën e atyre që janë të shtypur me siguri do të tregonte se këta njerëz nuk kanë aspak ndërgjegje për gjëra të tilla të dhimbshme. Sikur një nga këta njerëz të ishte në ambientin ku vriten njerëz të pafajshëm, ku gratë e tyre, fëmijët, vëllezërit, dhe prindërit vuajnë nga uria dhe i janë nënshtruar mizorive... Çka sikur ai t'i ishte ekspozuar varfërisë së vrazhdë?... Çka sikur të mos kishte para dhe mjete për të siguruar trajtim mjekësor për fëmijët e tij të sëmurë?... Çka sikur të jetë dëbuar nga vendi i tij pa ndonjë arsye?... Alternativisht, çka do të mendonte ai njeri sikur të takonte dikë i cili nuk ka përjetuar tërë këto fatkeqësi dhe që thjeshtë brengoset për paratë që do të fitonte dhe i cili thjeshtë mendon: “A jam unë ai që duhet t'i shpëtojë tërë këta njerëz?” a nuk do të mendonte ai se ky person nuk ka ndërgjegje, dhe se ai është indiferent dhe jo human?

Sidoqoftë, nuk është esenciale, që të vuash shtypjen me qëllim që të bëhesh person me konsideratë dhe i ndërgjegjshëm. Mjafton të shohësh gjendjen e vështirë të njerëzve dhe të konsiderosh gjendjen e tyre sipas kuptimit të Kuranit. Kështu, sa më shumë që njerëzit largohen nga Kurani, aq më shumë ata tregojnë pandjeshmëri të ndërgjegjes. Allahu tregon sjelljen egoiste, të pandjeshme dhe brutale të njerëzve që u mungon religjioni si në vijim;

Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Pse kur e godit ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac. (Surja Ma'arixh: 19-21)

Në ajetin që vijon, Allahu përmend ekzistencën e njerëzve që nuk janë “egoistë” dhe të cilët janë të shqetësuar për nevojtarët ;

... Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë në një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp. Edhe ata që e besojnë bindshëm Ditën e Gjykimit. Edhe ata që i frikësohen dënimit nga Zoti i tyre. (Surja Ma'arixh: 22-27)

Siç thotë Allahu në ajetin e tij, njerëzit që i frikësohen Allahut e

pranojnë përgjegjësinë për njerëzit e varfër. Allahu na tregon se ka dy mënyra për njerëzit që jetojnë në këtë botë, njëra nga të cilat është e drejtë dhe tjetra e gabuar. Në ajet, ai shpall :

Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët. E ai nuk u hodh në përpjetëzen (rrugë e vështirë - qafmalit). E ç'gjë të mësoi ty se ç'është Akabe (rruga e vështirë)? Është lirimi i një skllavi, Ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria: Ndonjë jetimi që është i afërt, Ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria. E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë). Të tillët janë të zotët e anës së djathtë. Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona, ata janë të të majtës. Kundër tyre është zjarri i mbyllur. (Surja Balad: 10-20)

*Është lirimi i një skllavi,
Ose dhënia e ushqimit në
kohën kur mbretëron
uria: Ndonjë jetimi që
është i afërt, Ose ndonjë
të varfëri që e ka molisur
varfëria. E pastaj të bëhej
prej atyre që besuan, që
këshilluan njëri-tjetrin
për durim dhe që
këshilluan për mëshirë
(për ndihmë). (Surja
Balad: 13-17)*



Kruga e drejtë e treguar në ajetin e mësipërm është mjaft e qartë. Prandaj, është vështirë që një person i ndërgjegjshëm, i cili synon miratimin e mëshirën e Allahut dhe Parajsën, të jetë i pakonsideratë ndaj praktikave shtypëse në botë, ose ndaj njerëzve të varfër e nevojtarë, dhe të mos mendojë për të ardhmen e tyre.

Çdo njeri i ndërgjegjshëm duhet të kujtojë se sot, anarkia, shtypja dhe tirania që dominon në skaje të ndryshme të botës, është duke bërë që miliona njerëz të shkojnë drejt mjerimit e terrorit. Disa thonë, “ka njerëz të caktuar që mbahen përgjegjës për këtë mjerim, a mund të jem përgjegjës unë?”, por, sidoqoftë, këto nuk janë fjalë që do t’i thoshte një njeri i ndërgjegjshëm. Tekefundit, në jetën e përtejme, Allahu do të kërkojë nga të gjithë njerëzit e pajisur me shëndet e aftësi të të kuptuarit që të japin llogari për këta njerëz të varfër. Ata që promovojnë ideologjitë që përgatisin terren të përshtatshëm që dhuna e mizoria ndaj njerëzimit të lulëzojë, hyjnë- e pranuan apo jo- në një grup me shtypësit. E njëjta vlen edhe për ata që I shmangen konfrontimit të këtyre ideologjive. Mos

Kujtojeni se sot, shtypja, padrejtësia, tirania, dhe vuajtja e përhapur kudo në botë janë çështje për të cilat çdo person i ndërgjegjshëm duhet të kërkojë zgjedhje. Sidoqoftë, sipas të gjitha gjasave, personi që aprovon shtypjen do të injorojë të gjitha këto thirrje.



përkrahja e parimeve të religjionit, do të çojë, në mënyrë të pashmangshme, drejt një lloj shoqërie të krijuar nga njerëz të papërgjegjshëm e të pavëmendshëm të cilët pretendojnë se do të lirohen nga ajo pa i dhënë llogari askujt. Në të vërtetë, këta janë lloj i njerëzve të cilët, më shumë se çdokush tjetër, së pari i shikojnë interesat e veta dhe bëjnë plane për mbijetesën e tyre.

Në të vërtetë, në bazat e teorisë së evolucionit që “me sa duket” ofron mbështetje shkencore për filozofinë materialiste dhe materializmin, si baza të mosbesimit, qëndron aspirata për të formuar një model të papërgjegjshëm e të pavëmendshëm të njerëzve të deprivuar nga të gjitha vlerat spirituale. Njeriu i tillë e ndjen se nuk duhet t’i jap llogari askujt. Sipas teorisë së evolucionit, njeriu është një kafshë e përparuar që ka evoluar nga majmuni dhe që është krijuar rastësisht. Pikëpamja që i referohet njeriut si një krijesë aq primitive në asnjë mënyrë nuk udhëheq drejt sakrifikimit për të tjerët, drejt mbrojtjes së qenjes njerëzore që vuan, ose mëshirës e dhembshurisë për të. Për më tepër, sipas teorisë së evolucionit, jeta është një arenë ku vetëm më të fortët kanë të drejtë të jetojnë. Të varfërit dhe të dobët, në anën tjetër, janë të destinuar që të zhduken. Njerëzit nga e mbarë bota kanë pranuar këtë indoktrinim me vite të tëra, gjatë shkollimit, përmes televizioneve, gazetave e njerëzve rreth tyre. Mënyra e vetme për të eliminuar këtë indoktrinim dhe për të krijuar dashurinë, mëshirën, bashkëpunimin dhe solidaritetin ndërmjet njerëzve është të komunikuarit e vlerave të Kuranit e të Sunetit, si dhe të treguarit atyre për humbjet që do t’u sjell mosbesimi në këtë e atë botë. Kjo është një detyrë e rëndësishme për të gjithë besimtarët. Allahu u premtonte një fund të mirë atyre që pretendojnë një përgjegjësi të tillë të rëndësishme e të ndershme.

Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillë janë ata më të prishurit. (Surja an-Nur: 55)



Çka Ndodh Kur Nuk Ekziston Frika Nga Allahu?

*Jo, nuk është ashtu! Por
ju punoni edhe më zi, ju
nuk përfillnit bonjakun,
Nuk cytni njëri-tjetrin
për ta ushqyer të
varfërin, Dhe ju e hani
me të madhe trashëgimin
(padrejtë). Dhe pasurinë
e doni së tepërmi.
(Surja Fajr: 17-20)*





Mendoji dy njerëz. Njëri nga ata e di se do ta takojë Allahun dhe e di se çdo veprim i tij ka një kompensim. Tjetri, për dallim nga i pari, supozon se nuk do t'i jap llogari askujt. Sigurisht, ka një dallim të madh ndërmjet asaj se si sillen këta dy njerëz. Dikush, i zhveshur nga frika prej Allahut, ka gjasa të kryejë një ligësi e të injorojë të gjitha llojet e imoralitetit sa herë që ndjen se interesi i tij është në pikëpyetje. Dikush që, për shembull, me gatishmëri vret një qenje njerëzore pa ndonjë arsye të qartë ose vetëm për interes të botës, e bën këtë sepse nuk ka frikë nga Allahu. Sikur besimi i tij në Allah dhe në botën e përtejme të jetë i palëkundur, ai kurrë nuk do të marrë guxim që të bëjë diçka, për të cilën nuk do të mund të jap llogari në jetën e përtejme.

Në Kuran, rrëfimet për të bijtë e profetit Adem, paqja qoftë mbi të, janë dhënë si shembuj për të fituar vëmendjen tonë mbi dallimin e saktë ndërmjet personit që i frikësohet Allahut dhe atij që nuk i frikësohet:

Lexoju atyre (jehudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbanë, nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: "Unë do


të të mbys ty" (Kabili i tha Habilit). E ai (që iu pranua) tha: "All-llahu pranon vetëm prej të sinqertëve", Dhe, nëse ti e zgjatë te unë dorën tënde për të më mbytur, unë nuk e zgjas te ti dorën time për të mbytur; unë i frikësohem All-llahut, Zotit të botërave!" (Surja -Ma'ida: 27-28)

Ai që nuk i frikësohet Allahut guxon të vrasë vëllain e tij pa rrahur qerpikun, edhe pse vëllai i tij nuk ka asnjë faj, përderisa viktima, përkundër faktit se është i kërcënuar me vdekje, thotë se madje as nuk do të orvatet që të vrasë vëllain e tij. Kjo është pasojë e frikës së këtij personi nga Allahu. Kështu, kur individët e një shoqërie të kenë frikë nga Allahu, atëherë vrasja, shtypja, padrejtësia, të cilat Allahu nuk i miraton, do të përfundojnë.

Lakmia për botën gjithashtu llogaritet si shkak për mizoritë dhe imoralitetin e njeriut. Brenga kryesore për shumë njerëz është se mos varfërohen, ose se nuk do të kenë ndonjë garancë për të ardhmen e tyre. Këto shqetësime shpjegojnë esencialisht se pse mitoja, korrupsioni, vjedhja, dëshmia e rreme e prostitucioni janë bërë mënyrë e jetesës për shumë njerëz. Për disa që kanë besim në Allahun, sidoqoftë, miratimi i Allahut është mbi të gjitha gjërat e tjera. Personi i tillë i shmanget çdo gjëje që e bën atë të humbasë miratimin e Allahut. Në zemrën e tij, ai strehon vetëm frikën nga Allahu; as vdekja, as uria, e as vuajtja nuk mund ta devijojnë atë nga rruga e drejtë.

Rrjedhimisht, personi që ka frikë nga Allahu, nuk devijon kurrë nga Kurani, pa marrë parasysh rrethanat. Në mënyrë të njëjtë, ai është i besueshëm. Ai gjithmonë vepron me ndërgjegje. Duke pasur ndjenjën e thellë se Allahu i sheh e i dëgjon të gjitha, ai nuk synon të veprojë kundër ndërgjegjes së tij madje as kur është vetëm.

Mungesa e religjionit e nxit humbjen e ndërgjegjes. Për ta bërë këtë më të qartë, mendoni për dikë që nuk heziton të ikë nga vendi i ngjarjes, pasi ta ketë goditur dikë me makinë në rrugë. Ka indikacione të dukshme se ai person është i distancuar nga religjioni. Ky njeri, që pa kurrfarë ndërgjegje e lë një qenje njerëzore të vetëm në agoni në mes të rrugës, i cili, përndryshe do të kishte gjasa të mbijetonte, mendon se mund t'ju shmangët njerëzve duke ikur prej tyre. Sidoqoftë, ai kurrë nuk mendon se Allahu e rrethon atë, duke e parë e dëgjuar në çdo sekondë. Askush nuk



Të qenit i pandërgjegjshëm është ndër dëmet madhore ndër të cilat shpjegohet mungesa e frikës nga Allahu. Njerëzit e pandërgjegjshëm madje as që orvaten ti ndihmojnë njerëzit që vuajnë.

mund të ikë kurrë nga dhënja llogari dhe nga dita e dhënjes së llogarisë. Allahu do t'ia kthejë të gjithëve për të gjitha padrejtësitë, mizoritë, dhe veprat e pandërgjegjshme në ditën e dhënjes së llogarisë:

...Kush bën hile, ai në ditën e kijametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë, pastaj secilit njeri i jepet ajo që e ka fituar, duke mos iu bërë e padrejtë. A është i njëjtë ai që iu bind All-llahut dhe kërkoi kënaqësinë e Tij, si ai që tërhoqi kundër vetes hidhërim të madh nga All-llahu dhe e ardhmja e tij është xhehennemi, që është përfundim shumë i keq? (Surah Ali 'Imran: 161-162)

Kur njerëzit përkujtohen në ajetet e Allahut dhe udhëzohen për këtë të vërtetë të rëndësishme, veprat e këtilla të paskrupullta do të parandalohen.

Një shembull i njerëzve me qëndrim të paskrupullt, të distancuar nga religjioni, janë njerëzit të cilët ofrojnë kujdes mjekësor kinse janë mjekë, edhe pse nuk kanë asnjë shkollim përkatës. Megjithëse plotësisht injorantë në secilën fushë të mjekësisë, njerëzit e tillë me gatishmëri mashtrojnë pacientët dhe marrin guximin t'i mjekojnë ata, pa u merakosur për kërcënimet serioze që mund të paraqesin për shëndetin e tyre. Veprat e tilla të paskrupullta mund të përfundojnë madje edhe me vdekjen e pacientit. Duke injoruar plotësisht këto jopërparësi ata mendojnë vetëm për sigurimin e përfitimeve dhe fitimin e parave. Sidoqoftë, në një nga ajetet e Tij, Allahu i urdhëron besimtarët që të : "T'ua lthejnë besimin atyre ndaj të cilëve kanë obligim". (Surja Nisa': 58)

Ai që bën hile në ditën e kijametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë, pastaj secilit njeri i jepet ajo që e ka fituar, duke mos iu bërë e padrejtë. A është i njëjtë ai që iu bind All-llahut dhe kërkoi kënaqësinë e Tij, si ai që tërhoqi kundër vetes hidhërim të madh nga All-llahu dhe e ardhmja e tij është xhehennemi, që është përfundim shumë i keq? (Surja Al 'Imran: 161-162)



Ceremony of Blood

A firm that sold HIV-tainted products apologizes in a bid to resolve Japan's worst health scandal

By ANTHONY SPAETH

battle, and the pieces of that proposal fell

Time, 25 mars 1996

Profits above people: Counterfeit drugs

Fake Drugs

In your article about counterfeit medicine (WORLD AFFAIRS, Nov. 5), you seemed to be confusing two different situations. It is one thing to sell a drug that works but was developed by another company. Quite another is to sell an ineffective (or harmful) drug designed to be the first of its kind.

Newsweek,
17 dhjetor 1990

Fake doctor fooled patients, colleagues, officials for 17 years

By BILL KACZOR
Associated Press

MARIANNA -- Many patients and colleagues respected and admired Nelson Ramos, a kindly doctor who delivered hundreds of babies and performed surgery for more than a decade in this rural town.



Të mashtruar verbërisht nga ambicjet e tyre për përfitime materiale, disa njerëz ushtrojnë pushtet mbi shëndetin e njerëzve dhe kështu rrezikojnë jetën njerëzore. Këta janë saktësisht njerëzit që nuk frikësohen nga Allahu dhe prandaj nuk e konsiderojnë jetën njerëzore të vlefshme.

Shëndeti i personit, poashtu, është i çmuar. Prandaj, në pajtim me ajetin e lartëpërmendur, njerëzit duhet t'i shmangen praktikimit të profesionit për të cilin nuk janë të shkolluar, që të mos jenë në pozitë për të lënduar njerëzit e tjerë.

Në të gjitha rrugët e jetës, njeriu ka gjasa të ndeshë akte të paskrupullta, të kryera nga njerëz që nuk i frikësohen Allahut. Duke dështuar që të njohë afërsinë e Allahut dhe duke dështuar që të mendojë mbi këtë, njeriu me gatishmëri përgojon një njeri të ndershëm. Ndërkohë, ai mendon vetëm se si t'i bindë njerëzit për pafajësinë e tij dhe t'i bëjë ata që t'i besojnë fjalëve të tij. Personi i tillë është plotësisht i zbrazur nga të

kuptuarit se Allahu është dëshmitar i të gjitha gjërave, dhe se pa asnjë përjashtim, gjithçka do të paguhet në jetën e përtejme. Në këtë kuptim, fakti që të pafajshmit i nënshtrohen provave të hidhura, se ndjehen fatkeqë ose se janë dërguar në burg, nuk e shqetëson ndërgjegjen e tij. Allahu, në Kuran shpall dënimin që do ta marrë shpifësi, si në vijim:

Kush bën ndonjë gabim ose mëkat, e pastaj atë ia hudh një të pafajshmit, ai ngarkohet me një shpifje e me një mëkat të hapët. (Surja Nisa': 112)

S'ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t'i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që e barti pjesën e madhe (të shpifjes) i takon dënim i madh. (Surja Nur: 11)

Personi që nuk i frikësohet Allahut, nuk i respekton dhe nuk i vlerëson njerëzit e tjerë. Mungesa e kësaj frike shpjegon pse pronarët e shumë restoraneve nuk e zhvillojnë biznesin e tyre në higjienë ose pse shumica e të rinjve nuk i respektojnë më të vjetrit. Ngjashëm, duke mos pasur frikë nga llogaritë që do t'i jepen Allahut, njerëzit në dhomat e emergjencës vdesin për shkak të pakujdesit, kurse njerëzit e përbuzur e të varfër dhe miliona të tjerë të pafajshëm masakrohen nga dora e hekurt etj.

Në shoqëritë me pjesëtarë që frikësohen nga Allahu, asnjë nuk angazhohet në gjëra të këtilla, sepse ata janë të vetëdijshëm se çdo prapësi që kryen njeriu në këtë jetë, do ta takojë në botën tjetër. Me individë që kanë ndërgjegje të shëndoshë, një shoqëri është e caktuar për të gëzuar paqen dhe ndjenjën e drejtësisë. Shmangja e rreptë nga pangopësia, prostitucioni dhe format e tjera të imoralitetit, bashkë me të treguarit e vlerave si respekti, dhembshuria e mëshira, sigurojnë lidhje të pathyeshme familjare të cilat, pamohueshëm, janë esenciale për një shoqëri të fortë. Shoqëria gëzon baza të qëndrueshme kryesisht për shkakun se njerëzit shfaqin besnikëri ndaj njeri tjetrit.

Bërja e të mirave pa pritur kompenzim

Personi që i frikësohet Allahut është gjithashtu dikush që e dëgjon ndërgjegjen e vet dhe që gjithmonë vepron sipas Kuranit. Në Kuran,

Allahu urdhëron njerëzit që të angazhohen për punë të mira, që t'u ofrojnë njerëzve ndihmë dhe të orvaten t'u japin një jetë të mirë, pa prituri ndonjë shpërblim në këtë botë. Në ajetin **“Mos jep gjë me qëllim që të kesh më shumë”** (Surja Muddaththir: 6), Ndalesa pohon se njerëzit nuk duhet të kërkojnë fitim për shërbimet që i kryejnë për të fituar kënaqësinë e Allahut. Personi që zbaton urdhërat e Allahut dhe nuk prët asnjë përfitim në këtë botë e bën këtë për një qëllim të vetëm; që të fitojë miratimin e Allahut dhe që Ai ta pranojë atë si skllav që e meriton Parajsën.

Sidoqoftë, numri më i madh i të mirave që bëhen në ditët tona bazohet në përfitimin e shpërblimit që do të merret në këtë botë. Për shembull, një biznesmen që me të ashtuquajturin qëllim bamirësie ndërmerr përsipër ndërtimin e një shtëpie për të varfërit, qartazi nuk përfiton dobi materiale nga ndërmarrja e tillë. Por, e vërteta është ndryshe, me këtë ai kryesisht promovon emrin e tij, duke u paraqitur në faqet e para të gazetave e në programet televizive, gjë që e shndërron këtë bamirësi në një formë të publicitetit. Ndërkohë, meqë shpenzimet për këtë bamirësi hiqen nga taksat e tij, kompania e tij kursen para. Veç kësaj, shpesh puna e ngjashme humanitare është shumë larg të qenit në harmoni me nevojat e marrësve. Për shembull, një kamion i ngarkuar me ushqime që dërgohet në një provincë të goditur nga tërmeti ndodh të dështojë në plotësimin e nevojave, ose sepse tashmë malli është prishur ose sepse ai është në kontradiktë me nevojat aktuale të viktimave.

Qëndrimet e politikanëve do të shërbejnë që kjo çështje të qartësohet. Gjatë gjithë fushatave të tyre të gjata, politikanët në mënyrë retorike përsërisin parulla duke shprehur përkushtimin e thellë për t'i shërbyer vendit të tyre. Kur njëherë të mos emërohen ministra, duke lënë anash shoqërimin me partinë dhe “qëllimin” e vënë në agjendën e tyre, ata zbulojnë motivet themelore që kishin për t'u inkuadruar në politikë dhe shfaqin se vrapojnë për “zyrë” e status. Është e jashtëzakonshme se sa pak dobi i sjell komunitetit një mentalitet i tillë.

Shkurt, veprat e kota të sinqeritetit paraqesin shërbime të pafrytshme në jetën tjetër. Allahu e shpall këtë në ajetin vijues:

O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson Allahun dhe as botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk udhëzon popullin jobesimtar. (Surja Bekare: 264)

Në anën tjetër, përkrahja e sinqertë për të ndihmuar njerëzit dhe për të fituar pëlqimin e Allahut, është dëshmuar të jetë e dobishme e përfituese, siç shpallet në shumë ajete të Allahut. Si shpërblim për qëllimet e sinqerta, Allahu i udhëzon njerëzit drejt suksesit në të gjitha veprat në të cilat ata janë të involvuar dhe i siguron rezultate të begatshme për ndërmarjet e tyre. Kjo është treguar në ajete:

E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e All-llahut, i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fruta të dyfishtë. Po edhe nëse nuk i bie shi i madh, i bie një rigë (që i mjafton). All-llahu sheh atë që vepron. (Surja Bekare: 265)

Dikush që synon vetëm pëlqimin e Allahut, nuk e kufizon vetveten për t'u angazhuar në fusha të caktuara të veprimtarisë dhe për të bërë sakrificë. Në shoqërinë e larguar nga religjioni, njerëzit shpesh janë të prirur për të besuar në ekzistencën e ndonjë interesi të fshehur sa i përket sakrificës, gjë që është thjeshtë shpjegim i arsyeshëm se mosbesimi është i rrënjosur në njerëz. Në shoqëritë ku nuk ndiqet besimi në Allah, njerëzit e vënë interesin vetjak mbi të gjitha gjërat e tjera. Besimtarët, në anën tjetër, synojnë pëlqimin e Allahut dhe asgjë tjetër:

Ata janë që zbatojnë premtimet e tyre dhe i frikësohen një dite dëmi i së cilës ka përmasa të mëdha. Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimet) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë vështirë. Po All-llahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. (Insan 7-11)

Kapitujt vijues të këtij libri ofrojnë trajtim të gjerë të zgjedhjeve që

ofrohen nga ajetet e Allahut lidhur me problemet që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Kur lexoni këto zgjidhje, mbajeni në mend se vetëm të jetuarit sipas Kuranit do të krijojnë zgjidhje afatgjata për të gjitha problemet. Në ditët tona, adresimi i çështjes së të varfërve, ofrimi i kujdesit kualitativ për të moshuarit, rrënjosja e vlerave të mira të fëmijëve, çlirimi i të rinjve nga qëndrimet degjeneruese, ofrimi i ndihmës urgjente për vendet e goditura nga fatkeqësitë, hedhja e ideologjive mizore që janë përgjegjëse për arsyet e futjes së vendeve në luftë dhe për vrasjen e mijëra njerëzve të pafajshëm, konfrontimi i atyre që rebelohen kundër shtetit të tyre e shumë çështje të tjera shpesh dërgojnë në rrugë pa krye. Në këtë kuptim, vetëm pajtueshmëria me Kuranin, të vetmin udhëzues të ndriçuar që Allahu ia ka dhënë njerëzimit në epokën tonë, do të sigurojë zgjedhje unike për problemet e ndryshme që i ndeshim në jetë. Duke jetuar sipas parimeve të Allahut do të largojmë çdo lloj të lige nga toka. Nëse ndodh që situata të jetë e kundërt, njerëzit me qëllim i përkushtohen sistemit mizor. Në Kuran, Allahu tërheq vërejtjen për lëndimet që njerëzit i bëjnë vetvetes :

Për shkak të veprave (të këqia) të njerëzve, janë shapur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu tërhiqen (nga të këqijat). (Surja Rum: 41)

Zgjidhjet që paraqiten me urtësi

Të poseduarit e veçorisë së urtësisë, mendjehollësisë (fushëpamje e shquar, fuqia e të kuptuarit të esencës së gjërave), dhe zgjuarësisë janë esenciale në gjetjen e zgjidhjeve për problemet që ndotin tokën, dhe sjellin të mirë njerëzimit në të gjitha sferat e jetës. Përvetësimi i këtyre veçorive është i mundshëm vetëm duke ndjekur Kuranin. Në një ajet, Allahu thekson urtinë që i garanton besimi njeriut:

O ju që besuat, nëse keni frikë All-llahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju, do t'ua mbulojë të këqijat, do t'ua falë mëkatet. All-llahu është dhurues i madh. (Surja Anfal: 29)

Nganjëherë, njerëzit mund të ndjehen sikur janë nisur në kërkim të

Sot, mijëra fëmijë të pastrehë merren me drogë dhe janë të prirur për krime, një pasojë e thjeshtë kjo e ambientit të ndotur në të cilin janë lënë. Sipas të gjitha gjasave, këta fëmijë do të rriten në individë të hendikepuar socialë, të paaftë për të kryer çfarëdo shërbimi të dobishëm për shoqërinë në të cilën jetojnë.



zgjdhjeve për problemet që hasin. Sidoqoftë, ata dështojnë që të gjejnë konkluzionet e dëshiruara sepse nuk posedojnë zgjidhje dhe janë të pa intuitë, zgjuarësi e mendjehollësi, kualitete këto që janë të gjitha rezultat i besimit. Të zbrazur nga zelli i inspiruar nga besimi, kur vjen puna te shkalla e implementimit, vendimet e tyre shpesh përfundojnë me vonesa. Ndryshe, dështimi për të parë ose ikja nga detajet e rëndësishme, i bën ata të ballafaqohen me stagnacione në shkallë të ndryshme.

Për shembull, një problem i madh sot në tërë botën, të cilit nuk i është gjetur një zgjidhje finale, janë jetimët dhe fëmijët e pastrehë që janë lënë të jetojnë nëpër rrugë. Misionet e ndihmave dhe masat përmes të cilave adresohen shumë probleme lidhur me pastrehimin, veçanërisht ato të dizajnuara për të parandaluar shndërrimin e fëmijëve të pastrehë në

individë të prirur për krime ose të varur nga droga, shpesh dëshmohen si të dobëta, duke hedhur këta fëmijë në një spirale të jostrehimit, pastaj në rrugë dhe në shtëpi korrektuese ose duke i pjekur kushtet për vetvrasjen ose vdekjen e tyre nga kujdesi joadekuat. Sidoqoftë, situata do të ishte definitivisht tjetër, sikur këta fëmijë të merrnin trajnime të bazuara në Kuran dhe të shoqëruara me shërbime përkatëse. Duke ia pasur frikën Allahut, ata nuk do të priren drejt aktiviteteve kriminale. Përkundrazi, ata do të rriten duke u orvatur që të kryejnë shërbimet më të mira për komunitetin e tyre dhe njerëzit.

Të sëmurët që kërkojnë tretman të shtrenjtë gjithashtu e bëjnë më të qartë këtë pikë. Të pasurit, duke mos pasur probleme për të paguar faturat e tyre, zakonisht kanë mjete për të jetuar. Në anën tjetër, të varfërit, pa ndonjë mbulesë shëndetësore, lihen për të vdekur. Rrallë që kjo situatë e vë dikë në lëvizje, çka vërtetohet me faktin se askush nuk mendon për të inicuar farë masash.

Sërish, mungesa e frikës nga Allahu dhe pasojat e kësaj, mungesa e urtësisë, janë arsye për këtë indiferencë. Ata që dështojnë së diskriminuari ndërmjet së drejtës e së gabuarës dështojnë që të gjejnë një zgjidhje edhe për problemet që hasin. Mungesa e diskriminimit është një tipar i veçantë për jobesimtarët. Allahu e definon se si sillen këta njerëz:

Shembulli i (i thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë. (Surja Bekare: 171)

Në saje të meritës së urtësisë që posedojnë, njerëzit që jetojnë sipas Kuranit e Sunetit, kanë zotësi të zhvilluara mirë për gjetjen e zgjidhjeve, zhvillimin e burimeve dhe organizatës. Organizatat e drejtuara nga këta njerëz dhe nga kontributet e njerëzve bamirës mund të ndihmojnë shumë në krijimin e jetës për këta të pafat. Së pari, njerëzit mund të jenë vigjilentë për problemet ekzistuese dhe në saje të kësaj të këshillohen për zgjidhjet. Disa biznesmenë, fjala vjen, mund të ndërmarrin përsipër ndërtimin ose renovimin e strehës për fëmijët e pastrehë dhe edukimin e tyre. Kjo me të vërtetë kërkon një organizim të thjeshtë. Për shkak të këtyre zgjidhjeve



The Independent, 26 shtator 2000

Report reveals the 11,500 lives lost every year in Britain because of the health gap



Edhe pse të gjitha burimet e nevojshme janë në dispozicion, dështimi për të pasur një organizim të mirë dhe shpërndarje racionale të burimeve shpjegon kujdesin e kualitetit të varfër që shumë njerëz e kanë në spitale. Disa, për shkak të varfërisë, nuk kanë kurrfarë kujdesi mjekësor. Kapitulli "S'ka para, s'ka barëra", për ironi, shërben si një frazë e qëlluar lidhur me situatën.

praktike, në shoqëritë që jetojnë sipas Kuranit e Sunetit, ky problem do të pushonte së ekzistuari përgjithmonë. Fjala vjen, secila familje që ka mjete adekuate, mund të marrë përsipër kujdesin për një fëmijë të vetëm, për edukimin e tij ose të saj. Përmes zgjidhjeve të këtilla funksionale njerëzit e pajisur me vlera e urti të Kuranit mund t'ia dalin në krye me të gjitha llojet e problemeve. Ngjashëm, pacientët pa kujdes shëndetësor mund të identifikohen kurse shpenzimet e tyre të mjekimit mund të mbuloohen nga një fond i ndarë. Në çështje të këtilla, ajo që është esenciale është që burimet botërore të orientohen në zonat e duhura, në mënyrën më produktive, pa lejuar madje as ekstravagancën më të vogël. Allahu, në Kuran, kërkon këtë lloj sjellje nga njeriu.

Duke ndjekur ndërgjegjen e tyre dhe duke përdorur intelektin e tyre, njerëzit që i kanë ngjarjet nën kontroll, mund të identifikojnë shumë shpejt stagnacionet e nevojat, dhe në saje të kësaj mund të gjejnë zgjidhje. Shpesh njerëzit dështojnë që të lokalizojnë se ku ka dështuar sistemi ose thjeshtë bëhen sikur nuk i shohin këto gjëra. Edhe kur ndjejnë dhembje në ndërgjegjen e tyre, ata dështojnë që të dijnë se çfarë duhet bërë ose ndjehen shumë dembelë për të filluar misionin. Jo të gatshëm për të trazuar paqen e tyre, ata i shmangen kalimit të kohës dhe energjisë në çështje të tilla. Sidoqoftë, orvatjet e njerëzve të ndërgjegjshëm dhe të urtë që të organizojnë njerëzit sipas fuqisë e aftësive të tyre do të rezultojnë në zgjidhje të shpejta ndaj shumë problemeve të qëndrueshme. Inkurajimi i njerëzve për një qëllim të mirë është një tipar që lavdërohet shumë në Kuran:

Kush ofron ndihmë të mirë, do të ketë pjesë nga ajo, dhe kush ofron ndihmë të keqe do të ngarkohet me të. All-llahu është i plotfuqishëm ndaj çdo sendi. (Surja Nisa': 85)

Sjellja e kundërt përmendet si tipar i jobesimtarëve dhe definohet si e ligë:

Jo, nuk është ashtu! Por, ju punoni edhe më zi, ju nuk përfillnit bonjakun, Nuk cytni njëri-tjetrin për ta ushqyer të varfërin, Dhe ju e hani me të madhe trashëgimin (padrejtë). Dhe pasurinë e doni së tepërmi. (Surja Fexhr: 17-20)

Të Jetuarit Sipas Kuranit Sjell Drejtësinë e Vërtetë

*All-llahu urdhëron drejtësi,
bampirësi, ndihmë të afërmve,
ndalon imoralitetin, të
neveriturën dhe dhunën.
Ju këshillon ashtu, që të
merrni mësim.
(Surja Nahl: 90)*





Drejtësia është një ndër thelbësoret për mbajtjen e rendit social. Secili shtet përdor sistemin e vet individual të drejtësisë. Sidoqoftë, duke parë vështirësitë e vazhdueshme në sistemet bashkëkohore të drejtësisë, kërkimet për një model ideal nuk kanë përfunduar kurrë.

Ka një thelb të sistemit ideal të drejtësisë që aspirohet kudo në botë: e ky është krijimi i një mekanizmi gjyqësor në të cilin secili person është i shpërblyer tërësisht për veprat e tij pa qenë subjekt i çfarëdo diskriminimi të paragjykuar. Pavarësisht metodave të reja, qasjeve të ndryshme, dhe projekteve e zgjidhjeve të sajura për të arritur këtë model ideal, të ushtruarit e gjyqësisë mbetet ende një rrugë e vështirë për t'u ndërmarrë.

Prishja morale e shoqërisë është arsye për këto situata të pafavorshme. Prishja, një pasojë e thjeshtë e mos zbatimit të vlerave të urdhëruara nga Allahu, i sjell dëme shoqërive në të gjitha fushat e jetës.

Sërish, kjo prishje është arsye e mashtrimit, mitos, padrejtësisë dhe shumë të këqijave sociale. Jeta e përditshme gëlon nga shembuj të këtij lloji. Një situatë e hasur shpesh, fjala vjen, në biznes, është biznesmeni i cili mashtron partnerët e vet dhe i gënjen ata duke i përvetësuar paratë e tyre, shtëpitë e makinat. Ndërkohë, miqësia e gjatë dhe humbjet materiale e shpirtërore të palës që vuan nuk kanë ndonjë domethënje

për mashtruesin. Duke qenë të brengosur në rradhë të parë për interesat vetjake, vlerat sikurse miqësia, lidhjet familjare, spiritualiteti, kohezioni social dhe morali i mirë nuk kanë ndonjë domethënje për mashtruesin.

Të gjitha raportet që ky person i krijon me këdo qoftë do të jenë nën ndikimin e një shpjegimi të tillë, meqë ai dështon për të reflektuar se Allahu është i informuar për të gjitha ato që bën ai, dhe se ai do të përgjigjet për të gjitha veprat që bën. Ai kurrë nuk e mendon se mashtrimi është një fitim i padrejtë dhe një sjellje e padrejtë kontribuon për këtë shpjegim të shtrembër.

Shembulli në vijim do të kontribuojë për të kuptuar këtë më thjeshtë: personi që beson se mashtrimi është një krim i tmerrshëm, do t'i shmanget atij gjatë tërë jetës. Njëherësh, kur dikush mendon se mund të nxjerrë ndonjë përfitim personal, ai duhet të ofrojë dëshmitarë të rrejshëm kundër tjetrit ose duhet të shpifë për tjetrin për diçka për të cilën personi tjetër është krejtësisht i pafajshëm. Ndërkohë, ai mund të gjejë ngushëllim në disa shfajësime: se e kanë detyruar kushtet ose se përgjegjësitë ndaj familjes së vet e kanë përgatitur terrenin për një krim të tillë...pa marrë parasysh se cilat janë këto shfajësime, mbetet fakti se mashtrimi është i ligë nën çfarëdo rrethanash.

Këto motive të lartpërmendura paraqiten veçanërisht në kohët kur njerëzit e ndjejnë se në shënjestër janë interesat e tyre. Këto shpjegime poashtu janë të vërteta për vjedhësit, mashtruesit dhe shtypësit. Në shoqëritë e mbushura me njerëz me interesa vetjake, ekzistimi i padrejtësisë, konflikti i interesave dhe kaosi është i paevitueshëm.

Pa marrë parasysh, se cilat janë forcat imponuese, personi që jeton sipas Kuranit kurrë nuk do të ndalet e të kryejë këto vepra të liga dhe kurrë nuk do të paraqes qëndrime kontradiktore ndaj vlerave. Dikush që i frikësohet, Allahut nuk harron kurrë se një ditë ai do të takohet me çdo vepër të cilën e ka bërë dhe me secilën fjalë që e ka thënë. Padrejtësia, që është një rezultat i prishjes morale siç është ndjekja vetëm e interesit vetjak, krijimi rezervë i pronave, injorimi i atyre që kanë nevojë dhe i atyre në vështirësi, ka një zgjidhje unike: përhapjen e vlerave të Kuranit ndër njerëz. Kjo sepse në Kuran, Allahu urdhëron robërit e Tij që besojnë e jetojnë sipas këtyre vlerave superiore që të jenë:

O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmuar të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose

kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, All-llahu plotësisht di ç'ka punoni. (Surja Nisa': 135)

All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim. (Surja Nahl: 90)

Në shoqëritë ku njerëzit kanë një mirëkuptim për drejtësinë, ashtu siç është shpjeguar në ajetin e lartëpërmendur, padrejtësia nuk mbizotëron. Kjo ndodh sepse në vendin ku zbatohen vlerat e Kuranit e të Sunetit, ushtrimi i rreptë i drejtësisë është thelbësor. Në praktikimin e kësaj drejtësie, lidhjet familjare të ndokujt, pasuria, statusi ose faktorët e tjerë nuk lejojnë përjashtime. Pavarësisht nga kjo, zbatimi aktual i sistemeve të drejtësisë përreth globit është më se i ndryshëm. Në disa raste, duke marrë në konsideratë pasurinë e dikujt, statusin ose rrethanat sociale, krimet e tij thjeshtë injorohen ose dënimet janë më të lehta. Kjo nuk ka gjasa të ndodhë në shoqëritë ku mbizotëron drejtësia reale. Faktorët siç janë lidhjet familjare, pasuria ose statusi kurrë nuk janë arsye për t'u larguar nga drejtësia.



Mashtrimi, korrupsioni dhe hajnia mund të bëhen mënyrë e të jetuarit për një person i cili nuk jeton sipas Kuranit dhe ai mund të mos ndiejë brejtje të ndërgjegjes kur angazhohet në vepra të liga.



Time, 22 qershor 1998



Time, 7 dhjetor 1998

Çfarë probleme paraqiten në shoqëritë ku nuk ushtrohet drejtësia e vërtetë?

1. Dëshmia e rreme shtohet

Në zbulimin e së vërtetës dhe krijimin e drejtësisë, dëshmitarët kanë rolin kryesor. Në bazë të dëshmive të dëshmitarëve okularë, shumë raste mund të ndriçohen shpejt dhe kështu shquhen e vërteta dhe e pavërteta. Sidoqoftë, në shoqëritë në të cilat vlerat e Kuranit e të Sunetit nuk zbatohen, të gjeturit e të vërtetës përmes dëshmitarëve është larg për t'u besuar. Kjo ndodh thjeshtë sepse njerëzit që nuk mbështeten në Kuran e Sunet mund të gënjejnë pothuaj me lehtësinë me të cilën njerëzit marrin frymë, saherë që për këtë ata do të marrin para ose do të përfitojnë në ndonjë mënyrë. Derisa e bëjnë këtë, ata i kthejnë shpinën të gjitha sjelljeve virtuozë siç është thënja e së vërtetës ose të angazhuarit për të pafajshmit.

Madje, në disa raste, njerëzit përmbahen nga të dëshmuarit për ndonjë rast të caktuar, pa marrë parasysh se sa e rëndësishme mund të jetë kjo për të pasqyruar drejtësinë. Zakonisht me qëndrime të tilla kanë të bëjnë disa mendime joreale, siç është frika e futjes në telashe ose në ndonjë situatë të pafavorshme. Në një ajet, Allahu thekson rëndësinë e zbulimit të së vërtetës:

... Mos e fshehni dëshminë, sepse ai që e fsheh atë është mëkatar me zemrën e vet, All-llahu di atë që veproni. (Surja Bekare: 283)

Mëria dhe inati që ndjehen ndaj dikujt mund të jenë arsye që i josh njerëzit për të fabrikuar dëshmitë. Përmes dëshmisë së rrejshme dhe duke shtrembëruar faktet, ata vonojnë drejtësinë. Rëndësia e së vërtetës është shpjeguar poashtu në hadithin e Të Dërguarit të Allahut, profetit Muhamet (paqja e Zotit qoftë mbi të):

Mbështetuni në të vërtetën, sepse ajo udhëzon në vepra të mira dhe veprat e mira e dërgojnë atë që i bën ato, në Parajsë. Nëse njeriu vazhdon ta flasë të vërtetën dhe e bën të vërtetën të jetë qëllim i tij, ai do të shënohet në prezencën e Allahut si i sinqertë i lartë. Shmangjuni pavërtetësisë, sepse pavërtetësia udhëzon në ligësi e ligësia udhëzon në Ferr. Nëse njeriu vazhdon të flasë të pavërteta dhe e bën pavërtetësinë e tij qëllim, ai do të shënohet në prani të Allahut si gënjeshtar i madh.¹

Njerëzit që nuk jetojnë sipas vlerave të Kuranit e të Sunetit nuk e

zbatojnë drejtësinë, veçanërisht kur i japin përparësi interesave dhe dëshirave të tyre personale. Ata kurrë nuk marrin në konsideratë pasojat e dëshmisë së tyre të rrejshme. Atyre kurrë nuk u ndodh ajo nëpër të cilën kalon njeriu i pafajshëm e i dënuar gabimisht, gjatë kohëzgjatjes së burgimit, e as vuajtjet e familjes së tij. Ata nuk e vënë veten në lëkurën e tjetrit dhe nuk imagjinojnë se çfarë do të ishte jeta atëherë...

Në Kuran, Allahu i jep një konsideratë të veçantë kësaj situatë të cilën e provojnë njerëzit, dhe ai na urdhëron të jemi të drejtë, pa marrë parasysh se cilat janë rrethanat:

O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hirë të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Keni droje All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni. (Surja Ma'ida: 8)

Për t'ju shmangur padrejtësisë, i dërguari I Allahut, profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) thotë gjithashtu: *"Asnjë nga ju nuk duhet të gjykojë ndërmjet dy personave kur ai është i hidhëruar."*²

Të nxitur nga frika, paraja, ose lakmia, disa njerëz devijojnë nga ajo që është e drejtë dhe korrekte. Vetëm të mësuarit e vlerave të Kuranit do t'i bëjë ata të lirë. Nën çfarëdo rrethane, qoftë nën kërcënim ose detyrim, ose në prezencë të çfarëdo përfitimi për ta, ata kurrë nuk priren për dinakëri, sepse janë të vetëdijshëm se Allahu i rrethon gjithmonë. Besimtarët janë të vetëdijshëm se, në botën e përtejme, ata do të japin llogari për secilin veprim të gabuar që bëjnë ose gjëra të liga që thonë. Në një ajet, Allahu shpall se robërit e të Gjithëmëshirshmit nuk sjellin dëshmi të rrejshme :

(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet. (Surja Furkan: 72)

Meriton vëmendje edhe një pikë që ka të bëjë me ata që ndjekin interesin e vet para se të zbatojnë drejtësinë: se atë ditë e njëjta ligësi mund t'i gjejë ata vetë. Nëse kjo ndodh, padrejtësia sigurisht që do t'i shqetësojë ata shumë dhe ata do të kërkojnë një dëshmitar të qëndrueshëm i cili nuk do të fabrikojë dëshminë. Pra, ata që nuk duan të

provojnë këtë duhet të përpiqen për përhapjen e vlerave që urdhëron Allahu dhe të përkrahin saktësisht parimet morale të lëvduara në Kurani.

2. Kriteri për gjykimin e nejrëzve shndërrohet në para e grada

Paraja dhe statusi shërbejnë si kriter kryesor për të vlerësuar njerëzit në shoqëritë ku vlerat e Kuranit e të Sunetit nuk janë përkrahur. Në këto shoqëri, të gjitha shtresat janë ngopur me këtë mentalitet, duke na dhënë kështu me bollëk shembuj për të analizuar.

Qëndrimet e supozuara të një dyqanxhiu ndaj dy konsumatorëve të ndryshëm ofrojnë informata të mrekullueshme lidhur me këtë çështje. Dyqanxhiu pretendon një qasje të kujdesshme e të vëmendshme ndaj atij që, sipas pamjes së jashtme, supozon se është i kamur. Në anën tjetër konsumatori tjetër, që duket më i varfër, nuk trajtohet mirë nga dyqanxhiu. Kjo qasje nuk ndryshon edhe pse të dy konsumatorët vizitojnë dyqanin për të blerë gjërat e njëjta dhe shpenzojnë shumën e njëjtë të parave. Paraqitja ose statusi përcaktojnë mënyrën se si dyqanxhiu trajton konsumatorët.

Këto kritere nuk janë të vërteta për dikë që jeton sipas Kuranit. Besimtari sillet mirë ndaj qenjes tjetër njerëzore vetëm sepse ai është "qenje njerëzore". Ai nuk i dallon njerëzit rreth tij sipas diskriminimit të paragjykuar të asnjë lloji. Për të vlerësuar dikë, atij nuk i duhet "etiketë". Pa marrë parasysh se a është njeriu i pasur ose i varfër, a jeton në kasollë ose në pallat, atij nuk i intereson. Rrobat e shtrenjta të dikujt, fytyra e bukur, diploma e ndonjë universiteti me prestigj, mirëqenja sociale, ose statusi i ngjashëm nuk kanë asnjë kuptim për të. Allahu, në Kuran, përmend besimin e njeriut ndaj Allahut dhe afrinë ndaj Tij si kriter të vetëm për ta përdorur në dashurinë ndaj njerëzve.

3. Pengesat në arsimim

Secili individ ka të drejtë që të ketë qasje në arsimim. Pa marrë parasysh religionin, gjuhën, racën ose statusin, çdo individ ka të drejtë të përpiqet për njohuri. Sidoqoftë, padrejtësia sociale, praktikisht e bën këtë të pamundshme, duke ngritur shumë probleme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, në rradhë të parë pamundësinë për arsimim të lirë të çdo

anëtarë të shoqërisë. Për shkak të varfërisë, në shumë vende, një numër i madh i fëmijëve e adoleshentëve janë të deprivuar nga arsimimi kualitativ. Qasja në shkollat kualitative është e rezervuar për një pakicë të privilegjuar. Vështirë që njerëzit e zakonshëm të marrin shkollim i cili u adresohet nevojave të tyre arsimore. Në këtë kontekst, të pasurit marrin edukim më të mirë, përdersia të varfërit thjeshtë marrin atë që ua ofron sistemi.

Zhvillimi i fëmijëve mund të gëzojë mbështetje nga laboratorët dhe mjetet tjera të shumta që ofrohen nga shkollat që pranojnë mbështetje materiale adekuatë. Burimet e kufizuara të disa shkollave, në anën tjetër, pengojnë individët e rinj në mënyra të ndryshme.


Children in poorest areas have little chance of winning a place

By Aileen Abo

YOUNG PEOPLE in some of Britain's poorest districts have no chance of going to university, an official from the funding authority said yesterday.

Staff from the agency that distributes money to universities compared young people's family income with their prospects of a university place. The comparison was based on an analysis of the average income of the neighbourhoods where pupils' families live.

Rahman Bekhradnia, the director of policy at the Higher Education Funding Council,



is, whether they get to the best schools and in society's attitudes towards them.

Stratford-upon-Avon, 15 per cent of young people studied in King's College London, most went on to college which includes world-class facilities. It is less than 10 per cent of young people who studied in the poorest areas of the country.

The Independent, 6 tetor 2000

Arsimimi është çështje madhore në tërë botën.

Shortage of teachers 'worst for a decade'

By Nicky Matthews

Education Correspondent

LOCAL AUTHORITIES are warning emergency schools for the first time in 10 years because of a shortage of teachers.

Local authorities say they cannot afford to pay the salaries of teachers who have left the profession.



David Brown, Director of the National Association of Head Teachers.

Emergency schools are those where the school is unable to recruit enough teachers to fill all the classes.

David Brown, Director of the National Association of Head Teachers, said: "The shortage of teachers is the worst for a decade."

He said: "The shortage of teachers is the worst for a decade."

The Independent, 4 shtator 2000



Second-Class Kids

Romans in the Czech Republic go to court alleging bias against them in the school system

ROMAN CHILDREN in the Czech Republic are starting school as 'second class' kids, the court has ruled. The court said the children were not given the same quality of education as other children.

The court said the children were not given the same quality of education as other children.

Time, 10 korrik 2000

School a Rare Luxury for Rural Chinese Girls



The New York Times, 1 nëntor 1999

Njerëzit janë mësuar që të marrin edukim në çdo lëmi në të cilën dëshirojnë. Në të vërtetë, një sistem arsimor i cili u jep njerëzve rastin për të pranuar shkollimin bazuar në interesin e tyre, tendencat dhe aftësitë e tyre, dëshmon të jetë më përfitues e produktiv për shoqërinë. Sidoqoftë, në ditët e sotme, kushtet ekonomike e sociale i detyrojnë shumë njerëz që t'i japin fund shkollimit të tyre ose që të vazhdojnë atë në lëmin në të cilin nuk janë të interesuar.

Të jetuarit sipas Kuranit adreson problemet e tilla sociale dhe sjell zgjidhje, sepse ambienti të cilin këto vlera e sigurojnë nuk lejon shërbime joadekuate arsimore. E pajisur me urtësinë dhe zotësinë e të kuptuarit se çfarë sjell të mbështeturit në Kuran, njerëzit veprojnë si ofrues të zgjidhjeve në arsimim, ashtu siç bëjnë në të gjitha sferat tjera të jetës. Për më tepër, në shoqëri të tillë, nuk ekziston dallimi i paragjykuar ndërmjet të pasurve e të varfërve. Siç u përmend më lartë, ata që e duan Allahun i shpenzojnë ato që nuk iu nevojiten për të mirën e të tjerëve. Njëherë kur këto akumulime të jenë kanalizuar në shumë fusha që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme siç është arsimimi publik dhe shëndetësia, kërkohet vetëm një moment që këto probleme të zgjidhen. Sikur kjo të adoptohej në tërë rruzullin, dallimi midis të pasurve e të varfërve do të zbehej. Vendet e pasura do të transferonin burimet e tyre të tepërta në vendet e pazhvilluara pa pritur asgjë si kompensim.

Të ofruarit e zgjidhjeve është sigurisht një detyrë madhore për të cilën janë përgjegjës muslimanët meqenëse ata mbahen përgjegjës që t'u ofrojnë të rinjve atë lloj arsimimi që do t'i udhëzonte ata për të jetuar sipas Kuranit. Ky është një lloj edukimi që sqaron personin në lidhje me qëllimin e tij/saj aktual në jetë dhe u tregon atyre shenjat e Allahut në tokë dhe në univers. Nëse kjo nuk ndodh, gjeneratat e reja, që bëhen subjekt i ngulitjeve të ideologjive irelevante të mosbesimit, do të rriten në persona jo produktivë kurse dobia e tyre, për vendin e tyre, kombin e religjionin do të jetë e vogël. Arsimimi joadekuat që u ofrohet të rinjve shpjegon pse ata adoptojnë mënyrë të padëshirueshme të jetës dhe si pasojë u mungon bekimi që prezenton religjioni dhe humbin rrugën. Sigurisht, njeriu që i frikësohet Allahut dhe që ka vetëdije nuk do të rrezikojë përgjegjësinë e vet.

4. Pabarazia midis meshkujve e femrave

Në shoqëritë të cilave u mungon drejtësia reale, pabarazia e grave dhe burrave është një çështje serioze sociale që paraqet probleme të mëdha. Në shumë vende të botës, gratë shpesh trajtohen si qytetarë të klasit të dytë e madje edhe dëbohen. Të përceptuara si të dobëta dhe qenje me nevojë për mbrojtje, ato shpesh abuzohen. Për të njëjtën arsye, ato nuk mbajnë ndonjë rol që kërkon respekt e autoritet në shoqëri.

Në shoqëritë ku mbizotëron paragjykim i tillë, femra me karrierë të mrekullueshme në jetën afariste vështirë se mund të pranohet. Në përgjithësi, femrat shihen si njerëz që kanë mungesë vetëbesimi dhe përcaktimi, dhe që kanë aftësi të varfëra intelektuale. Ky racionalizim i "stereotipit-femër" në shoqëri, shërben në mënyrë të gabuar si një shpjegim për çdo gabim që bën femra. Në realitet, gabimet e tilla nuk janë të zakonshme për femra por janë univerzale për të gjitha qenjet njerëzore.

Ndër kandidatët që konkurrojnë për një vend pune, meshkujt zakonisht privilegjohehen ndaj femrave, madje edhe kur kanë të njëjtat kualifikime, inteligjencë e aftësi. Kjo tendencë shpjegon pse ka mundësi të kufizuara që janë në dispozicion të femrave afariste.

Pabarazia gjinore në jetën sociale sot ka pasoja të mëdha në shumë vende. Këto janë ndër incidentet e zakonshme që shfaqen çdo ditë në shtyp.



Time, 23 dhjetor 1996



The Independent, 29 shtator 2000



The Daily Telegraph, 17 korrik 2000

Në shumë vende, femrat i nënshtrohen dhunës ose në vendet e punës ose në duart e bashkëshortëve të tyre.

Në anën, tjetër, shumica e femrave identifikohen me këtë imixh që u është ngjitur. Ky identifikim i bën ato të pranojnë si të vërtetë rolin inferior që u është dhënë në shumë shoqëri.

Paragjykimet në jetën sociale ndaj dallimeve gjinore kanë pasoja të habitshme në vendet në zhvillim. Lëre anash të drejtën e tyre për edukim e punë, ato madje janë të deprivuar edhe nga marrja e vendimeve lidhur me martesën. Të gjitha llojet e vendimeve personale të gruas gjenden ose te baballarët e tyre ose te burrat.

Ka një orvatje të vazhdueshme për të ofruar zgjidhje në këto implementime të mangëta ku vetëm disa sosh janë përfshirë këtu. Shoqatat e themeluara për të mbrojtur të drejtat e grave, konceptet siç është liria dhe barazia ose lëvizjet feministe e seminarët, panelet ose diskutimet nuk kanë dhënë ndonjë kontribut të thënë për zgjidhjen e zbatueshme. Të gjithë këto orvatje dëshmojnë se këto zgjidhje shkaktojnë komplikime të qenësishme. Kjo është pasojë natyrore meqë zgjidhja reale, si në të gjitha fushat tjera, është unike: zbatimi i Kuranit.

Në shoqëritë ku zbatohen Kurani e Suneti, nuk ka ndonjë dallim paragjykes ndërmjet individëve të shoqërisë, pa marrë parasysh a janë gra, burra, të pasur a të varfër, të rinj a të vjetër. Gjendja sociale, profesioni, pasuria, ose gjinia nuk i bëjnë njerëzit që të gëzojnë privilegje të veçanta. Vepra e mirë në të cilën është angazhuar dikush dhe frika e dikujt nga Allahu dallon, siç është përmendur në ajetin **“Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria, e ju të zotët e mendjes keni dronë Time.”** (Surja Bekare: 197) Në Kuran, njerëzit nuk janë ndarë në baza paragjykuese, në femra e meshkuj. Allahu i adresohet si burrave edhe grave që të kenë besim të ai dhe që të bëjnë vepra të mira. Allahu thekson rëndësinë e të jetuarit sipas vlerave që

Besimtarët dhe besimtarët janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqa, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhnyes, i urtë. (Surja Tavba: 71)

urdhëron. Në këtë kuptim, të qenit femër ose mashkull nuk ka ndonjë rëndësi. Disa nga ajetet e theksojnë këtë siç vijon:

Besimtarët dhe besimtareet janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqa, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhnjyes, i urtë. Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nën të cilët rrjedhin lumenj, në të to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtimi i madh. (Surja Tevba: 71-72)

Nuk ka dyshim se për myslimanët e muslimanet, besimtarët e besimtareet, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtareet, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e All-llahut e shumë përmendëset e All-llahut, All-llahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh. (Surja Ahzab: 35)

Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtarë, të tillët hyjnë në xhennet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie. (Surja Nisa': 124)

Shqetësimet që i vuajnë gratë në jetë sociale

Në shoqëritë e larguara nga religjioni, femrat përballen me shumë vështirësi, e në veçanti duhet përmendur ato që përjetohen pas shkurorezimit. Shkurorezimi krijon shumë probleme për gruan e cila është parandaluar që të punojë nga burri i saj dhe kështu ka mbetur e varur ekonomikisht nga ai.

Fakti se shumica e grave nuk kanë ndonjë profesion, se nuk janë mjaft të reja për të shkuar në punë ose se nuk janë titullare të ndonjë të drejte sociale e bën të vështirë ndarjen e tyre. Përfitimet shtesë që i kërkojnë palët e shkurorezuara nga njëri tjetri dhe insitimi i tyre për të ndjekur interesin e vet kontribuon për konflikte ndërmjet palëve dhe e bën situatën edhe më të vështirë.

Sidoqoftë, në shoqëritë e besimtarëve, njerëzit nuk kalojnë nëpër telashe të tilla, sepse ata zbatojnë Kuranin e Sunetin. Respekti e dashuria

që ndjehen në fillim të martesës nuk humben kur palët vendosin të përfundojnë martesën, sepse ajo bëhet me pëlqim të dyanshëm. Ky qëndrim është rezultat i shpjegimit se palët nuk e shohin njëri tjetrin si femër ose mashkull por si qenje njerëzore që kanë besim në Allahun, dhe prandaj Allahu është krijimi më i lartësuar. Ky qëndrim mirëmban kurtoazinë pas divorcit.

Ka shumë masa të ndërmarra në Kuran që sigurojnë të drejtat e gruas pas ndarjes. Ato që lidhen me situatën e saj ekonomike e mbrojnë mirëqenjen e gruas së ndarë. Ajeti në vazhdim na informon për përfitimet e ndihmave financiare të specifikuar nga aprovimi i përbashkët i të dyja palëve si dhe trajtimin përkatës të gruas pas ndarjes:

Për të devotshmit është obligim që edhe për gratë e lëshuara të bëjnë një furnizim të zakonshëm. (Surja Bekare: 241)

Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni gratë pa pasur kontakt (martesë) me to dhe para se t'u caktoni atyre ndonjë caktim (kurorë-nikah), po pajisni ato (me ndonjë pajisje), pasaniku sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij. Një pajisje e zakonshme është obligim për bëmirësit. E nëse i lëshoni ato para se të kontaktoni, por u keni pas caktuar atyre një caktim (kurorës), atëherë duhet t'u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ju falin ose ju falë ai në duart e të cilit është lidhja e kurorës. E të falni (burra ose gra) është më afër devotshmërisë, e mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtetë, All-llahu sheh atë që vepron. (Surja Bekare: 236-237)

Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngusht nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë All-llahu, e All-llahu nuk ngarkon askë, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë All-llahu sjell çlirim (begati). (Surja Talak: 7)

Sërish nga ajetet, ne e dijmë se, pas ndarjes, nuk është e ligjshme për burrin që të mbajë çfarëdo qoftë që i ka dhënë gruas gjatë martesës. Të gjitha nevojat e gruas së ndarë që i përkasin strehimit janë gjithashtu të garantuara gjatë periudhës 'iddah pas ndarjes. Sipas Kuranit, është poashtu e paligjshme që të trashëgohet gruaja me forcë.

Ajo që është treguar deri më tani na shpalos faktin se zbatimi i Kuranit sjell zgjidhje. Në shoqëritë ku njerëzit jetojnë sipas Kuranit, gratë nuk janë subjekt i maltremit dhe çnderimit si në shoqëritë e tjera.

5. Ndarja e barabartë e burimeve

Sot, jo të gjithë individët në botë kanë qasje në burime ushqimore. Energjia themelore e një mashkulli të rritur është rreth 2,800 kalori në ditë. Burimet ushqyese të disponueshme në planet janë adekuate për të plotësuar nevojën e çdo individi. Mirëpo, pjesa dërrmuese e botës është e përjashtuar nga këto përfitime dhe më shumë se 800 milionë njerëz në tokë vuajnë nga mosushqyeshmëria ekstreme. Kaloria ditore që harxhon 75% e popullsisë botërore (4.03 miliardë njerëz në vitin 1991) është shumë nën nivelin e minimumit të kalorive harxhuese. Për shkak të shpërndarjes jo të barabartë të ushqimit në botë numri i njerëzve të paushqyer dallon nga vendi në vend. Statistika të tjera tregojnë se përmbushja e nevojave themelore të popullsisë së vendeve në zhvillim (ushqimi, pirja, uji, sanitariet, kujdesi shëndetësor dhe edukimi) do të kushtonin afërsisht 40 milionë dollarë në vit. Kjo figurë barazon 4% të pasurisë së kombinuar të 225 njerëzve më të pasur në botë.³

Siç tregojnë këto statistika, burimet e tepërta të disa vendeve, edhe pse të një rëndësie vitale, janë të padisponueshme në disa vende të tjera. Në vendet e pasura, disa burime që nuk janë në përdorim mbeten kot, edhe pse ato mund të transferohen në vendet e varfëra. Mjerimi i disa vendeve afrikane është një shembull me të cilin është i njohur secili.

Padrejtësitë globale nuk janë të kufizuara në ushqim e ujë. Padrejtësia e njëjtë është poaq e vërtetë për shërbimet shëndetësore, e kjo krijon probleme serioze në tërë botën. Duke iu falënderuar hulumtimeve dhe zbulimeve në fushën e mjekësisë, sot shumë sëmundje mund të kurohen e parandalohen lehtë. Kjo është e mundur përmes teknologjisë mjekësore të aplikuar nga vendet e pasura me mjetet e tyre financiare. Vështirë që kjo të mund të thuhet për vendet e pazhvilluara. Problemet e vogla shëndetësore, me të cilat vendet e pasura ia dalin lehtë në krye, paraqesin kërcënim serioz në vendet e varfëra.

Për shembull, leproza është një sëmundje e fshehtë bakteriale që lulëzon kryesisht në "rripin e varfërisë" të rruzullit. Kjo sëmundje, që ka pikëlluar njerëzimin që kur s' mbahet mend, mund të kurohet me mjaft lehtësi në ditët e sotme. Leproza paraqet një kërcënim serioz në vendet e goditura nga varfëria, por në botën e zhvilluar ka vetëm raste sporadike

A leprous 14 year old.



ose hiç raste të raportuara. Ndër arsyet kryesore që sëmundja nuk është eliminuar në vendet e

varfëra është fakti se kurimi është i gjatë dhe çmimi për t'u mjekuar është shumë i shtrenjtë. Tashmë, mbetet fakti se ndihma mjekësore që ofrohet nga vendet e pasura mund të kontribuojë për eliminimin e problemit.

Kur konsiderohen në përgjithësi të gjitha problemet shëndetësore, leproza mbetet maja e një ajsbergu. Në vendet e pazhvilluara, teknologjia është impotente përballë shumë epidemive të tjera. Për më tepër, në mungesë të mjeteve financiare, zor se mund të kurohen këto sëmundje, lëre pastaj që të zhduken tërësisht. Sidoqoftë, zgjidhja e të gjitha problemeve shëndetësore është e thjeshtë: përmes një organizimi racional, mund të vihen në praktikë shumë metoda, siç është transferi i pajisjes së ndaluar mjekësore që është deponuar nëpër depotë e vendeve të zhvilluara për vendet e varfëra.

Pabarazitë globale janë poashtu të dukshme në disponueshmërinë e tekonojgjisë së informimit në tërë globin. Për të zgjeruar zonat bujqësore, vendet e zhvilluara investojnë me tepri në hulumtimin e teknologjisë bujqësore e të ujitjes, duke bërë aktivitetet bujqësore të mundshme nëpër toka joproductive, madje edhe shkretëtira. Sot, sistemet e ujitjes janë duke u transformuar falë teknologjisë informative. Sistemet e ujitjes të mbështetura në kompjuterë, që synojnë humbjen e ujit në minimum, e kanalizojnë ujin direkt në rrënjë të bimëve, nën dhe, duke ruajtur çdo pikë të mundshme në dobi të bujqësisë. Janë paraqitur projekte për të përmirësuar të gjitha burimet e ujit, siç janë deti dhe ujërat që rrjedhin me qëllim të përdorimit të ujitjes në shkretëtira.

Këto metoda moderne të bujqësisë paraqesin si të mundshëm prodhimin madje edhe nëpër shkretëtira. Mirëpo, fakti që këto zbulime nuk janë të disponueshme në vendet e goditura nga varfëria, mbetet një




Duke iu falëndëruar teknologjisë bujqësore, të përdorur nga disa vende si Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Izraeli, në ditët e sotme, toka e tharë mund të transformohet në fushë prodhuese. Teknologjia e njëjtë duhe të transferohet menjëherë në vendet drought-stricken.

problem ndaj të cilit duhet menduar seriozisht. Teknologjia e varfër e këtyre vendeve nuk jep prodhimtari të lartë madje as në tokën pjellore, duke shndërruar kështu urinë në një kërcënim serioz për njerëzit e vet.

Në disa raste, e tërë popullsia e një vendi jeton nën rrezikun e urisë. Shtypi i kushton hapësirë në faqe të tëra një mjerimi të tillë, duke ia tërhequr secilit vëmendjen për situatën por, deri tani ka dështuar që të depërtojë te njerëzit për gjetjen e zgjidhjes. Zgjidhjet janë parë në masa të përkohshme dhe projekte afatshkurtëra, mirëpo masat e tilla të dobëta, të cilave u mungon një depërtueshmëri, nuk prodhojnë ndonjë rezultat.

Në këtë pikë, njerëzit vërtetë kanë nevojë për zgjidhje të shpejta e efektive të cilat do të adresojnë nevojat aktuale. Sot, vendet e goditura nga varfëria marrin shuma të mëdha të ndihmës ushqimore. Tashmë, shumë

nga to nuk shërbejnë për asnjë të mirë sepse ato thjeshtë bëhen për qëllime të ekspozimit dhe janë në papajtueshmëri me nevojat e vuajtësve të krizës. Alternativisht, duke u vonuar ose për shkak të ndërprerjeve brenda organizatës, ushqimi priset para se të arrijë në destinacion. Shoqatat janë krijuar për të organizuar këtë ndihmë. Sidoqoftë, këto shoqata kanë mungesë kredibiliteti, meqë shpesh janë përplot korrupsion.



Sot, në disa vende, ngarkesat me perime e fruta shkarkohen në djerrina. Megjithatë, mbetet fakti se në planet, ka me miliona që jetojnë nën vijën e fundit të kufirit të varfërisë. Shpërndarja racionale e burimeve botërore mund ta parandalojë ekstravagancën, ndërkohë që mbron njerëzit që vuajnë nga uria në zonat e ndryshme të botës.

... Hani frutat e tyre kur të piquen dhe ditën e korrjes (të vjeljes) së frutave jepni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojlive) dhe (hani-jepni) mos teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit.
(Surja An'am: 141)

Newsweek, 18 maj 1998

FAMINE

Pangs of Hunger

Driven by war, a new wave of starvation is threatening the lives of a third of a million victims in southern Sudan—many of them defenseless children



Newsweek, 17 dhjetor 1990

Fakti se millona njerëz në botë ende vuajnë nga uria, është shenjë e përdorimit të paefektshëm të burimeve botërore.

Down by Hunger

Pyongyang's food crisis nears the famine stage

IF NORTH KOREA DOES INDEED COLLAPSE, IT MAY BE FROM SHEER HUNGER. THE horror stories grow worse by the week. A recent defector to South Korea was quoted as saying that women who give birth have taken to eating the placenta for the protein. A recent traveler was stunned by conditions at small railway stations, where temperatures reached minus 30 degrees.

Newsweek, 24 shkurt 1997



Nën dështimin për të gjetur një zgjidhje konkrete qëndron egoizmi, interesi vetjak, ambicja, shkujdesshmëria e dobësi tjera morale. E vetmja mënyrë për t'i dhënë fund këtyrë jopërsosmërive morale është të komunikuarit e Kuranit njerëzve dhe të përkujtuarit atyre se ne do të japim llogari për të gjitha veprat tona në jetën e përtejme.

Si në shembujt e mëparshëm lidhur me shëndetin dhe edukimin, drejtësia do t'i jepte fund shumë problemeve në tërë botën. Sidoqoftë, këtu një pikë meriton vëmendje të veçantë: kur ne themi shpërndarje korrekte, nuk duhet

nënkuptuar se gjithçka do të jetë e disponueshme për secilin, çdokund e në të njëjtën masë. Ajo që nënkupton kjo është se nevojat e njerëzve duhet plotësuar në tërësi. Sigurisht, sistemi i veçantë i ujitjes i vënë në shkretëtirë nuk do të jetë në përdorim diku tjetër. Ngjashëm, askush nuk mund të presë që një vend të dërgojë barëra në një vend tjetër, nëse i njëjti bar është i nevojshëm për vetë atë vend. Për më tepër, nuk është thelbësore që secili qytetar të posedojë saktësisht sasinë e njëjtë të pronës. Ajo që është me rëndësi është se nuk duhet pasur disa njerëz që kënaqen në jetë ekstravagante, derisa, afër tyre, ka njerëz që vuajnë nga varfëria. Është thelbësore shmangja e një hendekut të pa urë ndërmjet të varfërve e të pasurve.

Kur të jetë zbatuar urdhëri i Allahut, “ Të pyesin ty edhe se ç’do të japin. Thuaj: “Tepriçën!” Kështu ua sqaron All-llahu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq). ” (Surja Bekare: 219), shpërndarja korrekte që do të çojë shoqëritë në paqe do të shfaqet spontanisht.

Të pyesin se ç’do të japin. Thuaj: “Atë që jepni prej pasurisë jepni për prindërit, për të afërmit, për bonjakët, për të varfërit, për gurbetçinjtë. E çdo të mirë që punoni, s’ka dyshim se All-llahu e di. (Surja Bekare : 215)

Paqja: Pasoja natyrore e sigurimit të drejtësisë së vërtetë

Kur njëherë të jenë marrë në konsideratë të gjitha këto fakte, ne arrijmë në konkluzion se vetëm të jetuarit sipas Kuranit do të sigurojë një strukturë complete sociale korrekte. Kjo sepse vetëm morali i Kuranit ofron sjellje morale dhe urtësi. Egoizmi, vetëkënaqësia, njerëzit e shkujdesur do të shndërrohen në të mëshirshëm, njerëz që mendojnë për të mirën e të tjerëve dhe që gjejnë zgjidhje. Kjo thjeshtë do të thotë fund i shumë problemeve.

Në shoqëritë ku gëzohet drejtësi, njerëzit nuk ndalen në dobësitë morale siç janë ndjekja e interesit vetjak, mashtrimi ose shkelja e të drejtave të tjetrit. Urdhërat themelore të Kuranit na mësojnë çështjet siç është bashkëpunimi e mëshira, të cilat janë thelbi i shoqërisë së drejtë. Në shoqëri të tillë, secili kujdeset për interesat e tjetrit, prandaj të drejtat dhe interesat e të gjithëve janë të siguruara. Kjo është ajo që sjell paqja e përgjithshme dhe siguria e shoqërisë. Në këtë kuptim, përgjegjësia e të gjithë besimtarëve, është që të komunikojnë vlerat e lavdëruara të Allahut dhe religjionin e drejtë në tërë botën. Ky është tipari më i rëndësishëm i besimtarëve:

Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit. (Surah Ali 'Imran: 104)

(Të xhennetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinqerisht adhurojnë, ata që falënderojnë, ata që agjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqijat, edhe përmbushin dispozitat e All-llahut. Pra, përgëzoj besimtarët. (Surja Tavba: 112)

Allahu përmend ekzistimin e njerëzve që jetojnë sipas këtyre vlerave dhe prandaj u bën thirrje njerëzve që t'i ndjekin ato. Vetëm ata që i bëjnë njerëzit që t'i shmangen veprave të liga do të fitojnë shpëtim:

E kur braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuan ata që pengonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan i kapëm me një dënim të fortë, ngase ishin të shfrenuar. (Surja A'raf: 165)

Cila Është Përvoja Në Jetën Politike

*E sapo të kthehet, ai në
tokë fillon të bëjë
shkatërrim në te, të
asgjësojë të korrat
(mbjelljet) dhe gjallesat. E
All-llahu nuk e do
çrregullimin (fesadin).
(Surja Bekare: 205)*





Drejtësia, morali, dhe ndershmëria duhet të përshkojnë çdo moment të jetës së secilit. Në situatën e tanishme ku secili nga ne jeton në demokraci parlamentare, kjo është veçanërisht e vërtetë për politikanët. Politikani është përgjegjës për shumë njerëz. Njerëzit i drejtohen atij për zgjidhje. Prandaj, është thelbësore që ai të jetë korrekt në vendimet e tija, të mos bëjë diskriminime të paragjykuara kundër njerëzve, të identifikojë në mënyrë korrekte nevojat dhe të kryejë aksione përkatëse për të adresuar problemet e tyre. Derisa bën këto shërbime për të mirën e përgjithshme, ai duhet të bashkëpunojë me ekspertë dhe të emërojë njerëz të kualifikuar që mund të arrijnë rezultate. Nëse ai është i aftë për të gjetur arsyet për ndonjë ndërprerje në shërbim, politikani duhet që me shpejtësi të gjejë zgjidhje të suksesshme dhe të bëjë ndryshime të atypëratyshme në politikat e tij, nëse për këtë ka nevojë. Në interesin më të mirë të publikut, ai duhet të ketë aftësi për prioritete.

Megjithatë për disa, më parë se të jetë shërbim publik, politika është shndërruar në industri profitabile. Në këtë kuptim, në politikë dikush konsiderohet i suksesshëm nëse mban pushtet, konsolidon dhe e

siguron atë përkundër të gjitha rrethanave të pafavorshme dhe, nëse është e mundur, siguron edhe më shumë pushtet. Kur kjo bëhet rrugë e zakonshme politike, nuk është çudi pse në sisteme janë të strukturuar të gjitha format e korrupsionit e të mashtrimit.

Kudo, në perëndim e në lindje, në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, është e mundur të shihet se politika është shkrirë me biznes. Kështu, nuk është e



Mobutu

jashtëzakonshme të shihen shembuj të atyre që, abuzojnë politikën për dobi personale, rrezikojnë karrierën e tyre politike ose janë të përjashtuar nga zyra duke ndjekur skandalet “e ndarjes e të favoreve”. Në shumë sisteme autoritative liderët krijojnë gusto të shtrenjtë dhe kënaqen në ekstravagancë derisa njerëzit e tyre luftojnë urinë dhe epideminë. Mobutu, kryetari i përjashtuar i Zairesë, është një shembull i mirë. Derisa zairasit luftonin për një kore bukë, çdo muaj Mobutu dërgonte aeroplanin e tij personal në Francë për të sjellë berberin e tij. Ai grumbulloi një pasuri të madhe, duke përfshirë në pasurinë e tij personale edhe burimet natyrore e minierat e diamantit të vendit të tij. Për më tepër, ai i lejoi vendet perëndimore që të përfitojnë nga kjo pasuri natyrore e Zairesë derisa njerëzit e tij përjetonin rrethana shkatërruese ekonomike dhe trazira civile për shkak të konflikteve fisnore.

Asnjë shoqëri nuk është immune ndaj praktikave të tilla, veçse kërkohet sundimi i Kuranit. Në komunitetet jofetare njerëzit vështirë se lidhin

ndonjë kuptim për konceptet siç është drejtësia, mëshira, dashuria, respekti e ndershëmria, meqë secili ndjek interesin e vet dhe shfaq lakmi të pashuar. Në ajet, Allahu thekson dimensionet e kërcënimit që njerëzit e tillë paraqesin për shoqëritë:

E posa të kthehet, ai në tokë vepron të bëjë shkatërrim në te, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E All-llahu nuk e do çrregullimin (fesadin). (Surja Bekare: 205)

Nuk bën punë që të pritet ndonjë ndryshim në karakteristikat e lartpërmendura njerëzore për sa kohë që njerëzit nuk zbatojnë Librin e Allahut. Sidoqoftë, në vendet ku njerëzit kanë frikë nga Allahu dhe ku ka udhëheqës të ndërgjegjshëm, gabimet gjyqësore dhe abuzimet e pushtetit nuk lejohen. Problemet e njerëzve diagnostifikohen e trajtohen përshtatshëm dhe shërbimet punojnë me efektshmëri. Shpërblimi për shërbimin publik paguhet vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, ndihma e shprehur vetëm për hir të Tij nuk pritet në këtë botë por në botën e përtejme. Gjatë historisë, Allahu ka komunikuar porosinë e shenjtë përmes profetëve të Tij. Këta profetë vetëm i ftonin ata në religjionin e të së vërtetës. Sidoqoftë, reagimet e njerëzve ndaj këtyre profetëve ishin mosbesimi dhe ata shpesh dyshonin qëllime të fshehura prapa orvatjeve të tyre të singerta. Përgjigjet e profetëve ndaj jobesimtarëve ishin të njëjta:

Thuaj (Muhammed): “Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim, dhe unë nuk jam prej atyre që bëjnë trillime”. (Surah Sad: 86)

O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim. Shpërblimi im është vetëm prej Atij që më krijoi. A nuk po kuptoni. (Surah Hud: 51)

Ata që besojnë në Allahun ndjekin shembullin e kësaj sjellje, që lavdërohet në Kuran. Ata nuk presin fitim në këtë botë, në çfarëdo forme, si kthim për shërbimet e ndihmën e dhënë. Në jetën politike të shoqërive jobesimtare, sidoqoftë, çështjet politike, si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme, dhe interesat personale/partiake janë të lidhura ngushtë. Nëse kjo ndodh, jeta politike e ka hisen e vet të mashtruesit të zgjuar për të marrë vendime kundër interesit publik ose kombëtar. Metodrat e

aplikuara për të siguruar këtë mbështetje të rrethit janë investimet publike që u shërbejnë interesave më të mira të grupeve të veçanta të interesit, duke hapur kredi për ta ose thjeshtë duke injoruar korrupsionin dhe mashtrimin. Lobimi, i inkorporuar në sistemin politik të SHBA-ve e shpjegon më së miri se si punon sistemi. Janë mbledhur shuma të mëdha të donacioneve të pazbuluara, për të financuar fushatat elektorale të kandidatëve. Qëllimi është që të sigurohet një ulëse për dikë në senat, dikë që do të manovrojë llojin e politikës që e përkrahin donatorët. Në një ndër çështjet e saja The Economist u mor me fushatat elektorale të financuara për së tepërmi në SHBA duke theksuar se vetëm në vitin 1992 kontributet u llogaritën deri në 3 miliardë dollarë.⁴ Duke përdorur kontribute ilegale, lobet madje arrijnë fuqinë e ndërmarrjes së sanksioneve kundër qeverive të tjera. Është vërtetë e habitshme shkalla e presionit në politikanë, kur merret parasysh se politikanët kurrë nuk guxojnë të kenë mospërputhje me kërkesat e kontribuesve të tyre. Politikanët e “udhëzuar” nga frika e tyre, adoptojnë politika që i përshtaten më së miri interesit të këtyre grupeve të interesit ose krijojnë kriza artificiale. Nganjëherë partitë politike vuajnë nga konfliktet brenda partiake. Bile përdoren metoda të ndryshme tinzare për të nxitur trazira në vend, prandaj përgatitet terreni i duhur për grupet e interesit për të përfituar.

Lidhjet e ngushta midis grupeve të interesit dhe atyre që janë në pushtet ndikojnë që vendet të zhyten në kaos, siç është e dukshme në diktaturat e Amerikës Latine. Për pesë ose gjashtë vitet e fundit, regjimet fashiste në vendet e Amerikës Latine kanë jetuar në ekstravagancë përderisa masa e njeëzve në ose nën kufirin e varfërisë së skajshme. Edhe sot, pushteti në mënyrë konstante kalon nga diktatorët te juntat dhe vice versa. Juntat ushtarake sundojnë me grusht të hekurt, duke mbajtur pushtetin nga shtypja që i bëjnë masës. Në këto vende, që janë udhëkryq i trafikimit të narkotikëve, konfliktet e interesit të atyre në pushtet dhe të aleancave të drogës vështirësojnë zhvillimin e vendit. Këto qarqe, që lulëzojnë vetëm në kaos, mbajnë vazhdimësinë e tyre përmes shtypjes e terrorit. Prandaj, brutaliteti, konfliktet dhe luftërat civile janë të pafund. Vetëm në vitin 1992, në Kolumbi pati 28 mijë vrasje. Kjo shifër shërben shumë mirë për të

përshkruar formën e brutalitetit që ekziston aty. Siç e kemi parë, të mos jetuarit sipas Kuranit e Sunetit është poashtu arsye për ekzistencën e pushtetmbajtësve të cilët li mbyllin sytë ndaj çdo forme të dhunës.

Një pikë tjetër e habitshme në jetën politike është se autoriteti dhe pushteti u janë të garantuara atyre që, nga natyra dhe kualifikimet, nuk i meritojnë ato. Kjo është ajo në të cilin bazohen sistemet e jobsimit: që të caktoheni në një pozitë të caktuar nuk është esenciale të qenit i kualifikuar. Në këto çështje, interesat vetjake bëhen forcë shtytëse në vendimarrje. Sidoqoftë, në Kuran Allahu urdhëron të kundërtën:

All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni. (Surja Nisa': 58)

Në shoqëritë ku njerëzit nuk jetojnë sipas Kuranit, dhe në pajtueshmëri me të, detyrat dhe përgjegjësitë nuk bëhen në bazë të aftësive e kualifikimeve, dhe secili që fiton ndonjë pozitë të lirë praktikon në rradhë të parë nepotizëm e kronizëm. Për politikanët dhe partitë e ngjashme, interesat vetjake dhe preferencat politike gjithmonë kanë prioritet. Të punuarit për të mirën e publikut është me tepër retorikë që përdoret gjatë fushatave elektorale, se sa adresim ndaj votuesve. Në pajtim me këtë, shërbimet publike, (nëse të tilla ka), nuk u ofrohen fshatrave apo qyteteve të varfëra por provincave ku janë koncentruar zgjedhësit.

Përgjegjës për këtë të arsyetuar të shtrembëruar dhe imoralitet është mosbesimi. Njerëzit, që nuk sillen me përgjegjësi e ndërgjegje, nuk i frikësohen Allahut. Ata nuk tregojnë mëshirë për njerëz dhe për të njëjtën arsye, nuk sillen me korrektësi. Duke trilluar injorancë ndaj faktit se do të japin llogari për çdo vepër që bëjnë në këtë jetë, ata kryejnë çdo formë të ligësisë e imoralitetit. Kështu, detyrë e atyre që janë të përkushtuar që ky mjerim të mbarojë dhe që të përgatisin një të ardhme më premtuese, është që të zbatojnë Kuranin dhe t'i komunikojnë atë njerëzve. Është detyrë e çdo besimtarit që t'i informojë njerëzit për urdhërat e Allahut, me respekt për vlerat morale, që t'i ftojë ata të jetojnë sipas tyre dhe t'i paralajmërojnë ata kundër të qenit të këqinj. Ata që injorojnë këtë detyrë, ose ata që e shtyjnë për më vonë, duhet të frikësohen se, në botën e pastajme, mund të dështojnë që të japin llogari për pandjeshmërinë e tyre.

Ndikimi i Pabesimit Në Ekonomi

*All-llahu e zhduk kumatën
dhe e shton lëmoshën,
All-llahu nuk e do asnjë
besëprerë dhe mëkatar.
(Surja Bekare: 276)*





Pjesën më të madhe të bisedave tona ditore e zë ekonomia. Si në vendet e pasura ashtu edhe në ato të varfëra, disa komunitete janë imune ndaj eskalimit të problemeve ekonomike. Pjesa dërrmuese e njerëzve në botë jetojnë në kufirin e skajshëm të varfërisë përderisa ekzistenca e shumë vendeve varet nga “ndihma” e huaj. Të pranuarit e “ndihmës” i shton problemet e tyre edhe më, meqë, duke qenë të paaftë për të paguar madje edhe interesin, këto vende ballafaqohen me varfëri edhe më të madhe.

Nga shëndeti në arsimim, të gjitha çështjet mbahen në lëvizje duke iu falënderuar mjeteve financiare. Siqodoftë, pavarësisht a janë vende të zhvilluara apo jo, kushtet ekonomike i godasin njerëzit shumë. Pasuria, ekstravaganca dhe pasojat natyrore të saj, siç është degradimi, qëndrojnë afër varfërimit. Të paaftë për të plotësuar nevojat e tyre esenciale, njerëzit luftojnë me njëri tjetrin. Shumë raporte e studime, programe të përmirësimit, dhe seminare për të ngritur vetëdijën ngecin për shkak të dëshirës për të gjetur zgjidhje të zbatueshme dhe mbetet fakti se, secila ditë përforcon dëshpërimin e mjerimin e shumicës së botës.

Papunësia është problem i madh global. Madje edhe kur njerëzit janë të punësuar, pagat e tyre nuk janë të mjaftueshme për të siguruar kushte të mira jetese. Përkundër kësaj, qindra kandidatë konkurrojnë për disa vende të lira në shërbimin publik, vende që do të sjellin të ardhura solide.

Njerëzit presin në rradhë me orë të tëra para zyreve të të papunësuarve me shpresa të dobëta për të gjetur punë.

Pra, cila është zgjidhja? Pse dështojnë masat për të zhdukur këto probleme?

Në çdo vend, zhvillimi ekonomik, prodhueshmëria, rastet e begatshme të punës, dhe forca produktive e punës janë esenciale për të mirëmbajtur stabilitetin ekonomik. Sërish, statistikat indikojnë se ka gati 820 milion të papunësuar në tërë botën. Kur kësaj shifre ia shtojmë numrin e të varurve, dimensionet e problemit bëhen edhe më serioze.

Në ditët tona, sistemet ekonomike, veçanërisht në vendet e varfëra, qëndrojnë në interesin bankar. Përqindja më e lartë e kamatave që u ofrohet depozitorëve nga bankat, ka një ndikim destruktiv në ekonomitë kombëtare. Kjo është arsyeja kryesore pse njerëzit i fusin më me dëshirë paratë në banka se sa që i investojnë ose përdorin ato në mënyrë produktive. Të pasurit e gjejnë më të lehtë të jetojnë në saje të kamatave që marrin se sa të punojnë, kurse në shoqëritë ku shumë njerëz nuk punojnë nuk ka fort gjasa që të rriten investimet, që është esenciale për përmirësimin e vendit.

Në këto sisteme, gazetatat bartin reklamën bankare duke dhënë porositë vijuese: “ju mund të pushoni së investuari në biznesin tuaj dhe të shkoni

në pushime...” kjo përsiatje, megjithëse duket e thjeshtë e atraktive, sjell më parë rrënim të vendit se sa mirëqenie e pasuri. Një ekonomi që nuk rritet nga investimet e ka fundin në shkatërrim. Paratë e grumbulluara nëpër llogaritë bankare dhe sefe janë burim kryesor për problemet ekonomike siç është infacioni. Ata që nuk i kontribuojnë ekonomisë dhe që i vënë paratë në bankë e “shkojnë në pushime” do t’i bartin vetë pasojat afatgjate. Paratë e atyre që rrijnë në bankë do të humbin vlerën e tyre në mënyrë konstante, sipas kursit të kohës, dhe nuk do të mbajnë përqindjen në ngritje të inflacionit.

*O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudive dhe e të krishterëve, në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinën e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e All-llahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e All-llahut, lajmëroji për një dënim të dhëmbshëm.
(Surja Tavba: 34)*

është tjetër, por njësoj edhe kamata!” e All-llahu ka lejuar shitblerjen, ndërsa ka ndaluar kamatën. Atij që i ka aritur këshillë (udhëzim) prej Zotit të tij dhe është ndalë (prej kamatës) atij i ka takuar e kaluara dhe çështja e saj mbetet te All-llahu, e kush e përsërit (pas ndalimit), ata janë banues të zjarrit, ku do të mbesin përgjithmonë. (Surja Bekare: 275)

Në një ajet tjetër, është theksuar se fajdja nuk sjell prosperitet te njeriu: All-llahu e zhduk kamatën dhe e shton lëmshën, All-llahu nuk e do asnjë besëprerë dhe mëkatar. (Surja Bekare: 276)

Për të përmirësuar standardet e jetesës, në të gjitha fushat e jetës, stabiliteti dhe rendi janë esenciale. Kjo vlen gjithashtu edhe për ekonominë. Besimtarët janë ata që duhet të supozojnë përgjegjësinë për ofrimin e zgjidhjeve. Në këtë kuptim, askush nuk ka kohë që të humbasë duke pritur të tjetërt që të ndërmarrin iniciativën. Kjo është sepse Allahu i ka dhënë këtë përgjegjësi secilit besimtar. Për ta plotësuar këtë, njeriu duhet që fillimisht të komunikojë religjionin dhe bekimin që religjioni i jep jetës së secilit.


Anëtarët e një komuniteti që kanë besim të sinqertë se, për dallim nga fajdja, pasuria që shpenzohet për të mirën e njeriut sjell prosperitet, do ta shpenzojnë pa hezitim një pjesë të kësaj pasurie, që nuk u duhet, për një shkak të mirë. Përfitimet nga një sistem i tillë janë evidente në shoqëri. Sidoqoftë, njerëzit nuk duhet ta shohin një sistem të këtyllë si të paarritshëm. Mënyra për ta parandaluar këtë është që të mësojmë njerëzit për Kuranin.

Është me rëndësi të thuhet se në mënyrën e jetës sociale që udhëzon Kurani e Suneti njerëzit luftojnë jo vetëm për mirëqenien e vet, por edhe për mirëqenien e publikut, meqë vlerat e Islamit kërkojnë bashkëpunim, solidaritet e bashkim.

Duke qenë të ndaluar nga Allahu për të bërë këtë, njerëzit nuk dhunojnë të drejtat e njëri tjetrit. Askush nuk provon që në mënyrë të paligjshme të marrë të drejtat e tjetrit. Askush nuk mashtron gjatë matjes ose numërimit. Në shoqëritë që jetojnë sipas Kuranit, padrejtësia nuk lejohet kurrë. Rrjedhimisht, raportet u nxitura nga fajdja marrin fund. Pasanikët nuk grabisin të varfërit dhe njerëzit nuk tentojnë që në mënyrë të paligjshme të marrin hisen e tjetrit.


Numri I të varfërve po rritet

Popullsia botërore



Derisa të pasurit bëhen edhe më të pasur...

GDP-ja e vlerësuar (rata e dollarit 1980)



Në shoqëritë ku aplikohen vlerat religjioze, nuk humbet asgjë. Njerëzit konsumojnë por shmangin ekstarvagancën. Bashkëpunimi dhe drejtësia mirëmbajnë standarde më të mira jetese e mirëqenjeje. Periudha e bekuar e komunitetit të parë islam, një kohë e mirëqenjes kur njerëzit në përgjithësi zbatonin Kuranin e Sunnah, është një shembull eksplisit i këtij fakti.

Vlerat e Religjionit Na Urdhërojnë Që Të Mbrojmë Ata Që Kanë Nevojë Dhe Jetimët

Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u, japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindje e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'u falë.

All-llahu falë dhe mëshiron shumë.

(Surja Nur: 22)





Sot, varfëria nuk është problem i kufizuar vetëm në disa vende. Agjenda botërore është e dominuar nga fëmijët që jetojnë duke mbledhur mbeturina, që kalojnë netët e ftohta jashtë në rrugë edhe që bëjnë punë të rrezikshme, duke rrezikuar jetërat e tyre, e që si kundërshpërbilm marrin pak para. Prandaj, pjesa më e madhe e botës nuk është e sigurtë nga vdekjet e fëmijëve që vuajnë nga mosushqyeshmëria dhe probleme të tjera që lidhen me varfërinë.

Vetëm statistikat mbi varfërinë dhe fëmijët e rrugëve shpalosin dimensionet serioze të situatës.

Në vitin 1982, UNESCO raportoi 200,000 fëmijë të rrugëve në Stamboll, 10,000 në Bogota, dhe 2 milionë në Rio de Zhaneiro. Në Afrikë, kjo e dhënë vlerësohet të jetë 5 milionë dhe është në rritje. Zhvendosjet civile dhe luftërat, mungesat, Sida dhe urbanizimi i shpejtë janë faktorët që e ngrisin numrin e fëmijëve të rrugës. Në tërë botën, 30 deri në 70 milionë fëmijë të rrugëve janë pastrehë për çdo natë.⁵

Në Amerikë, shkalla e varfërisë së fëmijëve të mitur është rritur me një shpejtësi alarmante. Ndërmjet viteve 1979 dhe 1994, numri i fëmijëve nën moshën 6 vjeçare që jetonin në varfëri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u rrit nga 3.5 milionë në 6.1 milionë.

Në vitin 1994 gati gjysma e të gjithë fëmijëve nën moshën 6 vjeçare jetonin në familje të varfëra ose pothuajse të varfëra. Si shtesë ndaj 6.1 milionë fëmijëve të mitur që jetonin në varfëri, 4.8 milionë fëmijë të tjerë jetonin skaj nivelit të varfërisë.⁶

Siç sygjeronjë statistikat e mësipërme, as bota e zhvilluar nuk është immune ndaj varfërisë. Papunësia nga rënja ekonomike dhe pamjaftueshëmria e sistemeve të sigurisë sociale janë, në një masë të madhe, përgjegjëse për këtë varfëri.

Vlerat e Kurani e të Sunnah, sidoqoftë, kërkojnë mbrojtjen e të vrafërve dhe atyre që kanë nevojë. Ka shumë hadithe të të dërguarit të Allahut, profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) që urdhërojnë besimtarët që të mbrojnë të varfërit. Një nga to thotë kështu:

The Independent, 11 shtator. 2000

6 HOME NEWS

One-sixth of Britain's children living below the poverty line

SCALE OF DEPRIVATION

By Bryan Burroughs

ONE-SIXTH OF BRITAIN'S children are living in poverty, a new survey has revealed. The study, by the Joseph Rowntree Foundation, shows that 11 million children in the UK are living in households with low incomes. This is a significant increase on the 9.5 million children living in poverty in 1995. The survey also found that 4.8 million children are living in households that are severely deprived. This is a significant increase on the 3.5 million children living in severely deprived households in 1995. The survey also found that 1.5 million children are living in households that are extremely deprived. This is a significant increase on the 1 million children living in extremely deprived households in 1995.

Vetëm disa fëmijë,
që orvaten të
jetojnë në varfëri.

DEAD END KIDS



The tactics for getting by in a hostile world include good ideas such as finding free breads and candy and the cunning plan to fight off hunger pangs

Dead End Kids

About 200,000 Brazilian children live on their country's streets—and in danger of being slain

By BRYAN BURROUGHS AND MIC MARGOLIS

WASHINGTON: Barbara never had a chance. The 14-year-old street kid was standing down a busy Brazil Avenue street with her half sister and her boyfriend one winter afternoon when a Volkswagen

mentally she says he was the same former police officer who had been demonstrating the street children for months. The kids call him "Friday the 13th."

By the time the ambulance limped up to the Santa Agnes hospital, Wellington was already in a coma. Word of the attack spread quickly through street-level hangouts like the run-down Central de Brasil bus and subway station and the plaza of

Newsweek, 25 maj 1992

...Dhe të pyesin ty për bonjakët. Thuaj: “Po t'i ndihmoni në punët e tyre është më mirë, e nëse i përzieni (pasurin e tyre me tuajën), ata janë vëllezërit tuaj. All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmiri. E sikur të dëshironte All-llahu do t'ju rëndojë. All-llahu është më i fuqishëm, më i urti (Surja al-Bekare: 220)



Duani të varfërit dhe qëndroni afër tyre. Nëse i doni, Allah do t'ju dojë juve. Nëse ju kujdeseni për ta, Allahu do të kujdeset për ju. Nëse i vishni, Allahu do t'ju veshë juve. Nëse i ushqeni, Allahu do t'ju ushqejë juve. Allahu do të jetë zemërgjerë, nëse ju jeni zemërgjerë.⁷

Në vendet ish socialsite ne shohim një dimension tjetër të varfërisë: pavarësisht nga kushtet e veçanta, standardet jetësore të pothuaj të gjithë individëve janë të ulëta, ndryshe nga vendet e zhvilluara dhe ato të treta.


Në këto vende, ka një varfëri të përgjithshme që ndikon në tërë popullsinë. Pasojat e varfërisë kanë një ndikim të përgjithshëm ndaj gjithë vendit. Për shembull, infrastruktura e qyteteve dhe sistemet e sigurisë sociale janë dëshmuar të jenë joadekuate.

Ushqimi është i pamjaftueshëm. Për ndryshim nga shumë vende, madje edhe nëse mund ta sigurosh, ushqimi dhe të mirat e tjera nuk janë në dispozicion nëpër tregje.

Është e mundshme të numërojmë shumë arsye që mund të llogariten si shkaktarë për varfërinë.

Sidoqoftë, do të ishte shumë më e dobishme të diskutojmë ndikimin e varfërisë në shoqëri dhe mënyrat për ta çrënjësuar atë. Në kapitujt vijues, jemi marrë me problemet që lidhen me varfërinë në nëntema të veçanta.

Ekstravaganca është e përhapur në tërë botën. Sidoqoftë, në rrugë ka njerëz që përpiqen të mbijetojnë. Nëse injorojmë ekzistencën e këtyre njerëzve, nuk do ta dëgjojmë ndërgjegjën tonë.





*Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë.
(Surja Isra': 26)*



Sot, mijëra njerëz flejnë në rrugë. Nëse secili vepron me ndërgjegje, kjo varfëri do të përfundojë. Asnjë nuk ka të drejtë për të mohuar përgjegjësinë, duke thënë, "A jam unë ai që duhet ndihmuar?"

Efekti destruktiv I varfërisë në shoqëri

Pa dyshim, prej pasojave të varfërisë më së shumti vuajnë fëmijtë. Fëmijtë e varfër, veçanërisht ata të pastrehë shpesh largohen nga shkollat publike sepse nuk kanë adresë të përhershme, dëshmi për moshën dhe të dhëna për imunizim. Shumë vështirë gjejnë ushqim për të ngrënë. Shpesh, ata detyrohen që të punojnë në kushte të vështira. Në disa vende, fëmijtë madje edhe shiten nga familjet e tyre në “vende pune” si skllëvër.

Në pjesën më të madhe, këta fëmijë fitojnë pak para, në ambientet më të këqija shëndetësore që mund të imagjinohen, e të cilat mund të rezultojnë me vdekje. Popullsia e Indisë është 940 milionë dhe atje ka 44 - 100 milionë fëmijë që punojnë -që është më shumë se numri total i fëmijëve punëtorë në pjesën tjetër të botës. Në Pakistan, një vend me popullsi prej 120 milionësh, ka rreth 8 milion fëmijë që punojnë.⁸ Gjendja e keqe e fëmijëve të varfër nuk dallon në pjesën tjetër të botës.



Jo vetëm fëmijtë indianë bartin barrë të madhe. Në tërë botën, shumë njerëz kalojnë fëmijërinë duke punuar.





Fëmijtë do të detyrohen të punojnë përderisa njerëzit nuk do të mësojnë urtësinë dhe ndërgjegjen që sjell Kurani.


Në tërë botën ne e dijmë situatën e fëmijëve nën moshë të cilët janë të detyruar të punojnë, dhe kushtet e rënda që i kanë ata në vendet e punës. Sidoqoftë, përkundër kësaj, në vend se këtyre fëmijëve t'u jipen shërbimet sociale dhe përkrahja arsimore, që janë aq esenciale për zhvillimin e tyre, këto vende janë të brengosura për konkurrencën e ekonomive të tyre nga produktet e lira të prodhuara nga fuqia punëtore e fëmijëve. Në takimet e tyre, ata madje diskutojnë se si të ngrisin konkurrencën dhe jo se si t'i mbrojnë këta fëmijë.⁹

Shumë vende në botë ndajnë pjesë të rëndësishme të buxhetit për mbrojtje. India dhe Pakistani, vende ku arsimimi, shëndeti e industria kërkojnë një reformë urgjente, nuk bëjnë ndonjë përjashtim. Fjala vjen, Pakistani ndan 60% të buxhetit të vet në armatim dhe shpenzime të mbrojtjes. Fakti që shumica e publikut është e dëmtuar nga varfëria, nuk e ndryshon situatën në Pakistan. Shpenzimet e armatimit nuklear në SHBA janë 35 miliardë dollarë në vit. Nga viti 1946, viti kur ishin inicuar programet lidhur me bombën atomike, e deri në vitin 1996, qenë shpenzuar gati 5.5 trilionë dollarë.¹⁰

Pa dyshim, këto buxhete të ndara për mbrojtje e armatim mund të ofrohen për të sjellë ndihmë në zgjidhjen e problemeve për njerëzit e



Pakistani dhe India janë vetëm dy nga vendet ku shumica e njerëzve janë mallkuar nga varfëria.



goditur nga varfëria. Sidoqoftë, përkundër faktit që në shënjestër janë jetërat e fëmijëve të vegjël, shqetësimet politike dhe kalkulimet e interesit vetjake kanë vështirësuar për një kohë të gjatë zhvillimet e zgjidhjeve të duhura për këto probleme.

Një pikë këtu, kërkon vëmendje të veçantë: nën kushtet vijuese, shpenzimet për mbijetesë janë të pashmangshme. Meqenëse mosbesimi sjell më shumë konflikte, kaos, mizori e dhunë, duket se këto probleme do të vazhdojnë. Sëkëndejm, vendi duhet të mbështet në mbrojtjen e vet që të mbajë ekzistenën.

Sidoqoftë, mjerimi është kudo. Është e qartë se të përhapurit e fjalimeve lidhur me problemet nuk do të ofrojë zgjidhje. Por as të anashkaluarit e thjeshtë të lypësve apo dhënja e lëmoshës. Koordinimi i programeve të rregullta që adresojnë nevojat e edukimit, shëndetësor, strehimit dhe veshmbathjes së njerëzve të varfër është esencial.

Megjithatë, kjo është e mundshme vetëm kur njerëzit të zhvillojnë ndjeshmërinë dhe kur të jetojnë sipas Kuranit. Sërish, vlerat e Kuranit do të sigurojnë një ambient paqësor që do t'i bëj vendet mjaft të ndjeshme sa për të mos shkelur të drejtat e vendeve të tjera. Rrjedhimisht, shpenzimet e mbrojtjes mund të kufizohen dhe burimet e ndara për këtë mund të investohen në fushat përkatëse për të siguruar mirëqenje, paqe e edukim kualitativ për publikun.

Sigurisht që shpenzimet e mbrojtjes janë vetëm një shembull. Mund të ofrohen shumë zgjidhje të tjera të ngjashme. Sikur edhe në të gjitha çështjet e tjera, është esenciale të shihet se zgjidhjet gjenden në të jetuarit sipas Kuranit e Sunetit. Kjo për arsyen se vetëm një person i pajisur me vlerat e Kuranit e të Sunetit mund t'i japë pjesën e vet të bukës nevojtarit ose jetimit, edhe kur ai për veten e vet, është i uritur. Në të njëjtën kohë, ai person është personi që nuk u ofron të tjerëve gjërat që nuk i do për vete, dhe ai është i vetmi që u ofron ndihmë pa kërkuar asgjë si kundërshpërblim. Në Suren Nur, Allahu shpjegon se si duhet të sillen njerëzit e pasur:

Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u, japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindje e tyre,



Fëmijë shpesh janë të pavetëdijshëm për mjerimin që e vuajnë. Sidoqoftë, siç tregon kjo fotografi, të rriturit e dijnë se nëpër çka kalojnë. Por, ata u drejtohen metodave të gabuara për të mbrojtur veten. Zgjedhja e vetme, sidoqoftë, qëndron në Kuran.

po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'ua falë. All-llahu falë dhe mëshiron shumë. (Surja an-Nur: 22)

Në Kuran, Allahu na shpjegon se si duhet të pasurit t'i qasen nevojave të të varfërve. Fjala vjen, Allahu thotë se një pjesë e pasurisë së të pasurve i takon të varfërve. Allahu thotë se disa njerëz nuk e bëjnë publike varfërinë e tyre dhe se të drejtat e këtyre njerëzve duhet të mbrohen:

Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp). (Surja Dharijat: 19). (jepni) për të varfërit që janë të angazhuar në rrugën e All-llahut dhe nuk kanë mundësi të gjallërojnë me tokë, duke qenë se ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzitin njerëzit. Pra çkado që të jepni nga pasuria, s'ka dyshim se atë All-llahu e di shumë mirë. (Surja Bekare: 273)

Vuajtjet e atyre që detyrohen të lënë vendin e tyre

Një ndër pasojat e rëndësishme të varfërisë botërore është problemi i refugjatëve. Shpresa për vende më të mira pune ose standarde më të mira jetese, ose luftërat e mungesat kanë shkaktuar zhvendosje masive, duke shkaktuar kështu konflikte serioze ndërmjet vendeve.

Fillimisht, vala e refugjatëve nga vendet e botës së tretë është favorizuar nga shumë vende mikpritëse, dhe me qëllim që të ofrojnë furnizim të lirë të punës për perëndimin, është aranzhuar përmes trakteve të larta ndërkombëtare. Pagat e ulëta që u paguhen punëtorëve të huaj dhe gatishmëria e tyre për të punuar në kushte të vështira përlllogaritet në këtë pranim gatishmërie. Vërtetë, për një kohë të gjatë, punëtorët e huaj kanë kontribuar në masë të madhe në ekonomitë e këtyre vendeve, por me kohë, meqë këto vende arritën stabilitet e mirëqenje ekonomike, ato nuk kishin më nevojë për fuqinë punëtore të huaj, dhe ishin të prirura të punësonin qytetarët e vet.

Bie fjala, Malajzia, i detyroi punëtorët e huaj veteranë që ishin brenda kufinjve të vet që të largoheshin. Këta njerëz, që erdhën në Malajzi me shpresë për një jetë më të mirë, u desht të kthehen në vendet e tyre pas shumë vitesh shërbimi.

Arsyet e dislokimit nuk kufizohen në dëshirën për kushte më të mira jetese. Luftërat midis vendeve prodhojnë zhvendosje poashtu. Në vendet e shkretëruara nga varfëria e pas luftës, shumica e popullatës mund të asgjësohet. Duke parë gjendjen e vështirë të njerëzve që ikin nga lufta, disa vende tregojnë gatishmëri për të pranuar refugjatët. Në të ftohtët e akullt, refugjatët në nevojë për strehim, ecin me javë të tëra drejt një destinimi për të cilin shpresojnë se do të jetë më i sigurtë, por shpesh nuk pranohen aty.

Në mars 1998, zhvendosja e më shumë se 300,000 refugjatëve kosovarë i la pothuaj të gjitha qytetet e Kosovës të braktisura. Ndërkohë, të ftohtit e madh shkaktoi humbje të shumë jetërave gjatë arritjes.

Në nëntor 1990, çëçenët që ikën në këmbë nga sulmet ruse gjetën strehim në vendet fqinje, por këto vende përforcuan kontrollin kufitar dhe vunë rregulla të tranzitit, duke treguar ngurrimin e tyre për të mikpritur çëçenët. Deri në kohën kur refugjatët arritën në kufirin turk, ku

më në fund u pranuan, shumë gra, fëmijë e pleq kishin humbur për shkak të të ftohtit të ashpër.

Në Afrikë, konfliktet ndërmjet fiseve janë përgjegjëse për arratisjet e dhjetëra mijëra njerëzve. Në Zair, një shembull është konflikti midis Hutuve e Tutsive. Këta njerëz të zhvendosur vuajtën nga uria dhe epidemitë. Ata provuan t'i dërgonin refugjatët në vende të tjera por zakonisht ata nuk pranoheshin (për detajet shih kapitullin "Racizmi")

Vlerat e Kuranit e të Sunetit, sidoqoftë, vënë bazën për një strukturë sociale tërësisht tjetër. Në këtë strukturë, të drejtat e të varfërve dhe të atyre të detyruar t'i lëshojnë shtëpitë janë të mbrojtura. Për të përgatitur

kushte më të mira për ta dhe për të pakësuar vuajtjet e tyre përdoren të gjitha mjetet. Për këtë arsye, njerëzit nuk i shmangen sakrificave.

Gjatë kohës së profetit Muhamed, Allahu e bekoftë dhe i dhëntë paqen, kjo strukturë e vlerave ishte më e



dukshme në qëndrimin e besimtarëve ndaj atyre që i lanë shtëpitë për shkak të Allahut:

Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar. (Surja Hashr: 9) (Ajo pronë) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej All-llahut, dhe që ndihmojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, të tillët janë ata të sinqertit. (Surja Hashr: 8)

Siç shihet qartë nga ajetet, vlerat e përshkruara në Kuran janë mjaft larg prej atyre që hasim sot. Në Kuran, kërkesa për ndihmë gjithmonë has në zemërgjerësi e bujari. Besimtarët dëshmohen më së shumti përmes ndihmës që i japin atyre që kanë nevojë. Kurani kërkon që me rastin e dhënjes së ndihmës atyre që kanë nevojë, furnizuesi të mos shfaqë asnjë dobësi morale siç është të shprehurit e nevojave të veta ose vënja sy në ndihmën që është ofruar. Këto vlera sjellin zgjidhje për shumë probleme.

Vlerat e Kuranit e të Sunnah shtrojnë themelin e një strukturë tërësisht të ndryshme sociale. Në këtë strukturë, të drejtat e të varfërve dhe të atyre të larguar me dhunë nga shtëpitë e tyre janë të mbrojtura. Për të siguruar kushte më të mira për ta dhe për të minimizuar dhembjen e tyre shfrytëzohen të gjitha mjetet. Për këtë arsye, njerëzit nuk i shmangen sakrificave.



Degjenerimi Moral Në Shoqëritë Jobesimtare

*E në ditën kur ata që
nuk besuan paraqiten
pranë zjarrit (e u thonë):
Ju i shfrytëzuat të mirat
në jetën e dunjasë dhe i
përjetuat ato, e sot, për
shkak se keni bërë
mendjemadhësi në tokë
pa të drejtë dhe për
shkak se nuk respektuat
urdhërat e Zotit, do të
shpërbleheni me dënim
nënçmues.
(Surja Ahkaf: 20)*





Shmangja nga qëllimi i vërtetë i jetës është, në një mënyrë, humbje e vlerave. Vërtetë, askush nuk prët që vlerat t'i ngrisin ata që besojnë se bota është vendi i vetëm në të cilin jetohet dhe se të gjithë njerëzit, përfshirë edhe vetveten, do të marrin fund përfundimisht me vdekjen. Ngjashëm, askush nuk prët kualitete humane nga dikush që nuk mendon se është duke u testuar në veprat e tija në këtë botë dhe se, në pajtim me to, do të paguajë në botën e përtejme.

Është e pashmangshme që komunitetet e dhëna pas filozofive kaq të shtrembëruara të mos përjetojnë plogështi shpirtërore. Në këtë jetë të shkurtër, individët janë të brengosur më së shumti për fitimin e dobive personale dhe plotësimin e dëshirave vetjake, me objektiv bazë që të bëjnë jetë për të cilën nuk do të dhënë përgjegjësi. Ndërkohë, ambicja e tyre kurrë nuk është arritja e përsosmërisë së karakterit, sepse besojnë se kjo nuk do t'u japë asnjë dobi në jetën e vet. Përkundrazi, në saje të botëkuptimit të shtrembëruar ndaj jetës, ata i konsiderojnë njerëzit ndihmëtarë, të ndërgjegjshëm, të mëshirshëm dhe tolerantë si "teveqela." Përsiatja e tyre i urdhëron që i fuqishmi të bëj presion ndaj të dobtit dhe të përdorë dhunën kundër tyre, pa respektuar asnjë të drejtë të tyre.

Allahu, në Kuran, thekson se ata që nuk kanë besim në botën e përtejme dhe në Ditën e Gjykimit, nuk shohin asnjë kufizim në kryerjen e veprave të gabuara:

Atë ditë është shkatërrimi për gënjeshtarët. Të cilët nuk e besojnë ditën e përgjegjësisë. E atë ditë nuk e mohon kush, përveç atij që ka sharruar tepër në mosbesim e në punë të këqija. (Surja Mutaffifin: 10-12)

Këta njerëz, që janë larguar nga religjioni, aspirojnë të kenë më shumë dhe ata rrënjosin këtë ambicje në mendjet e atyre që i rrethojnë, duke përgatitur ata që të mos i binden kufizimeve të Allahut.

Jemi duke jetuar në kohë kur ata që i kanë braktisur tërësisht vlerat religjioze janë shumicë. Të pakënaqur me atë që bëjnë personalisht, këta njerëz dëshirojnë poashtu t'i bëjnë të tjerët që të bien në këtë rrugë të errët. Kjo është koha kur të gjitha format e imoralitetit janë duke u revitalizuar: Duke mos parë asnjë kufizim në kryerjen e veprave të gabuara, sulmeve të dhunshme, plogështisë shpirtërore, degradimit moral, prostitucionit, nxitjes së « koprracisë » siç thuhet me fjalët e një ajeti, orientimeve seksuale të mbrapshta, varësisë nga droga, kumora ... në faqet në vijim, ne do të ndalemi në dimensionet e degradimit moral që shpie për në mosbesim.

Indoktrinimi i imoralitetit

Personi jobesimtar, sikurse edhe personi që ka besim të dobët në Allahun dhe në botën e përtejme, kryen me gatishmëri kurvëri, luan kumorë ose bën vepra tjera të vjedhjes, të cilat Allahu i ka bërë të palejueshme. Në të vërtetë bazën për këtë tendencë e shtron mosbesimi. Kjo përsiatje pohon se qenja njerëzore ka ardhur në ekzistencë si rezultat i rastit dhe kështu njeriu nuk duhet të ndjehet i përgjegjshëm ndaj Krijuesit. Teoria e Evolucionit, e cila ushqen ideologjikisht mosbesimin, konsideron se qenja njerëzore është zhvilluar nga një kafshë. Në këtë kuptim, asgjë nuk duhet të na brengosë, përveç plotësimit të nevojave tona. Sa i përket plotësimit të dëshirave të anës së ligë shpirtërore, ne nuk duhet të zbatojmë asnjë kufizim; ne mund të sillemi posi kafshët. Shkurt, një filozofi e tillë, që nuk përmban asnjë dimension shpirtëror, dështon së njohuri vlerat morale.

Në të vërtetë, materialistët e njohur dhe avoketërit e darvinizmit shprehin qartë se si i sheh mosbesimi vlerat morale. William Provine, profesor nga universiteti Cornell, shpjegon se si e vlerëson materializmi moralin:

Shkenca moderne nënkupton drejtpërsëdrejti se bota është e organizuar saktësisht në pajtueshëmi me parimet mekanike. Nuk ka parime të qëllimshme, të çfarëdoqoftshme në natyrë. Nuk ka perëndi dhe forca dizajnuese që janë të zbulueshme në mënyrë të arsyeshme...e dyta, shkenca moderne nënkupton drejtpërsëdrejti se **nuk ka ligje të qenësishme morale apo etike, e as parime udhëzuese absolute për shoqërinë njerëzore**. Së treti, qenjet njerëzore janë makina komplekse të mrekullueshme. Qenja individuale bëhet një person etik përmes dy mënyrave të dy mekanizmave kryesore: trashëgueshmëria dhe ndikimi i ambientit. Kjo është e tëra. E katërta, ne duhet të konklujmë se kur të vdesim, ne vdesim dhe ky është fundi ynë...¹¹

Siç e thotë ky shkencëtar, mosbesimi nuk lejon besimin në botën e përtejme. Njerëzit thjeshtë besojnë se me vdekjen e tyre ata do të zhduken. Për këtë besim të çoroditur të jobesimtarëve në Kuran thuhet sa vijon:

Nuk ka tjetër, pos jetës sonë të kësaj bote, vdesim, lindim dhe ne nuk do të ngjallemi! (Surja Muminun: 37)

Ata që nuk besojnë në ringjalljen nga të vdekurit, nuk shohin asnjë kufizim ose të keqe në imoralitet. Për këta njerëz, nuk ka asnjë arsye që njeriu të vendosë vullnetin e vet. Kjo është arsyeja se pse mosbesimi është shkaku kryesor për degjenerimin moral, siç është pohuar me fjalët e lartpërmendura të W. Provine. Mendimet e shtrembëruara dhe vlerat morale të jobesimtarit janë evidente në këto fjalë.

Duhet përmendur gjithashtu se jo secili që është i angazhuar në imoralitet e ka në mendje darvinizmin ose materializimin. Sidoqoftë, secili duhet ta kujtojë se këto ideologji dhe mentorët e tyre jobesimtarë rrënjosin mendimet e këtilla në kokat e njerëzve dhe rrjedhimisht shumica e njerëzve në mënyrë lakmitare ndjehen më të lidhur për këtë jetë, se sa që mendojnë për botën e përtejme.

Të kuptuarit e atyre pjesëtarëve të gjeneratave të viteve të 60-ta që zunë një emancipim të ndjeshëm, ishte poashtu pasojë e të mos shikuarit të kufinjve në sjellje. Ata kujtohen për të gjitha format e imoralitetit siç janë seksi i hapur, droga, pavarësia arrogante dhe rebelizmi. Tri dekada më vonë, shumë prej këtyre ikonathyesve të viteve të 60-ta janë ose duke drejtuar vende ose duke dhënë mësim nëpër shkolla. Prindërit që rrisin rininë e sotme i përkasin poashtu të njëjtës gjeneratë. Sot, ne shohim një imoralitet që pothuaj është i

Degjenerimi që sjell mosbesimi



Time, 23 nëntor. 1998

LOST GENERATION



By ANDREW MEIER MOSCOW

SPIDER, AS HIS G...
is lead singer...
sion, the nasti...
nasty heavy me...
also a self-pro...
whose xenoph...
steeped in Nazi...
sports black lea...
and on his fing...
er, and his co...
Hitler doubles, n...
aked gi...
shirted dwarfs...
singing...
Spider also hap...
pers to the Du...
ma, the lower h...
parliament—and...
he's so...
Russia's dialec...
ted and...
teenagers that...
he may ju...
by-election to...
fill a Mosco...
Spider's foray...
into...
blematic of the...
rise of a p...
eration of you...
ng malco...
increasingly...
announcing...
public—vocally...
and vi...

Newsweek, 28 maj 2000

WORLD AFFAIRS

BRAZIL'S NEW DRUG HABIT

First it was only a 'transit country.' But now consumption is on the rise in rich neighborhoods and poor. The growing war against cocaine lords, money launderers and smugglers. BY MAC MARGOLIS

THE DAILY TELEGRAPH

Drink abuse 'is costing Britain £3bn a year'

The Daily Telegraph, 11 maj 2000

NEWS

Crime figures show violence soaring

By [unreadable]

Violence has soared in London, with a record number of deaths and injuries in the capital last year. The Metropolitan Police said that the number of deaths from violence rose to 103 in 1999, up from 87 in 1998. The number of injuries rose to 1,100, up from 900. The police also reported a 10% increase in the number of violent crimes, to 1.2 million. The increase was particularly marked in the areas of knife and gun crime, which rose by 15% and 20% respectively. The police said that the increase in violence was a result of a combination of factors, including the growing number of young people in the city, the increasing use of knives and guns, and the growing number of people who are involved in drug dealing. The police also said that the increase in violence was a result of a growing sense of lawlessness and a lack of respect for the law.

The Daily Telegraph, 26 qershor 2000

THE FALL OF THE NAZIS • HOLLYWOOD'S 'PEARL HARBOR'

Newsweek

Sexual Freedom, Legalized Drugs, Euthanasia: Is HOLLAND Pointing the Way Toward Europe's Future?

Newsweek, 4 qershor 2001

Personi që nuk ka frikë të brendshme nga Allahu, nuk vë limite. Kjo arsyejon degjenerimet morale në shoqëri.



The Capital Of Crime

St. Petersburg, Putin's hometown, has become a gangland city. Will the president talk on the street?

As Putin's hometown...

St. Petersburg, Putin's hometown, has become a gangland city. Will the president talk on the street? The city is known for its high crime rate, particularly in the areas of drug dealing and prostitution. The police have reported a significant increase in the number of violent crimes in the city, and the public is growing increasingly concerned about the safety of their neighborhoods. The police have taken steps to increase their presence in the city, but the crime rate continues to rise. The police also report that the increase in crime is a result of a growing sense of lawlessness and a lack of respect for the law.



...of the police...

The police have reported a significant increase in the number of violent crimes in the city, and the public is growing increasingly concerned about the safety of their neighborhoods. The police have taken steps to increase their presence in the city, but the crime rate continues to rise. The police also report that the increase in crime is a result of a growing sense of lawlessness and a lack of respect for the law.

Newsweek, 15 maj 2000

pashembullt në historinë botërore. Një shkak për këtë është ekzistenca e një gjenerate të degjeneruar shumë, të cilët janë rritur nga prindër jobesimtarë. Allahu, në Kuran, përmend komunitete që nuk janë të vetëdijshëm për religjionin për shkak se baballarët e tyre nuk qenë paralajmëruar:

Për t'ia tërhequr një populli, që të parët e tyre nuk u është tërhequr, e për atë shkak ata janë të hutuar. (Surah Jasin: 6)

Në këtë ajet është theksuar po kështu, se gjeneratat që janë lindur nga njerëz jobesimtarë bëhen joreligjiozë dhe i shmangen vlerave morale sikurse edhe prindërit e tyre.

Sot, një ndër shkaqet kryesore të degjenerimit moral që ka përfshirë botën, nga Amerika në Holandë, nga Lindja e Largët e deri te Rusia, është ekzistenca e njerëzve të cilët për shkak të mosbesimit të tyre supozojnë se ata nuk do të jenë përgjegjës për veprat e tyre dhe se do të jenë të pavarur. Meqë në ditët tona mosbesimi është mjaft i përhapur-sikur kurrë më parë në histori-homoseksualizmi është bërë një normë sociale. Për të njëjtën arsye, prostitucioni, pedofilia, kumora, mashtrimi e mitoja janë jashtë kontrollit. Prishja e shoqërisë është vetshfaqur me mosbesim kudo - madje edhe mes anëtarëve të familjes-sjelljet e liga janë bërë çështje prestigji, seksi para dhe ekstra martesor është bërë si karakteristikë definuese e "modernizimit". Sërish, mosbesimi është përgjegjës për humbjen e virtyteve të njerëzve, siç janë modestia, turpi, dhe sjellja e mirë. Njerëzit janë të inkurajuar vazhdimisht që të adoptojnë në formë të normave sjelljet që moralisht ishin të papranueshme vetëm disa dekada më parë.

Është e pamohueshme që mosbesimi sjell imoralitet. Megjithatë, mund të ketë njerëz që pohojnë të jenë me moral, megjithëse jobesimtarë. Ata shpallin se nuk përzihen në asnjë nga sjelljet imorale të lartëpërmendura. Vërtetë, është shumë e mundshme që një person që nuk ka besim mund të mos përfshihet kurrë në ndonjë formë korrupsioni, dhe se ai mund të jetë i vendosur që të mbetet i tillë. Por, kjo nuk do të thotë se nga pikëpamja morale ai është njeri i mirë. Personi që shfaq sjellje virtuozë vetëm sepse ka frikë nga Allahu mbetet konsekuent në sjelljet e tija pa marrë parasysh rrethanat. Personi që nuk beson, i cili pohon se kurrë nuk ka pranuar rryshfet, mund të gënjejë lehtë nëse kjo i shkon për shtat. Në mënyrë alternative, personi i njëjtë pranon që të marrë rryshfet për të paguar faturat e spitalit të birit të tij. Shkurt, me ndërrimin e

kushteve, nën pretekstin e “rrethanave imponuese”, personi jobesimtar mund të kryejë vepra të cilat ia pranon vetes si të gabuara, për shembull, personi jobesimtar i cili vrasjen e mendon si të paimagjinueshme, mundet që një ditë, në zemërim e sipër, ta kryejë atë.

Sidoqoftë, të poseduarit e vlerave të mira, kërkon durim e vullnet. Pa marrë parasysh se sa imponuese janë rrethanat, secili duhet të përpiqet që të ketë karakter të mirë. Për të pasur durim e vullnet të palëkundur, njeriu duhet të ketë qëllim. Besimtarët mund ta bëjnë këtë sepse ata kanë një qëllim kryesor në jetë: të arrijnë kënaqësinë e Allahut, mëshirën e Tij dhe Parajsën. Ata e dijnë siç ka thënë i dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të se: *“Nuk do të ketë asgjë më me peshë në balancimin e besimtarit në Ditën e Gjykimit sesa karakteri i tij.”*¹² Në këtë kuptim, ata shfrytëzojnë çdo rast që të përpiqen për përsosmëri. Në anën tjetër, personi jobesimtar e i pa ndonjë qëllim, nuk ka arsye që të këmbëngulë për durim e vullnet. Për shembull, ata që fitojnë për jetesë nga prostitucioni, pohojnë se kjo është mënyra e vetme për ta mbajtur vetveten. Sikur të kishin besim në Allahun e në botën e përtejme, ata kurrë nuk do të ishin të prirur për një rrugë të tillë të turpshme të të fituarit për jetesë. Të vetëdijshëm se nuk do të mund të japin llogari për këtë, ata me përpikëri do t'i shmangeshin kësaj.

Djali ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e All-llahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati; All-llahu është Dhurues i Madh, i Dijshëm. (Surja Bekare: 268)

Siç tregohet në ajet, për shkak të frikës nga varfëria, shumica e njerëzve guxojnë të kënaqen në të gjitha format e imoralitetit. Në anën tjetër, në mendjen e personit i cili shpreson të fitojë mëshirën e Allahut, nuk paraqitet as mendimi për të jetuarit në mënyrë imorale. Në një ajet, Allahu thekson se frika që kanë besimtarët nga Allahu i bën atë të përpiqen për karakter të mirë:

Dhe ata që e mbajnë lidhjen për të cilën All-llahu ka urdhëruar të mbahet, që frikësohen nga Zoti i tyre dhe nga llogaria e rëndë e përgjegjësisë. Edhe ata që patën durim (ndaj të këqia) për të fituar kënaqësinë e Zotit të tyre dhe që e falën namazin, dhe nga ajo me çka Ne i furnizuem ata kanë dhënë fshehtas e haptas dhe me të mirë e largojnë të keqen. Të tillët kanë përfundim më të mirë. (Surja Ra'd: 21-22)

Telashet me të cilat ballafaqohen njerëzit e moshuar

Në autobusët e stërmbushur, të vjetrit qëndrojnë në këmbë, derisa të rinjtë ulen duke iu shmangur kontaktit me sy...Të vjetrit presin më orë të tëra në rradhë nën diellin e nxehtë ose shiun e rreptë...Prindërit e moshuar e të dobtë duhet të kenë përkujdesje dhe sëmëndejmi shihen si pengesa në shtëpi... Gra e burra të moshuar me të meta mentale prezenca e të cilëve nuk i bë ata të dashur ndaj të afërmeve të tyre.

Këto janë vetëm disa gjërat me të cilat ballafaqohen të vjetrit, të cilët meritojnë respekt e jo neglizhencë. Në vendet jobesimtare, njerëzit që provojnë probleme të moshës, fizike e shpirtërore, provojnë shumë telashe. Shumë sfida individuale e shoqërore që kanë të bëjnë me kualitetin e jetës në moshë të shtyer ua bëjnë jetën edhe më të rëndë këtyre njerëzve.Keqtrajtimin që e përjetojnë ata dhe llojet e vendeve në të cilat lihen shtojnë edhe më shumë problemet e tyre.

Mbrojtja e të moshuarve dhe të treguarit e respektit ndaj tyre urdhërohen me Kuran. Në ajetin vijues, Allahu tregon respektin që e meritojnë të moshuarit:

Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese). (Surja Isra: 23)



Indian elders with nowhere to go

The few old people's homes are overcrowded and traditional family solidarity is breaking down

The Unesco Courier,
janar, 1999

In India, where the traditional joint family system is breaking down, many elders have no choice. 36

Të moshuarit dhe ata në nevojë nuk ndeshen në jotolerancë, dhunë ose inat në shoqërinë me njerëz që kanë ndërgjegje kuranore. Si për të moshuarit ashtu edhe për të rinjtë, besimtarët ofrojnë kushte paqësore e komfore. Ndërkohë, ata presin shpërblimin për këtë nga Allahu.

Nëse dikush ka besim, pa marrë parasysh se a është i ri apo i vjetër, ai gjithmonë mundohet të jetë i mëshirshëm, të respektojë e kuptojë. Në shoqëritë e larguara nga besimi të moshuarit u shkaktojnë mërzë atyre, përreth për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose edhe kualiteteve jo të favorshme. Ky nuk është rast në ambientet ku njerëzit zbatojnë Kuranin e Sunetin, meqë edhe të moshuarit gjithashtu orvaten të prezantojnë karakter të mirë në çdo rrethanë.



THE INDEPENDENT
Wednesday 20 September 2000 ●●●●

Elderly in poverty up by 100,000 since 1997

THE NUMBER of pensioners living in poverty has risen by 100,000 since 1997. By ANDREW GIBCE

The Independent,
20 shtator. 2000

Njerëzit inkurajohen për imoralitet

Sot, nën maskën e “modernizimit” ose të “emancipimit”, njerëzit, veçanërisht adoleshentët, janë të kushtëzuar në imoralitet. Vlerat të cilave, vetëm para disa dekadash, njerëzit iu janë shmangur tani janë pranuar me gatishmëri nga shoqëritë. Sot, në televizion, në tabloide e magazina shfaqen të gjitha format e të metave. Falsifikuesit, homoseksualët, ata që shesin trupin, prindërit që shtyjnë bijat e tyre në prostitucion, kumorxhinjtë, të ashtuquajturit të famshmit me manire të mjerueshme i prezentohen publikut si modele. Edhe pse nganjëherë vërtetë janë të tmerrshëm, ata janë njerëz mënyra e jetesës së të cilëve materializohet nga masa. Ndërkohë, jetërat e shthurrura që ata jetojnë ofrohen si vlera definuese të “modernizimit” ose edhe të “civilizimit”.

Në vitet e fundit, sjellja e përhapur e të feminizuarit, e stilit dhe veshjes mes burrave tipizon një pasojë të këtij indoktrinimi. Fakti se shoqëritë janë të prirura për degradime të tilla është shenjë e paturpësisë së tyre. Ngjashëm, njerëzit e famshëm promovojnë para publikut raportet jashtëmartesore si dhe përdorimin e drogës. Masat injorante imitojnë çdo gjë që lidhet me këta njerëz- nga sjellja deri te filozofitë e tyre, stili i veshjes e deri te gjuha që ata përdorin. Ata me vështirësi e kuptojnë që këta njerëz- objekt i lajkatimit të milionave-janë thjeshtë njerëz të përciptë që luftojnë probleme serioze psikologjike, seksuale e shpirtërore dhe kështu janë të poshtëruar në mënyrë të vazhdueshme nga kolegët e tyre që dijnë për botën e tyre të brendshme. Megjithatë, shumica e njerëzve dështojnë që të kuptojnë këtë. Allahu tërheq vëmendjen ndaj faktit se ata që nuk kanë besim janë të devijuar nga urtësia:

Dhe çdo gjë që u është dhënë juve është kënaqësi dhe shije e kësaj bote, ndërsa ajo që është te All-llahu (thevabi) është shumë më e mirë dhe përhershme, pra, a nuk mendoni? (Surja Kazaz: 60)

Sidoqoftë, njerëzit e kujdesshëm, të urtë, të ndërgjegjshëm e inteligjentë të cilët kanë frikë nga Allahu janë ata që duhet të formojnë kornizën morale të shoqërisë. Ata do të rrisin një shoqëri të shëndoshë sociale duke shtyrë të gjitha veset e këqija jashtë shoqërisë. Më parë se me

gjëra boshe, adoleshentët mund të jenë të preokupuar me pasurimin e karakterit të tyre. Dukshëm, njerëzit e ndërgjegjshëm janë ata që do t'i përkushtoheshin përmirësimit të shoqërisë e jo shkatërrimit të saj. Këta janë njerëz mendjehapur, që në mënyrë të lirë e të pavarur mund të mendojnë për kushtet shoqërore. Duke ikur nga mosbesimi, ata nuk bëhen të verbër dhe s'këndejmë mund të zënë kuptimin e të jetuarit. Duke qenë të ndërgjegjshëm se Allahu i ka krijuar, këta njerëz ndihen përgjegjës ndaj Allahut dhe së këndejmë shfaqin karakter të shkëlqyer. Meqë ata zbatojnë Kuranin dhe Sunetin, ata vetëm përcjellin shembullin e njerëzve të sinqertë, të urtë, e të ndërgjegjshëm që përpiqen për karakter të mirë.

The Daily Telegraph, 22 korrik 2000



Në masë të madhe, shtypi dhe mediat janë përgjegjës për inkorporimin e homoseksualitetit në vlerat shoqërore, sjellje kjo që dënohet me Kuran.



Newsweek,
23 nëntor 1998

Sex swap couples may be allowed to marry

By Steve Ward, Political Correspondent
SEX and marriage will have one change: opposite-sex couples may be allowed to marry legally and adopt children. Home Office ministers plan to launch a public consultation paper on changing the law so that transsexuals can

The Daily Telegraph,
22 korrik 2000



Siç indikon kjo storje e magazinës Time të vitit 1979, disa dekada më parë homoseksualiteti qe propaguar ndër masa si një fenomen natyror.



Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun. (Surja Ahzab: 21)

Të lavdëruarit e atyre që orvaten për karakter të mirë në shoqëri dhe prezentimi i virtyteve që sjell një karakter i mirë në shpirtin njerëzor kur shpreh mospëlqimin për dështimet morale me siguri që do të ndalonte njerëzit të priren ndaj imoralitetit.

Shenja e mungesës së vullnetit karakteristike për jobesimtarët:

Droga

Përdorimi i drogës, veçanërisht në dekadën e fundit, ka pasur një rritje alarmante. Nga hulumtimet është konfirmuar fakti se drogën e përdorë shumica e adoleshentëve. Ngjashëm, numri i të varurve në tërë botën nuk është në asnjë mënyrë i parëndësishëm. Një hulumtim i bërë në vitin 1992 konkludoi se 50% e popullsisë adoleshente të Britanisë ishin përdorues të drogës. Përqindja e të varurve arrinte në 30% të adoleshentëve britanikë. Një hulumtim tjetër indikon se ndërmjet viteve 1988 e 1995, Amerika shpenzoi 57.3 miliardë dollarë në drogë.¹³

Të gjitha drogat janë të dëmshme për shëndetin e njeriut. Përdoruesi i drogës në fund përfundon në qoshqet e errëta të shoqërisë. Atij i nevojiten shuma të mëdha të parave për drogë, megjithëse, paradoksisht, është droga ajo që e



Për çdo ditë numri i përdoruesve të drogës ngritet.

Illegal drugs 'taken by 10pc of 11-year-olds'

By Sarah Lyall

THREE million or more children in the world are estimated to be taking illegal drugs, according to a study by the United Nations Children's Fund (Unicef) and the World Health Organization (WHO) published in the journal *Journal of Child Psychology and Psychiatry*.

The study, which surveyed 11-year-olds in 100 countries, found that 10 per cent of children in 100 countries had used drugs at least once in the past 12 months. The highest rates were found in the United States (15 per cent) and the United Kingdom (14 per cent).

The study also found that 10 per cent of children in 100 countries had used drugs at least once in the past 12 months. The highest rates were found in the United States (15 per cent) and the United Kingdom (14 per cent).

The Daily Telegraph, 4 shtator 2000

Young men's drug deaths double in four years

By Sally Pook

DRUG abuse deaths among men have doubled in four years, with heroin and cocaine blamed for the rise, according to figures published yesterday.

A fifth of all deaths among men in their twenties are now blamed on drugs.

Figures released by the Office for National Statistics paint the first accurate picture of deaths in England and Wales from different types of drugs.

The information is expected to be used to help the Government to make


far less than those from other Class A drugs.

Heroin was listed on 215 drugs-related death certificates in 1997, compared with 82 in 1993. And cocaine deaths trebled from 12 in 1995 to 38 in 1997.

A spokesman for the statistics office said: "The increase in recordings of cocaine may be due to increased use or increased recording, or a combination of both."

Cocaine had become increasingly popular in recent years as its price had

The Daily Telegraph, 25 shkurt . 2000



THE DEATH OF A NATION

Time, 22 janar 2001



LOOMING PLAGUE: Moscow youths shooting up with "vink," a homemade drug cocktail

Time, 11 gusht 1997



Të qenët të deprivuar nga urtësia dhe ndërgjegja që garanton Kurani, shpjegon se pse të rinjtë l dorëzohen drogës.

pengon atë që të punojë fizikisht. Në këtë fazë, të varurit fillojnë të bëjnë jetë në kundërshtim me ligjin, duke vjedhur, mashtruar, duke bërë prostitucion heteroseksual ose homoseksual etj. Në fund, urgjenca për të fituar para dhe dështimi për t'u involvuar në ndonjë punë të hijshme, përforcojnë njëra tjetrën në spirale vetëpërditësuese.

Fakti se personi do të kalojë nga vullneti i tij i lirë në një jetë të përbuzur është i papërfytyrueshëm. Personi i urtë e i ndërgjegjshëm nuk vjen kurrë në situatë të tillë. Megjithatë, mungesa e vullnetit, që është pasojë e mosbesimit, mund të shkaktojë edhe një dëm tjetër, siç thuhet në ajet: **“All-llahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre.** (Surja Junus: 44)

Ata që joshin të rinjtë në përdorimin e drogës shfaqin një aspekt tjetër të efektit të mosbesimit. Dilerët e drogës, që kanë humbur plotësisht vlerat siç janë ndërgjegjia, mëshira, dhembshuria e keqardhja, orvaten të tërheqin më shumë të rinj vetëm e vetëm që të fitojnë më shumë. Për shembull, në disa vende siç është Amerika Latine ose Rusia kontrabandimi i drogës për përfitime komerciale është ndër aktivitet më fitimprurëse. Në masë të madhe, shteti në këto vende kontrollon tregtinë e drogës ose lejon rrjetet e involvuara në tregtinë me drogë që të vazhdojnë punën. Sikur, së paku, një ndër këto parti të ishte besimtare e të kishte besim në Allahun dhe në botën e përtejme, bota do të lirohej nga një problem i tillë. Nëse, për shkak të frikës nga Allahu, askush nuk do të involvohej në drogë në çfarëdo forme- as duke tregtuar me të e as duke e përdorur- ky problem do të merrte fund përgjithmonë.

Sot, iniciativat kundër shpërndarjes ilegale të drogës dhe përdorimit të drogës dështojnë që të ofrojnë zgjidhje përfundimtare. Për shembull, nëse të varurit të cilëve u mungon vullneti për të tejkaluar varësinë trajtohen në spital, ata shpejt u kthehen shprehive të vjetra. Në burg, anëtarët e rrjetit të drogës vazhdojnë të trafikojnë brenda drogat ilegale në mënyrë ndërkombëtare. Mënyra e vetme për të shpëtuar një të varur nga droga, është që t'i jipet vullneti i fortë. Vetëm religjioni i ofron njeriut vullnetin e palëkundur. Madje edhe mosbesimtarët që demonstrojnë vullnet të fortë kanë pasion për diçka, një faktor ky që i bën ata të dobtë. Vetëm frika nga

Newsweek, 19 mars 2001



Të rinjtë, të pavëmendshëm ndaj dëlirsisë, një ndër bekimet e vlerave të Kuranit, nuk shohin ndonjë arsye pse nuk duhet të shesin trupin e tyre.



Newsweek, 19 mars 2001

Prostitutes imported into slavery

Home Office figures show 70% of Soho sex workers are foreigners, most here willingly but some smuggled in and forced to work

The Guardian, 30 maj 2000



Daily Record, 17 dhjetor 1996

Auctions for sex: Europe's thriving slavery industry

Women tell of being sold to pimps by the Balkan mafia and beaten if they resist or fail to earn enough on the streets

The Guardian, 23 maj 2000

Asia's booming sex business

The sex industry is assuming massive proportions in Southeast Asia. The findings of a study carried out by the International Labour Organisation (ILO) in four countries of the region (Indonesia, Philippines, Malaysia and Thailand) speak for themselves: prostitution is generating millions of dollars, currently amounting to between 2 per cent and 14 per cent of gross national product (GNP).

The ILO study, entitled The Sex Sector: The economic and social bases of prostitution in Southeast Asia, states that "although the exact numbers are not known, it is estimated that

The Unesco Courier, nëntor, 1998

Film sex rules to be eased

By Steve Barnett, British Government
FILM censors will unveil plans today to relax rules on sex and violence in adult films and cinema to make a tougher case to entertainment for children and teenagers.
The British Board of Film Classification is expected to craft rules to film that show drug taking, sex

and use violence of "extreme" level and to be able to acquire or use these rules tonight.
The BBFC has faced calls to lift and others for it to be made up and for the Government to take over responsibility for film censorship.
The "Blood Letter" has continued to argue that film-makers to be left

be checked with the board, possibly to support director James Frawley, even where he relies increasingly on computer graphics rather than film. There was also public anger that the BBFC commissioned films such as David Cronenberg's Crash, based on a J.J. Labadie novel, and the French film Humanoid.
The former showed graphic genital

penetration for film students on what is prohibited and what is not for films seen by the young or the film clips for U, PG, 12 and 15 ratings. The guidelines are based on confidential research into public attitudes.
The board is understood to have started the work that there should be relatively little interference over

The Daily Telegraph, 14 shtator 2000

Allahu dhe vuajtja në Ferr ofron një lloj vullneti të cilin askush dhe asgjë nuk mund ta tejkalojë.

Disa akte të turpshme por të përhapura: prostitucioni, shkelja e kurorës dhe homoseksualizmi

Prostitucioni, si mënyrë e të fituarit për jetesë, po përhapet me shpejtësi. Në çdo vit që kalon, mosha mesatare e prostitutave të reja ulet. Madje edhe familjet e tyre i detyrojnë vajzat e djemtë shumë të rinj që të shesin trupin e tyre. Fakti që fëmijët detyrohen të hyjnë në zona aq të neveritshme, në kohën kur atyre ende ju nevojitet mbrojtje e kujdes, duhet të alarmojë vendet botërore në mënyrë që ato t'i mbrojnë ata nga dëmi i tillë. Në të kundërtën, vendet si Filipinet promovohen si atraksione të famshme turistike ku mund të sigurohen fëmijë për seks. Nga shumë pjesë të botës, turistët shkojnë në këto lokacione vetëm për këtë qëllim.

Kurvëria është një akt tjetër i pahijshëm por i përhapur. Sipas statistikave të çertifikuara shëndetësore kombëtare, 32% e fëmijëve të lindur në SHBA lindin jashtëmartese, që do të thotë, çdo vit, 1,267,383 foshnja lindin nga çiftet e pamartuara.¹⁴ Një koncept i cili ishte i

paimagjinueshëm vetëm 2 deri në 3 dekada më parë, tani është bërë pjesë e jetës së përditshme.

Dëmi material e shpirtëror që i jep kurvëria shoqërisë është evident. Nuk ka asnjë nevojë që të theksohet se fëmijët e lindur nga prindër të pamartuar ose nëna vetëushqyese, të cilët edhe vete janë fëmijë, në mënyrë të trashëguar marrin edukim problematik. E ardhmja e këtyre fëmijëve shpesh është mjegulluar. “Sinopsis i Raporteve Aktuale të Krizave Botërore” (mars 9, 1998) shënon degjenerimin moral në strukturën familjare siç vijon:

Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meritojnë bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. (Surja Furkan: 68)



Transformimi i fundit në pjesën e hershme të këtij shekulli kërkoi shkatërrimin e tre faktorëve fundamentale shoqërorë... faktori i parë ishte një zbrëthim më i plotë i moraleve dhe familjes si bazë. Kjo është ngritur fillimisht që në vitet e gjashtëdhjeta. Elementet radikale që sot udhëheqin vendin, në atë kohë quheshin hipikë. Parulla e tyre ishte- dashuria e lirë. Vështirë që dikush e hetoi se ata nuk ishin të lirë meqë ata ishin vazhdimisht duke e luftuar dikë, dhe nuk ishte dashuria ajo që ata e kishin. Ishte imoraliteti e degjenerimi.¹⁵

Kurvëria është një e ligë e ndaluar me Kuran. Fundi i atyre që e bëjnë atë është vuajtja në Ferr përderisa nuk pendohen:

Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe. (Surja Isra: 32)

... Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. (Surja Furkan: 68)

Pas indoktrinimit intenziv, shumica e njerëzve e shohin kurvërinë, një akt që çon në Ferr, si një "modernizëm" dhe shumë njerëz joshen nga ajo.

Homoseksualizmi, që deri vonë ishte i papranueshëm në kodin moral të shoqërive, është një akt tjetër i turpshëm që sot përshkon jetën tonë sociale. Në ditët tona, homoseksualët gëzojnë shumë të drejta sociale, nga martesat homoseksuale e deri te e drejta për të pasur foshnja nga nëna surrogate ose e drejta për të adoptuar fëmijë. Ata kanë qasje në parti, klube e kongrese, të cilat organizohen vetëm për qëllime të tyre. Ndërkohë, shumë magazina e organe të shtypit rrënjosin në mendjen tonë se homoseksualizmi është mënyrë e njohur dhe e pranueshme e jetës. Sidoqoftë, homoseksualizmi është një çoroditje. Megjithatë, me fjalët si

“secili është i lirë për të zgjedhur preferencat e veta ose orientimin seksual”, homoseksualizmit i është atribuar një kualitet “intelektual” dhe kështu kjo është legjitimuar. Siç do të pajtohej gjithkush, në jetën e homoseksualëve e të prostitutave ka një mungesë të vlerave morale. Ata zakonisht janë njerëz agresivë të cilët është vështirë t’i bindësh për çfarëdo gjëje. Ata mallkojnë shumë. Ata nuk i mbajnë trupin e shtëpitë e tyre pastër. Zemrat e tyre janë deri në atë masë plot inat e urrejtje ndaj njerëzve sa që pa ndjerë asnjë faj, shumë nga ta me gatishmëri transmetojnë sëmundje infektive në njerëzit e tjerë. Ata nuk shohin asnjë kufizim në çkadoqoftë dhe u mungon ndershmëria. Duke qenë psikologjikisht në gjendje të varfër shëndetësore, ata janë shumë të prirur për vetvrasje ose madje edhe vrasje. Këta njerëz nuk mund t’i japin asnjë kontribut shoqërisë. Më parë mund të thuhet se ata gjithmonë janë burim i trazirave, tensioneve, sëmundjeve e imoralitetit në rrethin e tyre. Arsyeja pse shtypi e vë homoseksualizmin në krye të agjendës është që të degjenerojë publikun. Meqë në media dhe në botën e argëtimit ka një proporcion të lartë të homoseksualëve, fushata e tyre aktive për homoseksualizmin është jashtëzakonisht efektive. Përhapja e këtillë e propagandës edhe më tutje dobëson përgjithmonë vlerat morale të shoqërisë.

Mosbesimi është veçoria më esenciale e një shoqërie të degjeneruar. Homoseksualizmi është një formë e perversionit, si kundërshtpërblim për të cilën Allahu premtan vuajtje si në këtë edhe në botën e përtejme, përderisa personi nuk i kthehet atij i penduar. Në Kuran, Allahu, shpall se qytetet e njerëzve të cilët nuk iu bindën profetit Lut, u rrafshuan me tokë sepse ata praktikuan homoseksualizmin, shkatërrim ky që u përcoll në histori. Kur profeti Lut, paqja e Zotit qoftë mbi të, u tha që të hiqnin dorë nga ky perverzion dhe ua përcolli atyre paralajmërimin e Allahut, ata e mohuan dhe vazhduan me çoroditjet e tyre. Pas kësaj, njerëzit e tij qenë shkatërruar nga shkatërrimi për të cilin Luti i kishte lajmëruar ata që më parë:

(Të mjerët ju) A shkoni pas meshkujve të kësaj bote. E gratë tuaja i leni anash, të cilat Zoti juaj i krijoi për ju! Por ju jeni një popull që kaloni çdo

kufi!". Ata i thanë: "O Lutë, nëse nuk pushon (nga kjo që na thua), me siguri do të jesh i dëbuar prej nesh!" Ai tha: "Unë jam kundër veprimit tuaj! Zoti im, më shpëto mua dhe familjen time nga ajo që bëjnë ata!" Ne e shpëtuan atë dhe tërë familjen e tij, Përpos një plake (gruas së tij) që mbeti me ata (në dënim). E më pas i zhdukëm ata të tjerët. E Ne u lëshuam atyre një shi të jashtëzakonshëm (gurë nga qielli), e sa i keq ishte ai shi për ata të cilëve iu pat tërhequr vërejtja. Edhe në këtë kishte argument (për të mbledhur mend), po shumica e tyre nuk qenë besimtarë. (Surja Shu'ara: 165-174)

Mënyra se si merren me problemin institucionet sociale dhe organet përkatëse është alarmante.

Asnjë nga këto institucione nuk thekson faktin se ky perverzion është vepër e gabuar që nuk pëlqehet nga Allahu dhe që kjo është arsye për dhimbje në këtë botë dhe vuajtje e përvetshme në botën tjetër. Sëmundja që këta njerëz të prishur i japin shoqërisë duhet larguar. Sidoqoftë, ajo që është më urgjente është që të mbrojmë këta njerëz nga ajo me të cilën kënaqen. Sot, ka me miliona njerëz në botë që jetojnë në perverzion e shthurrje, njerëz të cilët përmes indoktrinimit intenziv kanë përqaftuar imoralitetin, rebelimin dhe të gjitha format e stilet e sjelljes së tmerrshme në jetërat e tyre.

Në anën tjetër, në shoqëritë besimtare njerëzit orvaten për atë që është e mirë, më e ndershme, estetike dhe e sinqertë. Në ajetin vijues, Allahu na informon neve për njerëzit që janë të udhëzuar në mënyrë të drejtë:

... All-llahu juve ua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, ua bëri që t'i uureni. Të tillë janë ata që gjetën rrugën e drejtë. (Surja Huxhurat: 7)

Forca e vetme që i parandalon njerëzit nga të shkuarit pas veprave të këqija dhe perverzioni dhe që i bën vlerat e mira të përhapen në shoqëri është të besuarit. Në ajet, Allahu na informon kështu :

Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur'ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve); All-llahu e di çpunoni ju. (Surja Ankabut: 45)

Kumora është e dëmshme për jetën njerëzore

Në ditët tona, kumora dëmton shoqëritë. Megjithatë, kumora vazhdon të jetë një ndër sektoret më profitabile. Sidoqoftë, shumat enorme të parave të shpenzuara për kënaqësi të pastër, konkretisht për kumorë, do të mund të kanalizoheshin shumë mirë për një qëllim më të mirë, p.sh. për promovimin e mirëqenjes sociale.

Ndikimi i kumorës në njerëz është plotësisht I keq. Shoqëria nuk mund të lejojë kumorën, që është prezente duke filluar nga lajmet në gazeta e edhe në televizion. Meqë, për vetëm disa orë, njerëzit lënë në kumorë atë që e kanë grumbulluar për vite, ata shpesh bëjnë vetëvrasje për shkak të borxhit, ose nuk mund të mbajnë familjet e tyre bashkë,


Kumora, një veprim I ligë, është duke u përhapur çdo ditë e më shumë për shkak të internetit dhe promovimit të tij në shkallë të gjerë. Të referuarit e kumorës si një praktikë e pranueshme do të ishte një akt I pandërgjegjshëm..



Le Monde Diplomatique, gusht 2000



The Independent, 16 korrik 2001



The Independent, 23 korrik 2001

Çoroditja që sjell mosbesimi

Disa të rinj mendojnë se duke iu bindur Satanit, do të jenë në gjendje të vazhdojnë perversitetin e tyre bashkë me të në ferr. Sidoqoftë, ferri, është nën kontrollin e plotë të Allahut, dhe ata do të vuajnë dënimin e veprave në ferr bashkë me Satanin.






The Guardian, 13 korrik 2001

German satanic couple held after ritual murder
Kate Connolly in Berlin
Guardian

Friday July 13, 2001

A devil-worshipping newly married German couple were arrested yesterday after allegedly fleeing the scene of a suspected satanic killing.

The body of a 33-year-old car-parts dealer identified as Frank H was found on Monday in the couple's flat in the western town of Witter, with 66 machete and hammer wounds.



Loss of faith 'has led to increase in exorcisms'
By T. Buchanan

Loss of faith has led to an increase in exorcisms, according to a study by a team of researchers from the University of Exeter. The study, which was published in the journal 'Religion', found that the number of exorcisms performed in the UK has risen significantly in recent years. The researchers suggest that this is due to a growing sense of spiritual crisis and a loss of faith in traditional religious institutions. The study also found that exorcisms are being performed by a wide range of people, including priests, psychologists, and even laypeople. The researchers conclude that exorcisms are a reflection of a deeper spiritual need and a search for meaning in a world where faith is being questioned.

Daily Telegraph, 28 prill 2000

Satanizmi është një e ligë që nganjëherë vjen në rend dite. Kur çështja fiton vëmendjen e masës, secili bën komente sipas ideve vetjake dhe ofron rrugë të ndryshme për të mbrojtur të rinjtë nga ky kërcënim. Sidoqoftë, është e qartë se asnjë nga këto zgjedhje nuk është me rëndësi të thella dhe e përhershme, dhe se ka vetëm një rrugë për të mbrojtur njerëzit nga ky perversitet: të besuarit në Allah, të çmuarit e shenjave të ekzistencës e të fuqisë së Tij, frika nga Ai, të jetuarit sipas Kuranit dhe të edukuarit e të rinjve. Asnjë rrugë tjetër nuk ndihmon për të liruar njerëzit nga kërcënimi i tij.

vuajnë nga depresioni, e madje bëjnë edhe vrasje. Ky sektor i ekonomisë, i krijuar nga familje të thyera, martesë të shkatërruara, dhe para të bëra në mënyrë jashtëligjore është një shembull i rëndësishëm i degjenerimit moral.

Është e habitshme se si kumora, që dëmton aq shumë shoqërinë, promovohet gjerësisht. Fitimi i parave nga kumora dhe legjitimimi i tyre sigurisht nuk bëhet nga njerëzit që kanë ndërgjegje.

Ata që lejojnë kumorën të përhapet në shoqëri, e që është burim i vuajtjeve masive, pranojnë këtë ligësi vetëm kur edhe vetë fillojnë të vuajnë nga ajo. Derisa nuk pësojnë një fund të pakëndshëm ata bëjnë që shumë njerëz të zhyten në jetë të errët. Zhdukja e një veçorie të tillë të pandërgjegjshme është e mundur vetëm përmes zbatueshmërisë së Kuranit. Allahu e definon kumorën si fëlliqësi dhe paralajmëron njerëzit që të qëndrojnë larg tij:

O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedh armiçësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?
(Surja Ma'ida: 90-91)

Ajo që është detyrë e njerëzve besimtarë e të ndërgjegjshëm është ngritja e vetëdijës lidhur me dëmet që sjell kumora dhe të ftuarit e njerëzve që t'i ikin kësaj së lige.

***O ju që besuat, s'ka
dyshim se vera,
bixhozi, idhujt dhe
hedhja e shigjetës (për
fall) janë vepra të
ndyta nga shejtani.
Pra, largohuni prej
tyre që të jeni të
shpëtuar.
(Surja Ma'ida: 90)***



Vrasjet e Shkaktuara Nga Mobesimi

*Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin.
(Surja Furkan: 68)*






Të qenit larg nga vlerat e Islamit sjell shumë dëme për shoqërinë. Mbizotërimi i jomëshirës, zemërimit e dhunës janë ndër këto dëme. Jobsimtarët, me gatishmëri, kryejnë vrasje saherë që ndjejnë se në pikëpyetje janë interesat e tyre ose sa herë që nuk mund të përmbajnë zemërimin ata humbin kontrollin ndaj njëri tjetrit.

Shumica janë njerëz që, pa ndonjë arsye, e therrin tjetrin për vdekje, ose që për një shkëndijë xhelozie ose inati e vrasin një anëtar të drejtpërdrejtë të familjes ose një të huaj. Shtoji kësaj, edhe vrasësit serikë ose vrasësit e paguar. Gazetat dhe lajmet e televizioneve që vlojnë nga tregimet për vrasje janë indikacion i degjenerimit që rrjedh si pasojë e mosbesimit.

Dhjetëra mijëra njerëz vriten çdo ditë në botë. Ka njerëz që për një grusht para vrasin taksistët në mesnatë. Ka plot vrasës të paguar që fitojnë për jetesë duke vrarë njerëz që nuk i njohin. Këta njerëz shpesh gjejnë ngushëllim në pretekste jo të arsyeshme si për shembull: “po të mos i kisha marrë këto para, do të vdisja urie”. Të gjitha këto janë akte dhune që paraqiten si rezultat i jetës që nuk njeh qëllimin hyjnor.

Ka të atillë që vrasin vetëm për kënaqësi, ose vrasës serikë që angazhohen për të

masakruar njerëz të pafajshëm. Ka të tillë që vrasin prindërit e vet ose që angazhojnë dikë për t'i vrarë ata, vetëm e vetëm që të trashëgojnë pasurinë e tyre. Ka të tillë që bëjnë vrasje nga xhelozia, dhe të tjerë që, të udhëhequr nga dëshira për hakmarrje, presin me vite që të marrin hak. Ka të tillë që vrasin një të panjohur sepse nuk u pëlqen mënyra se si ata e shikojnë. Ka të tillë që masakrojnë një familje të tërë, përfshirë gratë e fëmijët, për shkak të gjakmarrjes. Ka të atillë që sulmojnë kopshtet për fëmijë duke terrorizuar zemrat e vogla. Ka me mizëri shembuj dhe s'kanë fund lajmet e këqija që shfaqen çdo ditë në shtyp. Një nga arsyet se pse ndodh kjo është sepse injorohet ajeti në vijim:



Ata që dështojnë për të observe kufizimet e vëna nga Allahu me gatishmëri kryejnë vrasje.

Time, 25 mars 1996



The New York Times, 30 korrik 1999

Trail of Despair by a Father Leaves 4 Dead and Son Hurt

The New York Times, 11 maj 1994

Daily Telegraph,
25 korrik 2000

Suicide father kills wife and four children

By Richard Smith

2 Teen-Agers Shot As Violence Persists On New York Streets

The tide of violence in New York City in the last two weeks — four children killed by stray bullets — an advertising

New York Times,
3 gusht 1990



Time, 19 mars 2001



Newsweek, 2 korrik 2001

Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. (Surja Furkan: 68)

Siç këshillon ajeti i mësipërm, Allahu i kërcënon me dënim të rëndë njerëzit që vrasin pa asnjë shkak. Allahu na informon se vrasja e një personi të vetëm është e keqe sikur të vrasësh tërë njerëzimin. Sidoqoftë, sot, njerëzit shpesh kryejnë vrasje sepse ata nuk i binden këtyre ajeteve dhe zemrat e tyre janë të zbrazura nga frika e Allahut. Duke mos pasur besim në botën e përtejme dhe duke trilluar injorancë për faktin se do të japin llogari për dhunën e tillë, njerëzit mund të sillen me mizori. Megjithatë, është e zorshme që personi, i cili ndjek kufizimet e Allahut, të dështojë së kontrolluari zemërimin e tij dhe që kështu të lëndojë personin tjetër. Njerëzit mund t'i ikin drejtësisë në këtë botë por një gjë e tillë është e pamundur të bëhet në prezencë të Allahut, pas vdekjes së dikujt. Asnjë nuk mund të ikë nga dënimi i përjetshëm. Allahu tërheq vëmendjen tonë për këtë çështje në ajetin vijues:

Ata që mohojnë argumentet e All-llahut, mbysin peygamberët pa farë të drejte, mbysin njerëz që këshillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroi për një ndëshkim të dhimbshëm e pikëllues. (Surah Ali 'Imran: 21)

Në shoqëritë ku njerëzit nuk mbështeten në Kuran, ka gjasa që ne do të ndeshemi me skena të dhunës në çdo kohë. Që të mbretërojë paqja e siguria, njerëzit duhet t'i frikësohen Allahut.



Njerëzit që janë larguar nga religjioni ngrisin pasardhës mizorë

Së voni, vrasjet janë ngjitur lartë në agjendën botërore dhe atë për shkak të një dimensionit tjetër pikëllues- që është dhuna ndaj fëmijëve e ushtruar nga fëmijët e tjerë. Të shtënat e vona nga fëmijët nëpër shkolla tregojnë qartë lëndueshmërinë e fëmijëve ndaj mizorive. Mendjet dhe zemrat e tyre të reja janë të ngopura thellë nga programet televizive dhe filmat përplot dhunë të proporcioneve të padëguara. Veçanërisht skenat e vrasjeve, që dominojnë në disa filma, i vënë shumë fëmijë në rrezik, duke bërë anën e errët të mosbesimit të dukshme.

Ajo që në të vërtetë i shtyn të rinjtë drejt kushteve të tilla të errëta dhe që i bën të prirur për mizori është humbja e rrugës nga religjioni. Këta njerëz nuk frikësohen nga Allahu, dhe, për mëtutje, ata vetëm rrisin përfundimet mizore duke mos pasur frikë nga Allahu. Ata, më parë rrënjosin të fëmijët e tyre veprat e gabuara, thënë shkurt: vlerat e mosbesimit, se sa mëshirën, dhembshurinë, drejtësinë e urtësinë. Lutja e

profetit Nuh, paqja qoftë mbi të, e përmendur në Kuran tregon se të gjithë jobesimtarët kanë sjellje të ngjashme mizore:

E Nuhu tha: “O Zoti im, mos lë mbi tokë asnjë nga jobesimtarët! Sepse, nëse Ti i lë ata, robërit Tu do t’i humbin dhe prej tyre nuk lind tjetër, vetëm të prishur e jobesimtarë. Zoti im, më falë mua dhe prindërit e mi, dhe ata që hynë në shtëpinë time, duke qenë besimtarë, edhe besimtarët e besimtare, ndërsa jobesimtarëve mos u shto tjetër, vetëm dëshpërim”. (Surja Nuh: 26-28)

Këta fëmijë, që janë të ndikuar shumë nga filmat, janë pasojë e pashmangshme e shoqërive pabesimtare.



Ky fëmijë që duket shumë i pafajshëm, përkundër rinisë së tij ka kryer një masakër të tmershme. E gjithë dhimbja që vuajnë këta njerëz është shkaktuar nga ky fëmijë. Fundi është i afërt për cilëndo shoqëri ku fëmijëve nuk u ofrohen vlera. Numri në ngritje i fëmijëve vrasës është bërë një tragjedi njerëzore në çdo aspekt.



Luftërat Në Botë

*Ka disa njerëz që
thonë: “Ne i kemi
besuar All-llahut dhe
jetës tjetër (Ahiretit),
po në realitet ata nuk
janë besimtarë.
(Surja Bekare: 208)*





Shekulli i 20-të ishte shekull i luftërave, i gjendocidit e konflikteve. Si një shekull i pashembullt në historinë botërore, ai u shënua me gjakderdhje. Ishte periudhë kur imazhet e miliona njerëzve që humbnin jetën silleshin para syve tanë. Gjatë këtij shekulli, dhjetëra miliona njerëz u dëbuan nga shtëpitë e tyre, humbën më të dashurit e tyre, ose u sakatuan, lënduan e paaftësuan. Shtete të reja u formuan e të vjetra u rrënuan, dhe kjo pati zbrapsje të rëndësishme në historinë botërore. Ai shekull ishte dëshmitar i dy luftërave botërore, të cilat për dallim nga ato të shekujve të mëhershëm morën dimension global. Në të kaluarën, vetëm disa vende ishin involvuar në luftëra dhe një numër i kufizuar i vijave të frontit shërbente si skenë për këto shkatërrime. Sidoqoftë, vetëm gjatë Luftës së Parë Botërore, vdiqën 9 milion njerëz kurse më shumë se 20 milionë u plagosën, e në Luftën e Dytë Botërore më së paku 55 milion njerëz humbën jetën.

Realiteti është se viktimat më të goditura nuk janë palët ndërluftuese por miliona civilë të zënë në shkëmbimin e zjarrit si dhe gra, fëmijë e pleq që masakrohen. Njerëzit u njohën me termin

gjenocid në shekullin e 20-të. Vietnami, Palestina, Kashmiri, Ruanda, Bosnja e Çeçenia u pllakosën nga konfliktet, secila duke paguar tarifën e vet me vdekje njerëzore. Dhjetëra mijëra njerëz u torturuan duke bërë tashmë jetën e tyre si njerëz të paaftë.

Në Kuran, periudha e faraonit përshkruhet si periudhë e ngjashme me këtë kohë. Masakrat mizore që ndodhën në kohën e faraonit ishin gjithmonë të drejtuara nga të varfërit e të pambrojturit. Se faraoni torturonte njerëzit e tij tregohet në vijim:

Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemt e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve. (Surja Kazaz: 4)

(përkujto) Kur Musai i tha popullit të vet: "Përkujtojeni dhuntinë e Allahut ndaj jush; kur ju shpëtoi prej rrethit të faraonit që ju shijonin dënimin më të shëmtuar, ju mbytnin bijtë tuaj, e lënin gratë tuaja të jetojnë. Në ato kishit sprovë të madhe nga Zoti juaj."Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: "Nëse falënderoni, do t'ua shtojë të mirat, e nëse përbuzni, s'ka dyshim, dënimi Im është i vështirë!" " (Surah Ibrahim: 6-7)

Në ditët tona, të raportuarit e mediave për këto vrasje masive tregon në mënyrë eksplicite se sa janë të larguar vrasësit nga njerëzimi. Të lirë nga çdo lloj ndjeshmërie morale dhe nga çdo ndjenjë njerëzore, zakonisht këta njerëz janë të pavëmendshëm se për çka luftojnë. E njëjta vlen edhe për luftërat. Ata që janë përgjegjës për planifikimin e luftërave dhe mbjelljen e farës së luftës në shoqëri, e bëjnë këtë në pritje të plotësimit të disa interesave të veçanta. Sidoqoftë, shpesh shumë nga ata që janë të involvuar aktivisht në luftë nuk kanë ndonjë ide të qartë se përse luftojnë.

Arsyeja se përse njerëzit bëhen mizorë, deri në masë sa që të kryejnë vrasje të dhunshme masive, në të vërtetë qëndron në mentalitetin që ata e përvetësojnë nga liderët e tyre. Në sistemet ku qenja njerëzore trajtohet si kafshë, dhe ku tortura, vuajtja, e dhuna janë shpjegime të arsyeshme, asnjë vlerë nuk tingëllon e kuptueshme. Shikuar nga kjo pikëpamje, shohim se ekzistojnë paralele ndërmjet liderëve dhe të fuqishmëve që përbëjnë forcën shtytëse të dhunës në kohën tonë, me faraonin dhe ushtarët e tij, të cilëve Kurani u jep një vlerësim:


Dhe ata i bëmë prijësa që thërrasin për në zjarr dhe në ditën e kijametit atje nuk do t'u ndihmohet. Edhe në këtë botë i kemi përcjellë ata me mallkim, kurse në ditën e kijametit ata janë të përbuzur. Surja Kazaz: 41-42)

Rrënjët e dhunës

Kur vëzhgojmë për së afërmi shkaqet që në prapavijë shtyjnë njerëzit të masakrojnë njëri tjetrin, e të cilët nuk ndejnë faj, ne ndeshim të menduarit materialist, që kishte ndikim të madh në jetën filozofike të shekujve 19 e 20. Filozofia materialiste pohon se s'ka asgjë përpos materies. Materja ka ekzistuar që nga përjetësia dhe do të mbetet kështu deri në përjetësi. Nisur nga kjo premisë, dënohet ekzistenca e Allahut dhe e të gjitha vlerave që i përkasin jetës shpirtërore si dhe moralit të mirë. Megjithatë, kjo arsye e shtrembëruar argumenton se njeriu ekziston për të mbijetuar, dhe se ai nuk është përgjegjës ndaj askujt dhe për asgjë. Sëkëndejmi, thonë materialistët, ai duhet të ndjekë vetëm interesin e vet.

Teoria e evolucionit, e përkrahur nga filozofët materialistë është shtyllë në të cilën është themeluar kjo e kuptuar e shtrembëruar. Në kohën kur teoria e evolucionit qe propozuar fillimisht, ajo përkrahte pikëpamjen materialiste dhe kështu shtroi bazat për të menduarit gjakftohtë ndaj vrasjeve masive e masakrave. Në konceptin "mbijetesa e më të aftit", Darvini pohon se të dobët duhet gjithmonë të eliminohen përderisa të fortit duhet të mbijetojnë. Pikëpamja e quajtur "darwinizmi social" u bë dogmë themelore e pikëpamjeve raciste, që dominoi kapitalizmin e shekullit të 20-të. Sipas kësaj pikëpamje, të dobët, varfanjakët e të paafët e madje edhe raca të tëra të njerëzve definoreshin si krijesa, statusi evolutiv i të cilëve ishte i tillë që duhet t'i shërbente interesit të 'të aftëve'.

Në rrënjët e shumë akteve të mizorive në botën moderne qëndron teoria e darvinizmit.



Kjo qasje materialiste, nuk i shton rëndësinë jetës njerëzore. Në veçanti, ajo nuk paraqet pengesa për asgjësimin e të dobëtve. Kjo mungesë e çmuarjes së jetës njerëzore shpjegon se pse njerëzit vriten për një copë toke, për ambicje personale ose për të siguruar disa burime natyrore. Duke iu mvëshur kualitetit të absolutshmërisë së materjes, njerëzit që mohojnë ekzistencën e shpirtit bëhen të prirur për të kryer çdo lloj vepre të gabuar e të ndyrë dhe ata gjithashtu i drejtojnë edhe të tjerët për të kryer mizori. Kurani, sidoqoftë, i cakton rëndësinë maksimale jetës njerëzore. Në Kuran, vrasja e një personi të vetëm është baraz me vrasjen e njerëzimit:

Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është

si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit. Atyre (beni israilve) u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij (vendimi) shumë prej tyre e teprojnë (kalojnë kufinj të mbytje) në këtë tokë. (Surja Ma'ida: 32)



Siç theksohet në ajetin e sipërpërmendur, në shoqëritë ku njerëzit zbatojnë urdhërat e Allahut, nuk ndodh që rrethanat t'u kushtojnë atyre me jetë ose me zhvendosje. Njerëzit nuk torturohen, nuk burgosen ose keqtrajtohen. Siç u tha më parë, Kurani, urdhëron trajtim korrekt e të mirë të njerëzve dhe thërret njeriun që të përmbahet nga dhuna, mizoria, lakmia dhe të tejkaluarit e kufinjve. Denoncimi i dhunës dhe padrejtësisë në tokë kërkon që ne të pranojmë përgjegjësinë për komunikimin e ekzistencës së Allahut, Ditës së Gjykimit dhe vlerat e Kuranit e Sunetit. Ata që abstenojnë nga kjo detyrë dhe që thjeshtë injorojnë duhet t'i frikësohen zemërimit të Allahut, meqë në këtë botë Allahu e vë njeriun në sprovë.

Ne kemi shkatërruar gjenerata para jush (o idhujtarë), pse nuk besonin, edhe pse të dërguarit u erdhën me argumente të qarta. Kështu shpërblejmë Ne njerëzit kriminelë. Pastaj juve ju bëmë zëvendësues pas tyre në Tokë për t'ju parë si do të veproni. (Surah Junus: 13-14)

Shkaqet e luftës

Vetëm një analizë e kryer mbi shkaktarët e luftës do të shpaloste bazat iracionale se përse zhvillohen luftërat. Asnjë luftë nuk ka arsytim që do ta justifikonte si të vlefshëm çmimin e mijëra jetërave dhe madje numrin edhe më të madh të të lënduarve. Arsyeja kryesore pse luftërat janë burim i dhimbjes dhe krijojnë shkatërrim për ekonomitë kombëtare janë njerëzit, të cilët janë të prirur për të dëmtuar e dhunuar të drejtat e të tjerëve. Ky karakter përshkruhet më së miri si të qenit i pamëshirshëm e egoist. Të larguar krejtësisht nga kualitetet humane siç janë dhembshuria, mëshira e aftësia për të bashkëpunuar, njerëzit e tillë e ndjekin vetëm lakminë personale dhe luftojnë për të kënaqur dëshirat e tyre për lidërsip. Në fjalët e Kuranit, ky karakter përshkruhet si në vijim:

E posa të kthehet, ai në tokë vepron të bëjë shkatërrim në te, të asgjësojë të korrrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E All-llahu nuk e do çrregullimin (fesadin). Dhe kur i thuet atij: "Kij frikë All-llahun!", atë e kap eufori për punë mëkati. Shtratit i shëmtuar është ai që i takon atij (Xhehennemi). (Surja Bekare: 205-206)

Shpesh, shkelja e të drejtave të një vendi nga vendi tjetër bëhet shkak për luftën midis dy vendeve. Lufta e deklaruar për shkak të një hektari

tokë zakonisht prin drejt një momenti të pakthyesëm - drejt shkatërrimit për çdo vend. Gjatë viteve sa zgjat lufta, të gjitha vendet investojnë rëndë në armatim, deri në atë pikë saqë konsumojnë gjithë pasurinë materiale. Ndërkohë, buxhetet që janë dizajnuar për edukim e shëndetësi gjithmonë dëshmojnë si joadekuate për mirëqenijen e shoqërisë. Disa lobe vitale, grupe e kompani të rëndësishme interesi, qëndrojnë në rrënjët e këtyre konflikteve. Ndërkohë, është gjithmonë publiku, ai që është i goditur nga pasojat e dhimbshme të luftës. Rezultati është gjithmonë shkatërrim i dukshëm për të dyja palët. Kjo ndodh sepse ata që janë të

Në shoqëritë ku njerëzit mbështeten në Kuran e Sunnah, gjakderdhja pa ndonjë arsye dhe masakrat nuk lejohen kurrë, veçanërisht kur janë në pyetje njerëzit e pafajshëm dhe ata të rinj. Kur dëshira për paqe e sjellje të mirë udhëzon raportet njerëzore, pasojat janë të kënaqshme.



involvuar në revolta, në këtë botë ballafaqohen me probleme dhe nuk ia dalin kurrë që të jetojnë në komfort. Allahu u premtan vuajtje atyre që bëjnë këto padrejtësi:

Përgjegjësia (ndëshkimi) është vetëm kundër atyre që u bëjnë njerëzve padrejtë dhe kundër atyre që pa farë arsye bëjnë çrregullime në tokë. Për të tillët është një dënim i dhembshëm. (Surja Shura: 42)

Faktor tjetër që i shtyn vendet në luftë janë burimet nëntokësore dhe natyrore si dhe minierat dhe burimet e ujit. Konfliktet shpesh lindin kur vendet të cilat janë pa këto burime fillojnë të kërcënojnë vendet fqinje me qëllim që t'i ndajnë burimet. Këto probleme mund të zgjidhen duke aplikuar teknologji të lartë dhe planifikim të duhur. Duke qenë kështu, disa vende japin tërë forcën për të ushtruar ndikimin dhe kontrollin me mjete të luftës e të konfliktit, dhe nuk shohin asgjë të keqe nëse i bëjnë vendet gërmadhë duke bombarduar kanalet e ujit, ose duke u drejtuar në çfarëdo lloj dhunë. Ndërkohë, – “dëmi kolateral” –vdekja e grave dhe e fëmijëve të pafajshëm, nuk i shqetëson ata.

Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet (si) mik i afërt. (Surja Fusilat: 34)



Nuk janë vetëm ushtarët ata që vuajnë nga pasojat e luftës. Përveç shkaktimit të humbjes së jetës njerëzore dhe pasurisë, luftat dëmtojnë civilët edhe në aspektin psikologjik.

Pasojat e të mos jetuarit sipas Kuranit

Siç përmendet në Suren Nisa', çdo besimtar është përgjegjës për të ndihmuar varfanjakun:

Ç'keni që nuk luftoni për Zotin dhe për (t'i shpëtuar) të paafitt: nga burrat, nga gratë e nga fëmijët, të cilët luten: "Zoti ynë! nxirrna nga ky fshat (Meka), banorët e të cilët janë mizorë. Jepna nga ana Jote shpëtim e ndihmë!" (Surja Nisa': 75)

Ajo që duhet bërë në këtë pikë është që të ftohen njerëzit që t'ia kenë frikën Allahut dhe që të përkujtohen ata se secili do të japë llogari në Ditën e Gjykimit. Të gjitha përpjekjet e tjera për të adresuar këtë çështje janë të destinuara për të dështuar, meqenëse vetëm personi që ka frikë nga Allahu i shmanget padrejtësië dhe përdorimit të dhunës ndaj të tjerëve. Përndryshe, asgjë nuk mund t'i parandalojë prapësitë e njerëzve; ata ndërmarrin çdo rast për t'iu kthyer qëndrimeve të tyre të padëshirueshme. Vetëm dikush që kupton superioritetin e Kuranit mund të "kthejë" nderin në jetën e tij, dhe këtë e bën duke zbatuar Kuranin, dhe duke ftuar të tjerët që të veprojnë njësoj. Kështu, çdo musliman serioz e ka për detyrë që të komunikojë religjionin. Besimtarët duhet t'u tregojnë të gjithë njerëzve për lumturinë, gëzimin dhe ndjenjën e sigurisë e të besimit që ua garanton religjioni njerëzve. Kështu, nuk do të mbetet asnjë arsye që këto luftëra të vazhdojnë. Çdo konflikt do të shndërrohet në paqe. Por, duhet të theksohet poashtu se kjo paqe mbetet e paarrtshme nëse vetëm pak njerëz e zbatojnë Kuranin. Paqja e pandërprerë në botë është e mundshme vetëm nëse vlerat e Kuranit e të Sunetit adoptohen në përgjithësi. Përndryshe, vetëm disa rajone të veçanta do të përfitojnë nga gëzimi që garanton Kurani dhe njerëzit e tjerë do të vazhdojnë të jetojnë nën kushte të mjera dhe në shtypje, duke vuajtur në masë të madhe nga varfëria dhe dhuna.

Thirrjet e vendeve që janë në nevojë për ndihmë

Për njerëzit që kanë besim në Allahun dhe që e zbatojnë Kuranin dhe Sunetin në çdo moment të jetës së tyre, çdo incident i brendshëm posedon shenja e qëllime. Kjo ndodh sepse Allahu e krijon çdo incident me një

qëllim të caktuar, duke e vënë në këtë mënyrë njeriun në sprovë sa i përket qëndrimeve e sjelljes së tij. Çdo person që beson, bart përgjegjësi e ndër to më të rëndësishmet janë: që të flasë për ekzistencën e Allahut dhe njëshmërinë e tij, që të urdhërojë të drejtën e të ndalojë të keqen dhe të luftojë me argumente inteligjente kundër çdo lëvizjeje që ka për zanafillë mohimin e ekzistencës së Allahut. Frika prej Allahut, në shoqëritë e ndërgjegjshme do të shfaqet kur të ofrohet komunikim preciz i religjionit. Pastaj, spontanisht do të shfaqet zgjidhja e të gjitha problemeve që kanë zanafillë në moszbatueshmërinë e religjionit. Në ajetin vijues Allahu na përkujton për përgjegjësitë që duhet t'i ndërmarrë besimtari:



Ata që mbështeten në Kuran në çdo moment të jetës së tyre, nuk mund të jenë indiferentë ndaj thirrjeve të njerëzve të dëshpëruar.



Luftoni ata (idhujtarët) derisa të zhduket propagandimi i idhujtarëve dhe deri sa të aplikohet feja vetëm për All-llahun. E në qoftë se ndalen (nga propaganda dhe lufta), atëherë lereni armiqësinë, përveç atyre që janë zullumqarë. (Surja Bekare: 193)

Siç thamë më lartë, në ditët e sotme duhet t'i jepet përparësi luftës intelektuale kundër asaj filozofie materialiste që përjashton drejtpërsëdrejti religjionin. S'ka dyshim, kjo luftë do të zërë vend brenda kornizave të sjelljes paqësore dhe të kompromisit të përshkruar në Kuran. Kur njëherë të jenë shkatërruar bazat ideologjike dhe filozofitë themelore, të gjitha ideologjitë e bazuara në to, do të bien një pas një. Allahu na informon në Kuran se kur njëherë të jetë shpalosur e vërteta, pavërtetësia është e gjykuar të zhduket:

Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të ndërsa ajo (gënjeshtra) zhduket. E juve (jobesimtarëve) u takon shkatërrimi, për atë që i përshkruani (Zotit, si fëmijë etj.). (Surja Enbija: 18)

Kjo është arsyeja se pse ne duhet t'ia komunikojmë religjionin secilit që është larg Kuranit. Për të njëjtën arsye ne duhet të inkurajojmë njerëzimin e tërë që të braktisë botën e errët që sjell mosbesimi. Në faqet në vijim, një

Sa herë që arrijnë ndihmat, shprehja e lumturisë është e dukshme në fytyrat e atyre që kanë nevojë për të.



hapësirë do t'i kushtohet disa vendeve të pllakosura në konflikt. Vënja në theks e këtyre vendeve, sidoqoftë, nuk shërben thjeshtë vetëm për qëllime informative. Për qëllime të tilla, ka me mijëra libra, dhjetëra mijëra e raporte të disponueshme. Qëllimi këtu është që të inkurajohen njerëzit e ndërgjegjshëm që t'i ndihmojnë njerëzit e shtypur të cilët janë të dëshpëruar për të gjetur zgjidhje. Është me rëndësi që të përkujtohen besimtarët për këtë detyrë fisnike, dhe që ata të mendojnë vendet e bëra gërmadhë nga konfliktet me të cilat ballafaqohen burra, gra e fëmijë. Askush nuk duhet të mendojë se këto konflikte, që rrënojnë vende, janë larg dhe se ata janë të paaftë për të bërë çfarëdo qoftë.

Është e dukshme që një grup humanitar i të drejtave të njeriut, dhe një organizatë zhvillimore që vjen nën maskën e ofrimit të mbrojtjes dhe ndihmës nuk ofron kurrfarë zgjidhje konkrete. Këto organizata, duke përdorur shuma enorme dhe duke punësuar personel të numërt, deri më tani kanë treguar shfaqje joadekuate dhe u kanë sjellë ndihmë një numri të kufizuar të njerëzve. Njerëzit duhet të jenë të ndërgjegjshëm se për ata që janë të shtypur në Kosovë, Bosnjë, Kashmir ose Palestinë, e që me dëshpërim presin "shpëtimtarin", ka vetëm një zgjidhje: të jetuarit sipas Kuranit.

Çeçenia

Në agjendën e sotme botërore lufta e vazhdueshme ruso-çeçene është një ndër trashëgimitë e shekullit të 20-të. Sulmet e rusëve në Čeçeni, ku kryesisht vriten civilë-gra e fëmijë, shtojnë edhe më tepër seriozitetin e

Trupat ruse në rrugë për masakrën në Čeçeni





IN THE RUINS OF



4

Crescent International — May 16-31, 2000

NEWS/ANALYSIS

Russian media spin-control and the genocide in Chechnya

By Khalid Osman

One of the earliest casualties in Russia's savage campaign against Chechnya was truth, betrayed by a


to subvert the coverage of the war, giving it a distorted, controlled quality. The press serves as an attempt to maintain the western alliance's elaborate public relations campaign, and the only

denigration. For several days they were shown a line of military officials and pro-government analysts explaining that Chechen "gangs" fighting

hand-to-hand in Chechnya also represent a general uprising of Russian public opinion. It reflects a groundswell of popular longing

The reliance on such herring patterns and the treatment of racial hatred, massacres, death attraction, as it contributes to the

Time, 2 prill 2001



GROZNY

Kryqi ndërkombëtar, prill 16-30, 2001

Putin preparing for more fighting in Chechnya, even as he declares the war to be won

Credit where credit is due: to the Chechen people, whose successful defiance of the Russian army's might has come to dominate the devoted to only one subject: Chechnya. His object was to impress on the delegates the real danger that the Chechen "terrorists" are in the work of Russian security forces. He is a former leader of 50 000 Chechen fighters.



E gjithë bota është dëshmitare e mizorive në çeceni. Sidoqoftë, vetëm një numër I vogël I njerëzve të vetëdijshëm ofruan ndihmë, e cila, për shkak të burimeve joadekuate shpesh u dëshmuar të jetë e pavlerë.



Në letrën dërguar
Papa Xhonit II,
presidenti çëçen
Asllan
Maskhadov
shkroi se 3,265
civilë kishin
vdekur dhe 5,000
ishin plagosur në
agresionin një
mujor të forcave
ushtarake ruse
që filloi më 5
shtator.



situatës në këtë pjesë të botës. Imazhet e bombave të hedhura nëpër tregje, pa i dhënë rast për mbijetesë grave, fëmijëve e civilëve të paarmatosur e të pambrojtur çeçenë, shpалosen para syve të botës. Vetëm në një bombardim, që kishte për shënjestër maternitetet, humbën jetën pesëmbëdhjetë foshnje. Ky qëndrim i liderëve rusë, të cilët urdhërojnë ushtarët që të shtijnë në civilët që i lënë fshatrat e tyre për të gjetur strehë në vendet fqinje, tregon dimensionet goditëse të dhunës.

Në Kuran është rrëfyer një masakër e ngjashme në histori, masakra që e kreu faraoni kundër njerëzve të vet:

Përkujtoni edhe kur u shpëtuan prej popullit të faraonit, që nga ai shijuat dënimin më të idhët, duke ua therrur bijtë tuaj, e duke ua lënë gjallë gratë tuaja. Në këtë torturë përjetuat një sprovim të madh nga Zoti juaj. (Surja Bekare: 49)

Siç theksohet në Kuran, përgjatë historisë, njerëzit e pambrojtur lëndoheshin nga mizoritë që ushtroheshin nga njerëzit e karakterit të faraonit. Një rishikim i shkurtër i historisë së Çeçenisë, popullsia e së cilës është nën kërcënim, do të na ndihmonte që më mirë të kuptojmë për dhunën që mbizotëron në këtë vend.

Në vitin 1918, Kaukazi, përfshirë Çeçeninë, ishte nën sundimin e Rusisë sovjetike. Në këtë kohë, Moska komuniste sundonte një territor të madh, duke ndarë me kufinj artificialë tokat e populluara nga grupet etnike. Kjo ndarje etnike që



intensifikuar mëtutje përmes zhvendosjeve të detyrueshme. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, regjimi komunist kreu operime mesnate duke detyruar banorët e Kaukazit që të hipnin nëpër trena të destinuar për në Siberi e Lindje të Mesme. Mijëra njerëz nuk arritën të gjallë në këto destinime, kurse në saje të urdhërave të regjimit komunist, popullsia të tjera etnike u vendosën në tokat që të zhvendosurit i kishin lënë prapa. Kaukazianët të cilët u kthyen pas disa vitesh në vendlindjet e tyre ndeshën në njerëz të tjerë të cilët po jetonin në shtëpitë e tyre. Politika “përçaj e sundo” e aplikuar në atë kohë nga Moska ka acaruar tensionet etnike të së sotmes.

Rënja e Bashkimit Sovjetik ngriti aspiratat nacionaliste dhe rivalitetet etnike duke bërë që grupe etnike brenda kufinjve të sferës së dikurshme sovjetike të deklarorin pavarësinë e tyre. Disa grupe të tjera etnike ndoqën pavarësinë vetëm sa u përket raporteve të tyre ekonomike dhe mbetën nën kontrollin e federatës ruse. 1.2 milionë banorët e Çeçenisë, të cilët për një kohë të gjatë vuajtën nën shtypjen e ashpër ruse, filluan të luftojnë për pavarësi nën udhëheqjen e Dzhokhar Dudayev.

Lufta 18 muajshe ruso-çeçene përfundoi në vitin 1996 dhe çeçenët deklaruan pavarësinë, ndërkohë që trupat ruse po tërhiqeshin. Marrëveshja e paqes e vitit 1997, e nënshkruar nga Moska dhe Grozni, përfundoi luftën formalisht dhe garantoj de fakto pavarësinë e Çeçenisë. Sidoqoftë, marrëveshja paraprake, i lejoi Rusisë shtyrje të afatit në statusin final territorial të Çeçenisë deri në vitin 2001.

Republikat e tjera përcollën hapat e çeçenëve që luftuan për pavarësi. Në vitin 1998 Këshilli i Kaukazianëve Verior u mblodh në Grozni, kryeqytet i Çeçenisë. Në takim, njerëzit e Kaukazit Verior u pajtuan të mos luftonin njëri me tjetrin. Konfliktet e 1999-ës i kishin rrënjët në vendimin e marrë në këtë takim. Forcat ruse nisën një fushatë bombarduese kundër disa fshatrave në Dagestan. Këto fshatra, me 1500 banorë kërkuan ndihmë nga çeçenët. Veterani çeçen, Shamil Basayev iu përgjigj kësaj thirrjeje në verë të vitit 1999. Në bombardim të rreptë, fshatrat e Dagestanit mbetën nën gërmadha dhe vetëm dy njerëz shpëtuan. Pasojat e këtij operacioni bënë që Çeçenia të lëvizë drejt një lufte të re me Rusinë.

Dagestani është në fqinjësi me Çeçeninë, një vend i dendur me popullsi muslimane (80%). Arsyeja kryesore se pse Dagestanezët kërkuan ndihmë nga çeçenët kundër federatës ruse ishte suksesi i madh që realizuan çeçenët kundër tyre në vitin 1996.

Prapa sulmeve ruse në Çeçeni qëndrojnë interese të ndryshme. Megjithatë, pavarësisht se çka shpjegon shpërthimin e luftës, janë gjithmonë gratë, fëmijët e të varfërit ata që vuajnë më së shumti. Janë gjithmonë ata që duhet të luftojnë për ekzistencë përballë varfërisë, urisë edhe epidemive. Ambicja kryesore ruse në Çeçeni gjithomë ka qenë që t'i detyrojë çeçenët që të emigrojnë nga vendlindja e tyre, që t'i asimulojë ata dhe që t'i hapë tokat çeçene për banorët e origjinave të tjera etnike. Deri më sot, në masë të madhe masakrat e mijëra të të pafajshmëve, të të paarmatosurve dhe njerëzve të pambrojtur janë aprovuar dhe për më tepër, e tërë bota mbetet indiferente ndaj këtij akti monstruoz që ndodh para syve të tyre.

Populli i pambrojtur i Kashmirit

Kashmiri është rajon i trazuar ku, për shkak të luftës së vazhdueshme ndërmjet Indisë e Pakistanit, në mënyrë të vazhdueshme shpërthen dhuna. Në mënyrë historike, Kashmiri ka qenë rajon ku civilë të pafajshëm kanë pësuar humbje të mëdha. Për një kohë të gjatë India ishte nën sundimin britanik. Duke pasuar tërheqjen e Britanisë nga India, indianët muslimanë krijuan Pakistanin, një shtet të pavarur musliman. U bë një shkëmbim i popullsisë mes Indisë dhe Pakistanit, me ç'rast shumë muslimanë që jetonin brenda kufinjve të Indisë emigruan për në Pakistan. Sidoqoftë, si rezultat i orvatjeve të Nju Delhit dhe përkrahjes që i dha Britania Indisë, Jammu dhe Kashmiri, një rajon me popullsi të dendur muslimane, mbeti nën sundimin Indian. Që nga atëherë e deri më sot, tensioni në Kashmir nuk ka pushuar kurrë. Kashmirasit nuk synojnë pavarësi por thjeshtë duan t'i bashkohen Pakistanit. Sidoqoftë, presioni që bëjnë indianët ndaj muslimanëve të Kashmirit shkon aq larg deri të përdorimi i armëve kimike kundër civilëve.



Për shumë vite, muslimanët indianë në Kashmir treguan durim ndaj dhunës. Rruga për të ndalë torturën e tillë është të jetuarit sipas Kuranit.

Rezistanca që muslimanët e Kashmirit i bënë Nju Delhit dhe lufta që të bashkohen me Pakistanin rezultoi me një dhunë të vazhdueshme, të imponuar nga shteti Indian ndaj Kashmirit. Në vitin 1947, 1965 dhe 1971, dhuna u shtua duke marrë jetën e mijëra muslimanëve të Kashmirit. Për nga natyra, vrasjet ishin të tmerrshme; nuk u kursyen të moshuar, të sëmurë, fëmijë të vegjël e foshnja. Femrat u dhunuan. Politikat e masakrimit e të asimilimit vazhdojnë edhe sot. Nga ajo që raportojnë organizatat ndërkombëtare, qindra njerëz humbën jetën nën tortura e mijëra të tjerë u paaftësuan në Kashmir. Indianët ndezën shtëpitë, mbyllën gazetat dhe shkollat që punonin me planprogram islamik. Dhimbja nuk ka mbaruar ende, shumë njerëz aktualisht jetojnë në kushte të vështira në strehimoret sikur shpella.

Sigurisht shumë veta kujtojnë se nuk kanë të bëjnë aspak me këta njerëz që jetojnë në pjesë të largëta të botës, qindra mijëra kilometra larg prej tyre. Sidoqoftë, kjo më parë mund të quhet një mënyrë johumane e të menduarit, shumë larg nga qasja kuranore. Si u tha më herët, përgjegjësia e besimtarit është që të komunikojë religjionin te secili, qofshin ata anëtarë të drejtpërdrejtë të familjes ose dikush në ndonjë pjesë tjetër të botës. Më poshtë janë rreshtat e cituar nga raporti i një gazetari i cili ka vizituar kampin e refugjatëve në Kashmir. Madje edhe vetëm këto përshtime do të ishin të mjaftueshme për të vënë në lëvizje ndërgjegjen e njerëzve. Raporti ilustronte kushtet e rënda në kamp:

Kampi i refugjatëve në Ambor është krijuar në vitin 1990 për të ikurit nga Jammu dhe Kashmiri. Kushtet e jetesës këtu janë të këqija. Njerëzit janë të pakeluar nëpër kasolla prej balte të vogla. Në kasollen njëdhomëshe që hymë, kishte vetëm një shtrat. Pyetëm se sa njerëz jetonin në këtë dhomë të vetme. Përgjigja ishte "9". Kampi ka akomoduar 214 familje, me gjithsej 1110 anëtarë. Vetëm të parit e kasolles ofron një pamje të qartë për jetën e rëndë këtu. Këto kasolla në përgjithësi kanë nga dy dhoma...disa poça të vjetruar, një shtrat ose dy, nëse ata mund të quhen shtretër. Një nënë ishte gjunjëzuar në qoshe duke mbajtur në krahë foshnjën e saj. Një çajnik po ziente në zjarrin e ndezur me ca shkarpa. Nuk pashë asgjë për t'u ngrënë! Nuk pata kurajo të hapja çajnikun dhe të shihja nëse kishte gjë brenda. Në disa nga tendat që pashë, nuk kishte as ushqim e as ndonjë gjë ku të flihej! Në një nga tendat, kishte një copë çarçaf

të hapur në mes. Shihej qartë, përdorej si shtrat. Kur pyeta “Sa njerëz rrijnë në këtë tendë?” ata u përgjigjën: “11 njerëz.”... dhe, vetëm një çajnik i hekurt po ziente përjashta!

Spastrimi etnik në Kosovë

Kosova, një rajon me shumicë muslimane, mbeti nën sundimin osman deri në luftën ballkanike të vitit 1912. Deri më sot, banorët e Kosovës janë muslimanë, një trashëgimi e perandorisë osmane dhe e qeverisjes së tyre. Mbarimi i luftës së ftohtë hapi një erë të re në botë, të përcjellur me ndryshime drastike të kufinjve dhe regjimeve, veçanërisht në Ballkan. Gjenerata që mbajti trashëgiminë kulturore të osmanëve mbeti në qendër të këtyre ndryshimeve. Ajo që sot po ndodh në Bosnjë dhe Kosovë është pasojë e këtyre zhvillimeve historike. Zbrastësira që mbeti pas rrënimit të Perandorisë Osmane, ajo që shërbeu si “faktor balancues” në vendet që i udhëhiqte, nuk mundi të plotësohej nga shtetet e reja që u shfaqën pas Luftërave Botërore. Konfliktet që po ndodhin sot në vend janë pasojë e këtyre zbrastësive të mbetura.

90% e popullsisë dy milionëshe të Kosovës janë shqiptarë muslimanë. Territori i krahinës paraqet 12% të Serbisë. Në vitin 1989, forca policore e përbërë kryesisht nga sllavët u angazhua në akte represioni. Ndërkohë, serbët ndaluan planprogramin shkollor në gjuhën shqipe. Që nga 28 shkurti e deri në ditë e sotme, serbët vazhdimisht kanë ushtruar dhunë ndaj kosovarëve.





Kjo është vetëm një nga 300 mijë familjet që kanë lëshuar Kosovën, pas operacionit të filluar nga NATO më 24 mars 1999. Rreshtat e refugjatëve të uritit zgjatëshin me kilometra. Ata i referohen pozitës së tyre si më të mirë krahasuar me ata që kanë mbetur prapa në Kosovë për të qenë viktimat të dhunës e dhunimeve ose të atyre që nuk patën mundësi të mbijetojnë kushtet e ashpra të dimrit duke vdekur rrugës.

Dhjetë mijë refugjatë nuk u lejuan që të kalonin në destinacionin e tyre në pikën kufitare të Morinit, në kufirin Shqipëri-Jugosllavi. Ata u morrën dhe u mbyllën në ndërtesa strategjike, të gjitha caqe të mundshme të bombardimit. Ambasada shqiptare në Romë raportoi 25 mijë refugjatë kosovarë që mungonin. Forca Evropiane e NATO-s tha se lufta në Kosovë ka shkaktuar 960,000 refugjatë. Bazuar në informacionin e ofruar nga UÇK, ministri i jashtëm britanik tha se ka më shumë se 400,000 civilë shqiptarë, refugjatë nëpër zonat malore të Kosovës, të cilët janë nën kërcënim konstant nga uria e vdekja. Sipas autoriteteve nga UÇK-ja, 40.000 civilë shqiptarë që orvateshin të gjenin mbrojtje në shtetet e ulëta të maleve të Berishës, u bënë cak i të shtënave të mëdha të serbëve.





Pas Luftës së Dytë Boëtrre, Serbia kreu gjenocidin më të madh që ka ndodhur ndonjëherë në Evropë. Qëllimi kryesor ishte që të asgjësonte shqiptarët muslimanë në Kosovë, të cilët përbëjnë 90% të popullsisë së përgjithshme, dhe që të bënte Kosovën tokë serbe. Serbët ndoqën politikën e tyre kundër muslimanëve duke vrarë, plaçkitur e dhunuar. Serbët shkatërruar shtëpitë e fshatrat dhe deportuan shqiptarët muslimanë. Regjimi serb filloi një fushatë të vendosjes së serbëve në në çdo vend të mundshëm në Kosovë me qëllim të qartë që të prishë strukturën e jetës shqiptare këtu. Qëllimi ishte ndërrimi i strukturës demografike në favor të serbëve. Siç tha një zëdhënës i NATO--s, me qëllim që të fshijnë gjithçka që kishte të bënte me identitetin kulturor të muslimanëve në Kosovë, serbët madje ndryshuan edhe letrat martesor dhe regjistrimin tittle-deed.



Të detyruar që të lëshojnë shtëpitë e tyre nga kërcënimet e sulmeve, në mars 1999 popullata muslimane e Kosovës filloi të largohet, duke lënë fshatrat e tyre të shkatërruara. Nën shiun e fortë dhe duke u përballur me të ftohtit e ashpër, gratë, fëmijët e vegjël dhe pleqtë lanë gjithçka prapa dhe ecën, drejt një destinacioni të panjohur. Rreth tre muaj më vonë, kur ata u kthyen, asgjë më nuk ishte e njëjtë. Shtëpitë ishin djegur e rrënuar, të afërmit ishin zhdukur, fëmijët ishin të sëmurë kurse prona ishte plaçkitur...lufta dhe migrimi shkatërroi jetën e çdo kosovari, të pasur ose të varfër, në një rrëmuje të plotë.



Organizatrat humanitare në rajon kanë raportuar gjithashtu se në Kosovë serbët kanë kryer gjenocid ndaj muslimanëve. Refugjatët dhe masat e gjera l qenë nënshtruar të gjitha formave të dhunës e torturës. Serbët kanë dhunuar femrat, kanë vrarë shtatëzënat dhe kanë shkatërruar ndërtesat dhe pasurinë. Më shumë se 100,000 njerëz janë vrarë. Gjendja e shtegtarëve ishte e frikshme. Rreth dyzet njerëz- nga to njëzet foshnja dhe të tjerë, të moshuar- kanë vdekur në kufirin maqedono-jugosllav gjatë ndalesës së detyruar e të gjatë që mbajti aty rreth 250-300 mijë shtegtarë.



Masakra çnjerëzore tri vjeçare në Bosnjë

Tri vite të ushtrimit të dhunës ndaj muslimanëve në Bosnjë ilustrojnë më së miri situatën e njerëzve që vuajnë persekutime në goll. Në luftën e nisur nga serbët, në prill të vitit 1992, plani ishte që të asgjësoheshin muslimanët në disa javë ose që ata të detyroheshin të emigronin. Megjithkëtë, trupat e muslimanëve boshnjakë treguan rezistencë të papritur. Lufta vazhdoi deri në pranverë të vitit 1995. Dhuna e kryer gjatë kësaj lufte ishte e pashembullt në historinë botërore. Serbët vranë më shumë se 200.000 muslimanë boshnjakë, nxorrën nga shtëpitë e veta 2 milion njerëz dhe dhunuan më shumë se 50.000 gra muslimane. Në kampet serbe të përqëndrimit, muslimanët iu nënshtruan një torture të papërbalueshme, dhjetëra mijëra u paaftësuan...Ajo që është më e habitshme është se serbët që kryen një mizori të tillë dhe boshnjakët, fokusi i zemërimit serb, janë të një race dhe flasin një gjuhë. Faktori i vetëm dallues është religjioni. Thënë ndryshe, ajo që ndodhi në Bosnjë e Kosovë ishte thjeshtë një luftë fetare, e menduar



ndështruan një torture të papërbalueshme, dhjetëra mijëra u paaftësuan...Ajo që është më e habitshme është se serbët që kryen një mizori të tillë dhe boshnjakët, fokusi i zemërimit serb, janë të një race dhe flasin një gjuhë. Faktori i vetëm dallues është religjioni. Thënë ndryshe, ajo që ndodhi në Bosnjë e Kosovë ishte thjeshtë një luftë fetare, e menduar

Në Sarajevë, gjithçka është shkatërruar: mezi ndonjë ndërtesë në qytet i ka shpëtuar goditjes nga artileria. Në rrugë janë grumbulli i rrënojave të autobusit e të makinave të shkatërruara nga sulmet me raketa. Nuk ka asnjë shtëpi pa dritare të thyera.





Në fshatrat e rrethuara nga ushtarët serbë, qasja në ushqim ishte e mundshme vetëm me lejen e ushtarëve serbë. Secili ballafaqohej me varfërinë, sëmundjet, urinë dhe vdekjen. Duke mos parë rrugëdalje, disa l shëptuan slumit, duke ikur matanë kufinjve të zbathur. Këta refugjatë ishin shenjë e një aspekti tjetër të luftës. Jeta në tenda ishte e mjerë dhe mijëra fëmijë e ndanë së bashku dëshpërimin e frikën për familjet e tyre.

nga shumëkush se është inicuar nga një urrejtje e pavdekshme e Kishës Ortodokse për Islamin.

Diktatura anti-religjioze në vendin më të madh islamik:

Indonezia

Ashtu si për shumë njerëz që përballen me luftën në mbarë globin, jeta është e pasigurtë edhe për muslimanët në Indonezi, një arçipelag ky në Lindjen e Largët. Ky vend që përfshin një tokë të madhe, një zonë të madhësisë së hapësirës evropiane, është kombi I katërt më i madh në botë, me një popullsi prej 210 milion banorë (mesi i vitit 2000). Rreth 87% e popullsisë është muslimane. Ka afro 300 grupe etnike dhe komuniteti

musliman, edhe pse më I madhi, gjithmonë ka qenë cak i shtypjes së rreptë.

Në Indonezi, ish koloni holandeze kjo, sundimi i vendit gjithmonë ka qenë në duart e njerëzve me origjinë javaneze, të cilët përbëjnë mbi 7% të popullsisë. Pas marrjes së pushtetit, elita sunduese javaneze luftoi për të mbajtur kontrollin e plotë në vend dhe, në këtë drejtim, përkundër strukturës shumë etnike të vendit, ka punuar shumë në projektin e ndërtimit të konceptit të kombësisë indoneziane, ose javaneze. Lëvizjet reaksionare të muslimanëve në Aceh Sumatra filluan në vitin 1953, me deklaratën e pavarësisë. Pas kësaj, elita sunduese i shpalli muslimanët tradhtarë dhe i nënshtroi ata me ekzekutime masive. Ndërkohë, sipas raporteve të Amnesty International, në vitin 1968 Suharto, i përkrahur nga SHBA-të, u bë kryetar dhe masakroi një milion njerëz.

Deri në vitin 1998 kur Suharto u bë kryetar për të shtatën herë, korrupsioni pothuaj ishte endemik në Indonezi, me në krye Suharton që aplikon nepotizmin në epërsi maksimale. Tradhtimi i fundit i besimit publik nxiti trazira, sepse regjimi mizor dhe shqetësimi ekonomik pothuaj se dëmtuan masën. Ngritja e imponuar e çmimeve prej 100% në produktet konsumuese, ishte fitili ndezës për masën e cili u hodh në trazira të rënda në rrugët e Xhakartës. Administrata ushtarake u orvat që të qetësojë këtë revoltë me armë zjarri dhe masakroi mijëra njerëz. Sidoqoftë, objektiva e vetme e publikut, ishte që të arrij kushte më të mira jetese dhe të lirohej nga mizoria dhe shtypja.

Madje as rënja e Suhartos nuk përmirësoi situatën ose rikthimin e rendit në Indonezi. Përkundër shumë

E faraoni tha:

“I besuat atij (Musait) para se t’ju lejoja unë? Kjo është një dredhi që ju e përgatitët në qytet (Misir) për t’i dëbuar prej tij banorët e tij (kibtët), po më vonë do ta kuptoni (çka do t’ju gjejë). Kam për t’ua prerë duartë dhe këmbët tërthorazi, pastaj të gjithë juve do t’ju gozhdoj. (Surja A’raf: 123-124)



Killings continue in Indonesia

Poso, a town located 205km east of Palu, capital of Central Sulawesi Province, was mourning earlier this month when they heard the news of a massacre of Muslim students at the village of Togolu, sub district Lage of Poso. Hundreds were killed at the end of May, at

on May 28.

According to several eyewitnesses, who were interviewed by *Antara*, the attacks caused the deaths of many students and several of them led to the jungles nearby. The eyewitnesses could not even find the remains of victims under

The Muslim News, 30 qershor 2000



DESCENT INTO MADNESS

Riven by ethnic and religious hatred, Indonesia is slipping out of control

By NICK MCKENZIE

Indonesia has descended into hell since the end of the Suharto era. The last 18 months have been a descent into madness. The country has been plunged into a state of chaos and violence. The people are suffering and the government is unable to control the situation. The violence has spread to many parts of the country, and the death toll is rising. The people are desperate for peace and stability.

Time, 7 dhjetor 1998



Më 1968, gjenerali Suharto, i mbështetur nga SHBA-të, u bë president dhe, sipas raporteve të Amnesty International masakroi një milion njerëz. Në këtë vend, siç e tregojnë edhe fotografitë dhuna dhe mizoritë kanë rënë mbi muslimanët edhe pse ata janë shumicë.

masave administrative të suksesshme, konflikti në vend nuk pushoi kurrë.

Mënyra e vetme për të siguruar një ambient të lirë nga jokorrektetitë e tillë, dhuna dhe parregullsia, siç është përmendur vazhdimisht në këtë libër, është të jetuarit sipas Kuranit dhe Sunetit. Kjo për arsyen se të jetuarit sipas mënyrës kuranore e largon pabarazinë ekonomike, gjë që është në papajtueshmëri me idetë konfliktuozë, padrejtësinë dhe dhunën. Mungesa e këtij vullneti siguron një ambient ku askush nuk do të trajtohet brutalisht.


Komunitetet muslimane të cilave iu janë ndërprerë të gjitha lidhjet me botën: Turqit Uigurë në Turkistanin Lindor

Për shumë njerëz Turkistani Lindor sigurisht është vend i njohur pak. Ai përfshin një zonë sa dy herë hapësira e Turqisë. Pjesa tjetër e botës është e panjohur me mizoritë ndaj të drejtave të njeriut të kryera nga regjimi komunist kinez kundrejt muslimanëve, të cilët vetëm duan të kryejnë obligimet e tyre fetare. E drejta për të dalë ose për të pasë qasje në territoret e këtij komuniteti musliman turk, thjeshtë mohohet. Komuniteti musliman janë Uigurët, por sipas Kinës kjo quhet provinca Xinjiang. Edhe pse s'ka gjasa të jetë një shifër e saktë, sipas asaj që thuhet nga institucionet relevante dhe sipas raporteve të shoqatave, popullsia e provincës numëron prej 20 deri në 30 milionë njerëz. Muslimanët pohojnë se Kina minimizon me qëllim popullsinë e saj, sepse siç indikojnë statistikat, në Kinë, ka ende më shumë muslimanë.

Burimet natyrore shpjegojnë pse Kina i kushton aq shumë rëndësi Turkistanit Lindor. Ekzistenca e shtresës së pasur me naftë Brenda kufinjve të Turkistanit Lindor është faktor kryesor interesi, kurse hulumtimet më të reja kanë zbuluar burime të tjera naftë. Burimet zyrtare



Raport i Amnesti International



Chinese Muslim to be deported

A Chinese Muslim suspected of having links with separatist Uighur Chinese Muslims was told he would be deported to China on June 13. A senior government official said that Di Yisikan Da Daier would be deported from Pakistan by an Urumqi-bound flight from Islamabad. Urumqi is the capital of China's oil-rich northwest.

to the investigations said.

The official said that Pakistan shared Chinese concerns and the deportation of the Chinese national gave ample proof of Islamabad's commitment to do whatever needed to allay Beijing's apprehensions. Di had arrived in Pakistan on a valid visa but had travelled to Afghanistan without valid travel documents. Investigators said that the Chinese national had torn from his passport the page con-

Muslim Observer, 22 qershor 2001

Chinese Muslim Sentenced to Death

A Muslim who received military training abroad has been sentenced to death.

An official of the Intermediate People's Court confirmed that Imit was sentenced to death, but wouldn't give details. The official gave his name.

Separatist rebels have been waging a

Muslim Observer, 15 qershor 2001

Gjenocidi në Turkistanin Lindor, vend që mbetet brenda territorit kinez, soars. Gratë që mblidhen në xhami dërgohen në selitë kryesore të sigurimit, rrahen dhe zakonisht torturohen deri në vdekje nga ushtarët kinezë. Arrestimet e torturat pothuaj nuk pushojnë kurrë. Ndërmjet 4-7 shkurtit të vitit 1997, për vetëm tri ditë, qenë arrestuar 3,500 Uigurë dhe qenë dërguar në kampe përqëndrimi. Në vitin 1997, u arrestuan më shumë se 70.000 njerëz. Kërcënimet dhe dhuna kundër Uigurëve morën formë të ndryshme: sterilizimin, abortimet masive, testet nukleare, parregullsitë e shkaktuara nga kolonët kinezë, papunësia, ndalesa për përmbushjen e obligimeve fetare, pengimi i arsimimit dhe burgosja e adoleshentëve.

kineze kanë konfirmuar ekzistencën e 20 deri në 40 miliardë tonelata naftë në rajon. Disa kompani perëndimore të naftës pohojnë se rezervat janë mjaft të pasura për t'u krahasuar me rezervat e Arabisë Saudite.

Turkistani Lindor ka qenë nën sovranitetin e Kinës për rreth 250 vjet. Kina nuk ka pranuar kurrë të drejtën e banorëve të Turkistanit Lindor për pavarësi dhe secilën iniciativë për pavarësi e ka ndëshkuar me shtypje. Thjeshtë, Kina e ka pranuar Turkistanin Lindor, një territor musliman, si provincë të aneksuar në territoret e veta. Në vitin 1949, marrja e pushtetit nga Mao në Kinë udhëhoqi drejt një shtypjeje më të madhe në Turkistan. Muslimanët që i rezistuan politikave asimiliuese të ndjekura nga Kina, u

masakruan brutalisht kurse të drejtat e tyre u mohuan. Nga viti 1949 e deri më sot, janë vrarë rreth 35 milion njerëz. Ndërkohë, torturimi, çdo formë e dhunës dhe shtypja e dhunshme janë pjesë përbërëse e jetës së përditshme për ata që kanë mbetur aty. Njerëzit janë varrosur të gjallë dhe gratë janë dhunuar...Në vitin 1953, muslimanët paraqisnin 75% të popullsisë ndërsa kinezët përbënin 6%. Në vitin 1990, kjo gjendje ndryshoi në të mirë të kinezëve. Popullsia kineze përbënte 53% ndërsa popullsia muslimane ra në 40%. Vetëm këto shifra shpjegojnë dimensionet e gjenocidit, të kryer kundër muslimanëve, në Turkistanin Lindor.

Ajo nëpër të cilën kaluan njerëzit në Turkistanin Lindor sigurisht nuk dallon nga ajo që u ndodhi muslimanëve në Bosnjë e Kosovë. Dallimi i vetëm i Turkistanit Lindor është të qenit një rajon ku komunikimi me pjesën tjetër të botës është i bllokuar tërësisht dhe prej ku është shumë vështirë të nxirret çfarëdo informacioni. Kina, me sukses, i është përkushtuar orvatjeve për të mbajtur të pa raportuara mizoritë e kryera në Turkistanin Lindor, e me këtë synim, madje mban nën kontroll të rreptë edhe internetin. Në anën tjetër, bota, mbyll sytë ndaj përvojës së rëndë e të tmerrshme të cilës i nënshtrohen njerëz të pafajshëm e të pambrojtur në këtë rajon dhe e konsideron këtë si problem kombëtar të Kinës. Gjenocidi në Turkistanin Lindor shpjegon “vlerën” e jetës njerëzore në vendet si Kina, ku sundon mosbesimi. Nën ndikimin e këtij sistemi mbizotërues, njerëzit nuk shohin asnjë arsye se pse nuk duhet vrarë njerëzit që nuk mendojnë njësoj si ata, ose të kryejnë eksperimente në ta dhe t'i torturojnë ata pamëshirshëm.

Një vend i varfër i mbuluar nga oazat: Çadi

Pasi që Çadi, një vend me shumicë muslimane, fitoi pavarësinë, pushtetin në vend e morën të krishterët. Ministrinë qenë ndarë baras midis të krishterëve e muslimanëve. Sidoqoftë, në vend kishte dy milionë muslimanë dhe vetëm tetëqind mijë të krishterë.

Përplasjet e para filluan kur udhëheqësit e krishterë, të cilët tashmë kishin lidhje të forta me ish kolonizatorët e dikurshëm, vendosën raporte



(Majtas) Mizoritë e tmerrshme të kryera kundër civilëve nga Cadi.

diplomatike me Izraelin. Çadianët muslimanë kupohet që ishin të ndjeshëm ndaj kësaj çështjeje, për shkak të incidenteve që po ndodhnin në Palestinë dhe e perceptuan aleancën politike me Izraelin si tradhti ndaj Palestinës. Ndërkohë, kuadri musliman në qeveri mori pozicion kundër Izraelit, por kjo politikë i kushtoi ministrave muslimanë me pozitën e tyre në qeveri. Një mëngjes, të gjithë ata u dëbuan. Shumë nga ta u arrestuan, u burgosën kurse pasuria e tyre u konfiskua. Këto incidente shpunë në një periudhë shtypjeje të muslimanëve dhe pasuan kryengritje të pasuksesshme që morën jetën e një mijë njerëzve dhe lanë të plagosur me mijëra.

Filipinet

Në fillim të shekullit të 20-të, Filipinet ranë nën kontrollin e SHBA-ve, dhe në vitin 1946, asaj iu dha pavarësia. Duke pasuar tërheqjen e Amerikës nga ishulli, filipinezët që u ishin nënshtruar interesave të SHBA-ve erdhën në fuqi, kurse muslimanët ranë nën udhëheqjen e tyre. Për regjimin e filipinezëve ishte fundamentale politika e konfiskimit të tokave të muslimanëve, bazuar në strategjinë e tyre të konsolidimit të pushtetit në ishull. Për këtë, qe miratuar ligji që rregullonte ndarjen e tokave midis filipinezëve e muslimanëve. Sipas ligjit, muslimanët mund të pranonin vetëm një të tretën e tokës për të cilën ishte titullar filipinezi. Kjo politikë siguroi vendosjen e 3.5 milionë emigrantëve filipinezë në tokat e muslimanëve, duke ndezur kështu shkëndijat e konfliktit midis



Diktatori Markos I Filipineve (majtas). Regjimi I Markosit nisi një operacion të asimilimit të muslimanëve. (djathtas) Muslimanë të nënshtruar dhunës.

muslimanëve e filipinezëve. Muslimanët, në ndjekje të të drejtave të tyre, deshën të hyjnë në kompromis me kryetarin Ferdinand Markos por nuk ia dolën. Regjimi i Markos nisi një aksion për të asimiluar muslimanët. Përmes ngritjes së pagave e promovimeve selektive, Markos i shndërroi forcat e armatosura në makinë të tij personale, suspendoi implementimin e ligjit kushtetues dhe e zëvendësoi atë me ligjin ushtarak.

Fronti Kombëtar Moro i (lirimit (FKM) luftoi në interes të muslimanëve dhe në konfliktet e përgjakshme humbën jetën më shumë se pesëdhjetëmijë muslimanë, shumica prej tyre civilë. Mijëra gra, fëmijë e pleq u vranë. Ekipet e trajnuara në mënyrë speciale ishin krijuar që të zhdukjin muslimanët. Këto ishin guerila të egra, që shkuan shumë larg në dhunë, siç është thyerja e kafkave të viktimave të tyre ose pirja e gjakut të tyre. Ata përdorën teknika speciale të torturimit për çdo viktimë, dhe pas vrasjes ia konfiskonin tërë pasurinë.

Udhëheqësit vijues, pas Markos vazhduan me politikat e njëjta brutale dhe kryen gjenocid të njëjtë etnik.

Libani

Konfliktet e përgjakshme dhe luftërat po shkatërrojnë vendet muslimane në tërë globin. Dihet që më së shumti kjo gjakderdhje po zgjat në rezistencën palestineze ndaj invazionit izraelit. Ky invazion i kryer nga Izraeli dhe I përkrahur nga vendet perëndimore ishte sistematik, dhe la prapa vetes qindra mijëra të vdekur, shumë refugjatë dhe një histori të përgjakshme. Konfliktet, luftërat dhe masakrat reflektojnë pak nga ajo që kanë vuajtur civilët përgjatë invazionit izraelit.

Pas viteve 1950-ta, forcat e Izraelit bënë disa intervenime në vendin fqinj, Libanin. Izraeli ndezi zjarrin e konfliktit ndërmjet disa grupeve të caktuara brenda Libanit dhe këto grupe, që u përziën në luftën civile, mirëmbajtën lidhjet dhe siguruan mbështetjen nga Izraeli. Këto konflikte bënë që balanci i pushtetit në Liban të jetë mjaft i brishtë, duke bërë që vendin të hapur për invazion. Izraeli provokoi komunitetet që banonin në Liban: Maronitët, të krishterët, grekët e krishterë ortodoksë, muslimanët shiitë, sunitë e druzët, dhe gradualisht i mblodhi frutat e politikës së vet “përçaj e sundo” .

Strategjia që Izraeli e kishte planifikuar për 28 vjet mbaroi në vitin 1982 me invazionin aktual të Libanit. Lufta civile e ndau Bejrutin në rajone për secilin grup minoritar. Është interesant se secili minoritet fitoi mbështetje dhe mori armë nga Izraeli. Në veçanti, falangistët, që morën pushtetin, kishin lidhje të forta me Izraelin.

Lufta civile në Liban shpërtheu dukshëm, nga që palestinezët, të cilët u përzunë dhunshëm prej mbretit Hysen nga shteti Jordan, u vendosën në Liban. Të krishterët, të indoktrinuar nga nevoja për të përzënë palestinezët nga Libani, bënë një luftë të përzënjes së përgjithshme të palestinezëve. Të krishterët e muslimanët me sa duket ishin palë në këtë luftë, e megjithatë secila sërish ishte e ndarë përbrenda. Gjatë luftës, Izraeli filloi të shkelë kufirin libanez. Ndërkohë, siguria e Libanit me SHBA-të u prish dukshëm dhe Izraeli ktheu sulmin e Sirisë, një vend musliman, kundër Libanit.

Vendosja e pushtetit politik të Partisë falangiste përmes ndihmës së Izraelit ishte fillimi i një lufte të përgjakshme që shkatërroi Bejrutin. Palestinezët dhe libanezët muslimanë ishin objekt i shtypjes së madhe.

Invazioni i vitit 1978 çoi në mënyrë ultimative në invazionin e Libanit në vitin 1982. Libani u shndërrua në vend luftarak e të shkretëtuar. Ndërkohë, historia është dëshmitare e masakrave brutale falangiste të qindra civilëve palestinezë në kampet e refugjatëve në Sabra e Shatilla, që u bënë nën nxitjen dhe mbikëqyrjen e forcave izraelite.




In Israeli dungeons, ka ende shumë palestinezë që vuajnë në masë të madhe nga trajtime brutale e jonjerëzore. Pas çdo marrëveshjeje, autoritetet e Izraelit njoftojnë për lirimin e këtyre të kapurve por kurrë nuk përmbushin premtimin. Disa nga të orvatjet e të zënëve për të tërhequr vëmendjen e botës përmes grevave të urisë shpesh nuk kanë sukses sepse vendet e perëndimit janë të shurdhëra ndaj thirrjeve të tyre.

Bejrut, 1982



Bejrut, 1976

Një ndërtesë në Bejrut dhe gjendja e saj pas invazionit.



Masakrat nuk kufizohen vetëm ndaj muslimanëve.



Haiti

Historia e Haitit, vendi më I varfër në hemisferën perëndimore, është zhytur në çrregullime e mjerim. Haiti ishte nën okupimin amerikan nga viti 1915 deri më 1934. Pastaj Haiti deklaroi pavarësinë, vetëm në emër, meqë ky shtet që krijuar nën hijen e SHBA-ve me një kushtetutë detyruese të diktuar nga amerikanët. Ndërmjet viteve 1957 e 1986, Haiti drejtohej nga diktatura.

Në këtë periudhë, së pari mori zyrën Ati Duvalier e pastaj e trashëgoi i biri I tij, Jean-Claude Duvalier. Ata krijuan monopol dhe aleanca në të gjitha sektorët duke fituar miliarda nga ekonomia e Haitit. Duvalier krijoi regjim diktatorial si çdo shtet tjetër në afërsi. Në këtë vend të vogël, një njësi inteligjence e quajtur Leopardët dhe organizata sekrete e policisë, Tontons Mavoutes, e terrorizuan masën, duke kryer krime të tmerrshme masive. Si edhe në diktaturat e tjera, Duvalierët argëtoheshin në ekstravagancë përderisa masa jetonte në mjerim të madh. Nën pretekstin e çrregullimeve që mbizotëruan në vend nën sundimin e Duvalierëve, SHBA-të vunë në skenë krimin e organizuar në vitin 1994. Ky vend I vogël është një shembull tjetër tipik I pasojave të mungesës së besimit në shoqëri: dhunës, konflikteve, dhe çrregullimeve...

Shri Lankë

Një komb I ishullit në Oqeanin Indian në juglindje të Indisë, Shri Lankës, numëron 16 milion banorë. Shumica e njerëzve janë budistë sinhalezë (74%), 20% janë tamilë indianë. Sinhalezët kanë pushtetin në vend. Tamilët, që jetojnë në Shri Lankën veriore, kanë nisur luftën guerile në vitin 1980 kundër regjimit të sinhalezëve që u shndërrua në një luftë të përgjakshme civile që ende vazhdon.



Në Shri Lankë, madje edhe fëmijët e vegjël janë të involvuar në luftën civile.

“Zemërimi Fanatik”: Racizmi

Kur ata që nuk besuan ndezën në zemrat e tyre euforinë, dhe atë kryelartësi injorante (pagane), po All-llahu dhuroi qetësimin e Vet dhe ndaj të dërguarit të vet dhe ndaj besimtarëve dhe për ata zgjodhi besimin e drejtë (fjalinë: la ilahe il lell llah), pse ata ishin më me meritë për të dhe më të zotët e saj, e All-llahu është i Gjithëdijsëm për çdo send. (Surja Fath: 26)





Zemërimi ndaj racave të tjera është përgjegjës për shumicën e konflikteve, përplasjeve dhe luftrave civile në tërë botën. Në rastet e qasjes agresive, të pretenduar nga raca e bardhë kundrejt racës së zezë, ose idealeve nacistike të arritjes së krijimit të racës së pastër dhe konfliktit pasues me aleancën, gjë që mori jetën e miliona njerëzve në historinë e vonshme, ose në konfliktet mes fiseve afrikane, ne gjithmonë ndeshim një faktor të njëjtë: “inatin fanatik”.

Ky keqkuptim sygjeron se një racë e caktuar është, ose fizikisht ose mentalisht ose me të dyja, superiore ndaj tjetrës dhe se është e domosdoshme për racën superiore që të ketë ndjenja të mëshirës, dhembshurisë e respektit për tjetrën. Në raste ekstreme, kjo përsiatje e mendon madje si të gabuar edhe bashkëjetesën e këtyre racave. Kjo është, sidoqoftë, qasje e egër meqë çon në të menduarit se nuk ka ndonjë arsye që të ekzistojnë kombe të ndryshme, duke bërë kështu të detyrueshme eliminimin e racave “të ndryshme”.

Në Kuran, Allahu deklaroi se kombet dhe fiset e ndryshme ekzistojnë që “njerëzit të mund të njohin njëri tjetrin”.

Dallimet kombëtare, racore, fisnore e gjuhësore janë bukuri karakteristike e krijimit të Allahut. Është e papranueshme që një person të pësojë zemërimin e tjetrit vetëm sepse është më i shkurtër ose pse ka lëkurë më të zeshkët. Këto karakteristika janë të gjitha krijim i veçantë I Allahut, me bukuri të panumërta, qëllime e sekrete delikate brenda tyre. Siç është bërë e ditur në ajetin vijues, besimtari është i ndërgjegjshëm se kriteri i vetëm për fisnikëri është frika nga Allahu:

O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë. (Surja Huxhurat: 13)

Rrënjët pseudo-shkencore të keqkuptimit racist, që manifestohen me shumë brutalitet, kërkojnë një përmendje të veçantë, meqë ato janë edhe bazat në të cilat janë themeluar shumë ideologji të tashme të gabuara. Materializmi, komunizmi dhe kapitalizmi i egër, të gjitha i kanë rrënjët në baza pseudo-shkencore dhe marrin fuqi prej tyre.

Ky themelim pseudo-shkencor është e ashtuquajtura teori e evolucionit e Darvinit. Disa që kanë dëgjuar për « teorinë e evolucionit » mund të supozojnë se ka të bëjë vetëm me fushën e biologjisë. Teoria e evolucionit, sidoqoftë, paraqet më shumë se kaq. Duke mos qenë thjeshtë një koncept biologjik, ajo është e mbështjellur nga shumë filozofi që mbajnë nën ndikim e tyre masat e gjera.

Baza pseudo-shkencore e racizmit

Kur Darvini, e propozoi këtë teori për herë të parë, shkenctarët e kohës nuk e adoptuan atë plotësisht. Palaontologjistët, në veçanti, ishin të ndërgjegjshëm se teoria ishte më shumë se një pjellë e imagjinatës. Sidoqoftë, meqë teoria ofronte një themel ideologjik të padëgjuar për fuqitë që mbizotëronin në shekullin e 19-të, Darvini fitoi qasje në qarqet shkencore.

Meqë idea e evolucionit u përhap shpejt- përmes publikimit nga Darvini, të librit, *Origjina e llojeve* – evropianët vazhduan që të kolonializojnë kontinentet dhe civilizimet e tjera në pjesët e largëta të

botës. Duke qenë të parat, vendet evropiane- Anglia dhe Franca - koncentruan orvatjet e tyre, pjesërisht në Azinë Jugore dhe Amerikën Latine si dhe në kontinentin afrikan në tërësi. Ndërkohë, në Amerikën veriore, banorët autoktonë qenë therrur brutalisht. Shkurt, në pjesën e dytë të shekullit të 19-të, perandoritë perëndimore plaçkitën civilizimet në pjesët tjera të botës. Me dhunë e terror ata fituan pushtetin, për të cilin nuk kishin të drejtë aspak, dhe konfiskuan burimet natyrore të atyre vendeve. Kështu, perëndimorët e ndjenë thellë domosdoshmërinë e legjitimitetit të praktikave të tyre. Në këtë nivel, darvinizmi u ofroi një mundësi të madhe imperialistëve. Me këtë teori, u bë e mundshme të ofrohej themeli i “ashtuquajtur” shkencor ndaj idesë se njerëzit e eksploatuar ishin thjeshtë “lloje kafshësh”.

Darvini i ka bërë të qarta pikëpamjet e tij lidhur me origjinën e qenjes njerëzore në librin e tij *Prejardhja e njeriut* të publikuar në vitin 1871. Në këtë libër, ai me guxim ka komentuar se njeriu është zhvilluar nga paraardhës që duken sikur majmuni. Ai shkoi mëtutje dhe tha se racat



Jo vetëm te britanikët, por edhe te imperialistët e racistët nga kombet e tjera, darvinizmi social formonte një themel ideologjik. Kjo është arsyeja pse ajo lulëzoi aq shpejt. Një pasues i spikatur i darvinizmit ishte Teodor Ruzvelt, president amerikan që kreu spastrimin etnik të banorëve vendës të Amerikës.

ekzistuese njerëzore ishin të lokalizuara në nivele të ndryshme të “shkallëve të zhvillimit”, se racat evropiane ishin më të “përparuara” nga të gjitha, dhe se plot racat të tjera ende bartnin tipare majmuni.”

Teoria e darvinizmit kishte edhe një dimension tjetër të rëndësishëm. Darvini e bazonte zhvillimin e qenjeve të gjalla, përfshirë edhe qenjet njerëzore, në termin “lufta për mbijetesë”. Sipas tij, ka një betejë të egër, një konflikt të vazhdueshëm, që ekziston në natyrë. Në këtë luftë, të fortët gjithmonë mposhtin të dobët dhe kështu vjen deri te progresi.

Darvini pohonte se kjo “luftë e mbijetesës” është gjithashtu e vërtetë për racat njerëzore. Madje edhe nëntitulli në librin e tij *Origjina e llojeve e bëri të dukshëm këndvështrimin e tij racist.*

“Origjina e llojeve sipas mjeteve të selektimit natyror, ose ruajtja e racave të favorizuara në luftën për jetë.”

Sipas Darvinit, evropianët janë racë e favorizuar. Në anën tjetër, banorët vendorë të Amerikës, afrikanët dhe të gjitha racat dhe kombet e tjera përbëjnë racat primitive që mbetën prapa në procesin e zhvillimit. Sipas kësaj arsyeje të shtrembëruar, zbutja, të skllavëruarit e madje edhe vrasja e këtyre racave më të ulëta është legjitime, siç është legjitime që e njëjta t’u bëhet majmunëve ose kafshëve të tjera. Për të njëjtën arsye, Darvini mendonte, se atyre mund t’u konfiskohet pasuria. Në librin e tij, lidhur me racat e ulëta Darvini thotë sa vijon:

Në një të ardhme, jo shumë të largët siç matet me shekuj, racat e civilizuar të njerëzve gati se do të asgjësohen dhe do të zëvendësojnë racat e egra në tërë botën. Në të njëjtën kohë majmunët antropomorfus ...pa dyshim do të asgjësohen. Ndarja midis njeriut dhe aleatit të tij më të afërt atëherë do të jetë më e gjerë.¹⁶

Siç tregon ky qëndrim, Darvini qartas ishte një racist. Ai besonte se evropianët janë superiorë ndaj kombeve të tjera dhe kështu kanë të drejtë që t’i skllavërojnë e asgjësojnë ata.

Në këtë teori thirret social darvinizmi, një adaptim i teorisë së evolucionit të shoqërive. Në pjesën më të madhe, kjo e shtroi terrenin për legjitimimin e imperializimit e të racizmit. Një ndër vendet ku social darvinizmi është përqaftuar ngrohtë është Gjermania.

Masakra e pambarim e të zinjve dhe Ku Kluks Klani



Ku Kluks Klani, një shoqëri secrete e organizuar në SHBA pas luftës civile për të risiguruar supremacinë e të bardhëve me mjete të terrorizmit, është përgjegjëse për vrasjen e mijërave burrave, grave e fëmijëve. Ky grup, anëtarët e të cilit përdorin dhunën kundër të tjerëve vetëm sepse ata i takojnë racës tjetër, është një shembull tjetër i mizorisë dhe çrregullimeve që përhapen në shoqëri në mungesë të moraleve të Kuranit. Fakti që mizori të tilla paraqiten ende në shekullin 21 është diçka për të cilën duhet menduar.



Këto episode të dhunës kundër të zinjve kanë ndodhur në vitet 1900-ta. Në ditët tona do të ishte e lehtë për ta ndaluar këtë sikur njerëzit të jetonin sipas vlerave të Kuranit.

Nacizmi e Darwinizmi

Nuk është rastësi që neo-nazistët janë të inspiruar nga teoria e evolucionit e Darvinit, meqë që nga dita kur është konceptuar, darvinizmi ka qenë gjithmonë një pjesë e pandashme e ideologjisë nacistë.

Nacizmi ka lindur në Gjermaninë e mposhtur pas Luftës së Parë Botërore. Një ndër themeluesit dhe liderët e Partisë Nacistë, Adolph Hitler, ishte një njeri ambicioz dhe agresiv i cili një pjesë të pikëpamjeve të tija i bazoi në racizëm. Hitleri vendosmërisht besonte në “racën zotëruese” ariane dhe sipas tij kjo ishte raca që duhej të udhëhiqte të gjitha kombet e tjera. Hitleri ia përkushtoi veten krijimit të pan-Gjermanisë “Rajhut të Tretë”, që do të zgjaste me mijëra vite. Baza shkencore e teorisë raciste të Hitlerit ishte teoria e evolucionit e Darvinit.

Hitleri ishte i ndikuar thellë nga Heinrich von Treitschke, një historian racist gjerman i cili poashtu zhvilloi pikëpamjet e tija raciste nën ndikimin e teorisë së evolucionit të Darvinit. Fjalët vijuese të Treitschke-s shpalosin pozitën e tij ndaj racave tjera.

Racat e verdha nuk kanë mirëkuptim për aftësitë artistike dhe lirinë politike. Është fati i racave të zeza që të shërbejnë të bardhët dhe që të jenë cak i paqejfit të të bardhëve për tërë përjetësinë...¹⁷

Derisa formulonte teorinë e tij, Hitler nxorri idenë për luftën e mbijetesës nga ideja e Darvinit. Emri i librit të tij të njohur *Mein Kampf* (*Lufta ime*), ishte një inspirim që Hitleri nxorri nga ideja e Darvinit për luftën për ekzistencë. Hitler ndau pikëpamjet e Darvinit lidhur me racat dhe, sikurse ai, i konsideroi racat joeuropiane si krijesa të ngjashme me majmunët:

Hiqi gjermanët nordikë dhe s'mbetet tjetër përveç valles së majmunëve.¹⁸

Pikëpamjet e evolucioniste të nacistëve çuan në adaptimin e një pjese të konceptit të “eugenics”, që do të thotë “shkenca e përmirësimit të (esp. njerëzor) popullsisë përmes kontrollit të edukimit mbi karakteristikat e dëshirueshme të trashëguara.” Sidoqoftë, nacistët kujtohen më shumë për konceptin, që madje në atë kohë mbizotëroi edhe në të ashtuquajturat shoqëri liberale siç ishte Suedia, e sipas të cilit mënyra më e mirë për të



Hitleri ishte një diktator absolut. Kjo është manifestuar në fjalët e tij, "secili duhet ta dijë se ai që revoltohet kundër meje duhet ta konsiderojë veten të vdekur" që u publikua në gazetat e kohës së tij.



Emri i librit Mein Kampf, ishte një inspirim që Hitleri e mori nga ideja e darvinizmit për luftën për mbijetesë.

parandaluar të paaftët e të sëmurët mentalë nga çiftimi, ishte sterilizimi, nëse kjo do të ishte e domosdoshme. Siç mund të supozohet, ata që propozuan teorinë ishin darvinistë: Leonard Darvini, biri i Charles Darvinit dhe kushëriri i tij Francis Galton.

Në Gjermani, Earnst Haeckel, biologjist evolucionist i njohur, u bë zbatues i parë dhe propagator i "eugenics." Haeckel, mik i ngushtë i Darvinit, vazhdimisht e furnizonte atë me pikëpamje, e një ndër to ishte edhe përshpejtimi i procesit të evoluimit duke i vrarë foshnjat e paafta. Një ide tjetër e Haeckelit ishte vrasja e padhembje e pacientëve që vuanin nga leproza e kanceri, si dhe të atyre me shqetësime mentale. Ndryshe, mendonte ai, këta njerëz do të vazhdojnë të jenë barrë për shoqërinë.

Kur Hitleri mori pushtetin, ai inkorporoi këto pikëpamje të Haeckelit në politikë zyrtare, që rezultoi me internime të menjëhershme në qendra



Kampi I trupave italiane në Etiopi.

Besimi I prishur se njerëzimi do të përmirësohet përmes konflikteve e dhunës u bë burim I ideologjisë së tyre. Për shembull, në orvatjet e tij për të themeluar Italinë fashiste Benito Musolini ndjelli konceptet darviniste. Ai e vlerësoi invadimin e Etiopisë në saje të qëllimit të klerarkisë racore të propozuar nga darvinizmi.



të veçanta të të sëmureve mentalë, të të paaftëve, të të verbërve dhe të atyre që kishin sëmundje trashëguese. Nga kjo pikëpamje e e shtrembër, këta njerëz konsideroheshin faktorë që "ndotnin" pastërtinë e racës ariane dhe vononin "të ashtuquajturin" progres të tij të evoluimit. Pas mbajtjes në izolim të këtyre kategorive të njerëzve nga shoqëria për një kohë, sipas një ligji konfidencial të urdhëruar nga Hitleri, nacistët përvetësuan të drejtën për të vlarë ata në mënyrë sekrete.

Pas mposhtjes në Luftën e Dytë Botërore, "Rajhu i Tretë" u bë histori, duke lënë prapa miliona njerëz të pafajshëm por të shkatërruar. Por, darvinizmi social, që ofroi bazën e ideologjisë nacistë, mbeti.

Shumë njerëz janë në dijeni se për çka u fol deri tani. Sidoqoftë, mbetet fakti se vetëm disa kanë kuptuar se këto ngjarje historike kanë jehonë të vazhdueshme. Ekzekutimet e dhunshme e të pamëshirshme të njerëzve për shkak të gjendjes së tyre mentale e fizike shpalosin shpirtin e sëmure

Tretmani që e marrin të paaftët



Ernst Haeckel

Në fillim të viteve 1900's, qe përhapur një propagandë botërore. Kjo propagandë e filluar nga Ernst Haeckel një biolog evolucionist, synonte të përshpejtonte të ashtuquajturin procesin evolutiv të shoqërive. Sipas Haeckel, vrasja e menjëhershme e fëmijëve të paaftë që në lindje do të siguronte një evoluim të shpejtë të racës. Haeckel shkoi edhe më larg duke thënë se të paaftët, pacientët me kancer dhe ata me çrregullime mentale duhet të ekzekutohen në

mënyrë secrete meqë ekzistenca e tyre ishte barrë e madhe për shoqëritë. Si pasojë e kësaj, pohonte ai, ata janë pengesë për procesin evolutiv të shoqërive. Një jehonë sot të këtyre pikëpamjeve të mbështetura nga idetë e Darvinit për "betejën e më të fortëve" është mënyra e trajtimit të të moshuarve në shoqëri.

Në shumë vende, të paaftët i nënshtrohen tretmanit të ndarë. Sidoqoftë, secili meriton dashuri e respect dhe ky fakt nuk ndërron kur një ose dy organe të njeriut janë të pabarabartë ose kur organi mungon. Ajo që e bën qenjen njerëzore person është mënyra e karakterit të tij, frika e tij nga Allahu dhe saktësia në përmbushjen e urdhërave të Allahut. Allahu i liron të paaftët nga përgjegjësitë e tyre dhe i mban ata përgjegjës vetëm për dëgjueshmëri dhe sjellje të moralshme. Secili duhet t'i qaset këtyre robërve të Allahut me dhembshuri e mirëkuptim, sepse Allahu ndien dhembshuri për ta dhe u garanton atyre lehtësi në robërinë ndaj tij.

Nuk është mëkat (të ngelë pa dalë) për të verbërin, për të çalin, e as për të sëmurin. E kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, Ai atë e shtie në Xhennete ku rrjedhin lunenjë, e kush ngel prapa, Ai atë e ndëshkon me një dënim të dhembshëm. (Surja Fet'h: 17)



Në shumë shoqëri, fëmijët me aftësi të kufizuara janë të izoluar nga shoqëria. (Lart) Një fëmijë me aftësi të kufizuara me duart e lidhura.

e të prishur të kryesve të vet. Mosbesimin e kanë shpirtrat e sëmurë e të prishur. Sa kohë që të mbizotërojë mosbesimi, mund të pritet çdo formë e abnormales, pamëshirës dhe sjelljes së prishur. Ekzistenca e miliona pasuesve të drejtuar në rrugë të humbur nga këta njerëz mendje- sëmurë është një shenjë tjetër e mosbesimit.

Personi që i frikësohet Allahut dhe e vë besimin e tij te Ai, e di që Ai është i Gjithëmëshirshmi, dhe nuk priret kurrë për mizori e prapësi. Për më shumë, ai me kurajo e zell mundohet që të ruajë njerëzit e tjerë nga skllavërimi i tiranëve, dhe që t'u tregojë atyre rrugën e drejtë e t'i paralajmërojë. Për shembull, profeti Musa, paqja qoftë mbi të, luftoi i vetëm kundër faraonit, që kishte të njëjtin mentalitet diktatorial racist e mizor si Hitleri e Musolini, dhe mbrojti fëmijët e Izraelit nga sundimi i tij brutal. Ajo që e bëri profetin Musa aq kurajoz ishte thjeshtë besimi i thellë në Allahun dhe vlerat e ndërgjegjja që ia ofroi besimi atij. Mënyra se si Musa i drejtohej faraonit tregon qartë besimin e tij në Allah dhe mënyrën se si e vënte ai besimin e tij në Të:

Mandëj pas tyre dërgam Musain me mrekulli të argumentuara te faraoni dhe rrethi i tij, e ata i refuzuan ato, e shih se si ishte përfudimi i shkatruesve? Musai tha: O faraon, s'ka dyshim, unë jam i dërguar prej Zotit të botëve". Është dinjitet për mua ta them për All-llahun vetëm të vërtetën. Unë u kam ardhur me argumente nga Zoti juaj, lejoi pra beni israilët të vijnë me mua!" (Surja A'raf: 103-105)

Vitet e dhunës që "racizmi" I solli kontinentit afrikan

Për shumë vite, kontinenti afrikan ka vuajtur nga konfliktet, luftrat, uria e mjerimi. Për shkak të konfliktit të interesave të ngritura për shkak të mos zbatimit të religjionit dhe të besimeve të tjera jo të drejta, mosmarrëveshjet janë të vazhdueshme në rajon. Deri në vitet e pesëdhjeta, njerëzit e këtij kontinenti vuajtën nga të gjitha format e dhunës dhe politikat raciste që imponuan vendet imperialiste. Në vitet e pesëdhjeta, gjatë tërë kontinentit, kishte vetëm katër shtetet të pavarura zyrtarisht. Në vitin 1962 kjo shifër u ngrit në tridhjetë. Definitivisht, në vitin 1972, kontinenti u bë i pavarur, me disa përjashtime. Sidoqoftë, për


publikun, pavarësia ishte më shumë një fasadë, meqë fuqitë ish imperialiste thjeshtë u zëvendësuan nga dikatorët autoritativë, shtypës e mizorë, të cilët mbanin lidhje të ngushta me fuqitë ish imperialiste, që do të thotë me vendet e sotme perëndimore. Sëkëndejmi, pavarësia nuk u solli lirinë këtyre vendeve por i bëri që të vuajnë varfëri e dhunë të madhe nën regjime edhe më shtypëse se sa ato kolonialiste. Nën këto rrethana njerëzit u bashkuan për të luftuar kundër regjimeve diktatoriale. Ndërkohë, dikatorët provokuan disa grupe etnike, destabilizuan vendet e tyre fituan përparësi ndaj këtyre çrregullimeve.

Në Zaire, lufta midis dy fiseve të saja, Hutuve e Tutsive, është një shembull tipik i konflikteve që ndodhin ndër raca në shekullin e 20-të. Dy fiset u përfshinë në luftë në pranverë të vitit 1997. Efekti i konfliktit u përhap në pesë rajone, përfshirë Zairenë, Ruandën, Ugandën, Burundin e Tanzaninë.

Në këtë rajon të bërë shoshë nga korrupsioni, pavarësia e vitit 1960 vështirë që solli ndonjë lehtësim nga shtypja politike e shteteve imperialiste perëndimore. Joseph Mobutu, i mbështetur nga SHBA-të, mori pushtetin në vitin 1964 dhe i la të gjitha burimet natyrore të vendit të tij në dispozicion të Amerikës. Duke mos lënë asgjë që të kontribuojë në mirëqenjen e njerëzve të tij, gjatë viteve Mobutu vetëm akumuloi pasuri personale dhe e drejtoi atë ndaj masave despotike për të shtypur njerëzit e tij. Në kohën kur

Mobutu u ka paguar \$12,000 secilit prej ministrave të tij përderisa mësuesit fitonin vetëm \$8 në muaj. Pasuria e tij personale, duke përjashtuar patundshmërinë, ishte rreth \$5,000,000.





Për shkak të mosushqyeshmërisë, më shumë se një e treta e popullatës së Zairesë është duke vdekur, derisa shumë fëmijë vuajnë nga dëmtimet e përhershme të trurit. E tërë popullsia, prej 30 milion njerëzve, gjysma e të cilëve fëmijë, jeton në uri në kasolle prej balte.



Për tri vjet, katërqindmijë refugjatë I rezistuan vdekjes në kampet primitive të refugjatëve në kufirin e Zairisë. Uria është bërë pjesë e jetës së përditshme, krahas kërcënimit nga kolera e cila ka shtuar mjerimin në jetën e këtyre kampeve të refugjatëve. Asnjë ndihmë nuk u është dhënë këtyre njerëzve të varfër, dhe edhe nëse kjo ka ndodhur, është konfiskuar nga ushëtarët. Ndërkohë, askush nuk mund t'i paramendojë që Hututë e Tutsitë, dy fiset që brutalisht e vranë njëri tjetrin, që të ndajnë ndihmat në mënyrë paqësore. Minimumi dhjetë foshnja vdisnin në çdo orë, në Goma, një qytet në Zairs, për shkak se ndihma mjekësore ishte konfiskuar.

shkalla e inflacionit në vend tentonte vlerën kulmore prej 6000%, ndërmjet dy fiseve dominuese në rajon shpërthyen përplasje të mëdha. Kjo luftë fisnore rezultoi në gjenocid të madh që la pas vetes gati gjysmë milioni të vdekur. Mijëra emigrantë iu nënshtruan përvojave të tmerrshme nëpër pyje, dhe në fund shumica e humbën jetën nga uria dhe epidemitë. Njerëz të pafajshëm qenë masakruar. Vetëm pse ishin nga një fis tjetër, qenë vrarë madje edhe foshnja e fëmijë shumë të vegjël.

Luftrat ndërmjet racave, do të thotë "inatit fanatik" që përmendet në Kuran, shpesh mbaron me skena gjuetie të masakrave. Allahu, në Kuran na tërheq vërejtjen ndaj "inatit fanatik" të njerëzve injorantë siç vijon:



Në Zair, dimensionet e korrupsionet tejkalojnë imagjinatën tonë. Madje edhe ndihma e ofruar për njerëzit e uritur që shitur për të blerë armë.

Refugjatët Hutu, duke ikur nga konflikti ndërmjet forcave qeveritare të Zairesë dhe Tutsive, konflikt ky që u përhap edhe në vendet fqinje. Ky imigrim ishte një tragjedi e madhe njerëzore.

Në vitin 1994, luftimet midis fisit Tutsi, një fis me lidhje të forta me kulturën britanike të trashëguar nga periudha e kolonializmit, dhe fisit Hutu kushtoi me rreth 500,000 jetëra të Tutsive. Në vitin 1996, Hutu-të ikën në Ruandë nga represioni i udhëheqësve despotikë Zairianë dhe nga masakrat e Tutsive. Në nevojë për një thellë buke, refugjatët ishin të pavetëdijshëm për rreziqet që po i prisnin në rrugën e tyre për në Ruandë.

Kur ata që nuk besuan ndezën në zemrat e tyre euforinë, dhe atë kryelartësi injorante (pagane), po All-llahu dhuroi qetësimin e Vet dhe ndaj të dërguarit të vet dhe ndaj besimtarëve dhe për ata zgjodhi besimin e drejtë (fjalinë: la ilahe il lell ilah), pse ata ishin më me meritë për të dhe më të zotët e saj, e All-llahu është i Gjithëdijshëm për çdo send. (Surja Fath: 26)

Këtë shprehje të errët të mosbesimit e kanë ekspozuar lëvizjet raciste, si në Afrikë si në vendet e tjera të botës. Për ta larguar atë plotësisht është e mundur vetëm duke jetuar sipas parimeve të religjionit të drejtë dhe duke i bërë të tjeërt që t'u binden atyre.

Mizoritë e Çrregullimet Në Shoqëritë Jobesimtare

*Sikur All-llahu t'i
dënonte njerëzit
(zullumqarë) për shkak të
mizorisë së tyre, nuk do
të linte mbi të (tokë)
asnjë gjallesë, por Ai i lë
ata për më vonë deri në
aftin e caktuar, e kur të
vijë afati i tyre, për asnjë
moment nuk mund ta
vonojnë as ta ngutin.
(Surja Nahl: 61)*





Siç analizuam në kapitujt e mëhershëm, në të gjitha skajet e botës, Kosovë, Kashmir, Palestinë, Çeçeni e në vende të tjera, muslimanët i janë ekspozuar mizorive të pandërprera e të pamëshirshme dhe telasheve të pambarim. Nga mënyra se si u zhvillua e tëra do të ishte gabim të mendohej se ato nuk korresponduan me njëra tjetër. Në anën tjetër, të mveshurit e këtyre përplasjeve veçorive natyrore politike e gjeografike të vendeve individuale do të tregonte se ky është një moskuptim. Çdo luftë dhe dhunë që shfaqet në historinë botërore, pavarësisht se ku ndodh kjo, indikon ekzistencën e njerzve që fitojnë epërsi mbi ta. Të gjithë muslimanët duhet të shohin e të jenë të paralajmëruar për këto incidente. Përndryshe, rrezikohet që ngjarjet botërore të shihen si aksidente spontane që nuk kërkojnë zgjidhje. Në hadith, profeti i Allahut, profeti Muhamed i referohet poashtu tiranisë, duke thënë se do të jetë *“errësirë në Ditën e Ringjalljes”*.¹⁹

Shekulli I 20-të ka qenë veçanërisht i shënuar nga brutaliteti i papresedencë. Të gjitha lëvizjet që mbështesnin luftërat dhe brutalitetin, siç është komunizmi-që përkrah filozofinë materialiste dhe e refuzon në tërësi religjionin, vlerat morale e


familjen- ishte kryesori. Në vendet ku ka kontroll komunizmi, historia ofron evidencë më se të mjaftueshme se çfarë jete të përçmuar u ofron shoqërive mosbesimi. Që të ketë një pasqyrë më të qartë për këtë sistem brutal, do të mjaftojë vetëm një shikim i shkurtër në histori dhe në situatën aktuale në Rusi, një vend që mbeti nën sundimin komunist për dekada.

Gjurmët e komunizmit- një system i bazuar në mosbesim-në histori

Marks dhe Engelsi, themeluesit e materializmit dialektik dhe mentorët e komunizmit, ishin që të dy ateistë të devotshëm. Duke pohuar se të gjitha format e përmirësimit në botë janë të arritshme përmes konfliktit, ata besonin se do të arrinin qëllimet e tyre vetëm përmes revolucionit komunist. Që të dy ndjenin armiqësi të thellë ndaj religjionit, kurse ne pamë se eliminimi i religjionit është kusht paraprak për mbizotërimin e pikëpamjeve të tyre. Marks dhe Engelsi besonin se lëvizja komuniste ndonjëherë do të mund të nxisë besimin e dikujt në Zot prandaj pengesa e quajtur religjion u eliminua. Marks kurrë nuk qe i zoti për të vënë pikëpamjet e tij në praktikë. Pas vdekjes së tij, revolucionin e udhëhoqi Lenini.

Lenini, i cili fitoi pushtetin pas luftës së përgjakshme civile ndërmjet militantëve komunistë dhe mbeturinave të armatave aristokratike, paralajmëroi politikën që do të ndiqej nën sundimin e tij. Në këtë kohë, ata që i rezistonin atij dhe sistemit

**Karl Marks dhe
Fridrih Engels**




komunist u ekzekutuan. Lufta civile zgjati tri vjet, dhe solli shkatërrim të tërësishëm të Rusisë. Pas kësaj lufte të përgjakshme, Lenini themeloi diktaturën e parë totalitare një partiake në botë.

Koha e Leninit ishte e një shkatërrimi të përgjithshëm të Rusisë, veçanërisht sa i përket ekonomisë; taksa shtesë iu shtuan njerëzve që tashmë ishin të varfër. Uria dhe mjerimi u rritën vazhdimisht. Politika e tij solli nacionalizimin e gjerë, racionin ushqimor, dhe kontrollin mbi industri, dhe më askush nuk guxonte të merrte përsipër rrezikun e rezistimit të politikave të tij, meqë të gjithë e dinin fundin e atyre që vetëm kishin tentuar këtë gjë.

Deri në vitin 1924, kur vdiq Lenini, politikat që ai ndjeku i siguruan urrejtje të fuqishme nga njerëzit, përfshirë shokët e tij më të afërt. Zëvendësi i tij i radhës në Partinë Komuniste ishte Stalini, diktatori më i përgjakshëm që njeh historia botërore.

Përvojat e njerëzve gjatë 25 viteve sa sundoi Stalini kanë shpalosur, në vazhdimësi, natyrën krejtësisht të pamëshirshme të sistemit komunist. Vrasjet, masakrat e torturat nuk kishin të ndalur. "Projekti komunist" i tij u bë një përvojë e plotë e mjerimit për publikun; me miliona vdiqën nga uria e mjerimi, fshatarët u përdorën për punë të detyruar dhe njerëzit u shtypën rreptësisht. Ndërkohë, të gjitha format e praktikave religjioze u nxorrën jashtë ligjit.



Gjatë sundimit të liderit komunist Lenin, dhjetëra mijëra njerëz të pafajshëm vdiqën nga uria. Kriza e urisë që qe përhapur në kohën e Leninit e të Stalinit ndodhi thjeshtë për shkak se burimet për ushqimin e publikut ishin shpenzuar për qëllime ideologjike.



Victim of Lenin's famine

Stalini filloi me konfiskimin e fushave të fshatarëve, që përfshinin një total prej 80% të tërë popullsisë ruse. Si pjesë e politikës së nacionalizimit, zyrtarët mblodhën tërë prodhimin e fshatarëve, duke shkaktuar krizë urie për miliona gra, fëmijë e pleq. Vetëm, në Kazakistan, 20% e popullsisë vdiq nga uria. Në Kaukaz, shkalla e vdekshmërisë u ngrit në më shumë se një million.

Mijëra njerëz që tentuan t'i rezistonin këtyre politikave, u internuan në kampe pune në Siberi. Në këto kampe, ku forca punëtore ishte mjaft e rëndë, shumica e robërve nuk i ikën vdekjes. Mijëra njerëz u ekzekutuan nga policia sekrete e Stalinit. Emigrimi i dhunshëm u bë pjesë e politikës së Stalinit; miliona njerëz u zhvendosën, duke lënë vendlindjet e tyre dhe duke u dërguar në pjesë të largëta të Rusisë.

Stalini ishte përgjegjës për së paku 20 milionë vdekje në tërë Rusinë. Nga ajo që tregojnë historianët, Stalini nxirrte kënaqësi nga një brutalitet i tillë, dhe në zyrën e tij në Kremlin, kënaqej shumë duke ekzaminuar raportet e shkallës së vdekjeve që vinin nga kampet e punës.

Terrori në kohën e Stalinit nuk drejtohej vetëm ndaj atyre që ngrinin zërin kundër sistemit ose ndaj intelektualëve. Nën sulmet e militantëve komunistë, secili ishte i kërcënuar.



Stalini ishte përgjegjës për së paku njëzet million vdekje në tërë Rusinë. Për sa tregon historia, ai nxirrte kënaqësi nga një brutalitet i tillë, dhe në zyrat e Kremlinit, kënaqej shumë duke shikuar raportet e shkallës së vdekjeve që arrinin nga kampet e punës. Terrori në kohën e Stalinit nuk drejtohej vetëm në ata që ngrinin zërin kundër sistemit ose intelektualët. Nën sulmet e militantëve komunistë, secili ishte nën kërcënim.

Pa ndonjë kriter, masat e njerëzve u internuan në “Gulag”, një rrjet i kampeve për punë të detyruar, ku shumë njerëz u ekzekutuan. Stalini siguroi një pushtet absolut mbi masat e njerëzve përmes terrorit. Të 25 vitet e sundimit të tij diktatorial nuk lanë prapa tjetër, pos njerëzve të varfëruar.

Rusia është një ilustrim i qartë i shoqërive jobesimtare, ku nuk ka gjasa të ekzistojë jeta e gëzuar e me kuptim. Kjo për arsye se, për shkak të natyrës së vet, mosbesimi i udhëheqë njerëzit në kryerjen e të gjitha llojeve të krimeve për dobi personale, përfshirë vrasjen ose madje edhe nënshtrimin e fëmijëve dhunës për shkaqe kënaqësie. Shoqëria e sotme



Në shoqëritë komuniste, pasojat e paevitueshme të mosbesimit janë uria, mjerimi, parregullsitë e dhuna.



ruse sjell dëshmi të efekteve destruktive të sistemit anti-religjioz nga i cili njerëzit vuajtën me dekada. Degjenerimi është trashëgim i këtij sistemi. Ndryshimi i kësaj situate është i mundshëm vetëm përmes mësimit të vlerave të Islamit nga të gjithë njerëzit dhe të ndihmuarit e tyre që të rifitojnë vlerat e tyre shpirtërore.

Shtypja e vazhdueshme e Kinës së Mao-s

Stalini e ktheu në praktikë projektin mbi revolucionin komunist në Rusi, duke lënë prapa 20 milionë të vdekur. Ky regjim i përgjakshëm në Rusi që imituar nga një regjim tjetër komunist, në Kinë.

Pas një lufte civile të përgjakshme, në vitin 1949, nën lidhshpimin e Mao Tse-Tung, komunistët morrën pushtetin në Kinë. Ashtu siç kishte bërë aleati I tij I afërt, Stalini, ndërmyjet viteve 1949 e 1976, edhe Mao vendosi një regjim represiv e të përgjakshëm. Ekzekutime politike të panumërta zunë vend në Kinë. Ushtria përbëhej nga trupa komuniste e grave dhe burrave. Në muajt që pasuan, militantët e rinj të quajtur nga Mao “Rojat e Kuqe” e zhytën vendin në terror.

Shkatërrimi ekonomik në Rusi kishte paralelet e saj në Kinë, duke iu falënderuar parimeve të përkrahura nën emrin “ndryshimet socialiste dhe të drejtat e barabarta”. Skenari i njëjtë u përsërit në Kinë; njerëzit më nuk ishin titullarë të të drejtave të tyre dhe e gjithë pasuria e tyre u konfiskua në të mirë të shtetit. Shkurt, edhe në Kinë, regjimi komunist, që u prezentua si shpëtim dhe shpëtimtar I masave, pushtoi fushat, kafshët, prodhimet dhe pasurinë e njerëzve, ashtu sikurse në Rusi.

Nacionalizimi u prezentua si prerekuzitë e “ndryshimeve socialiste”. “Drejtësia sociale” punoi vetëm sa për të pasuruar njerëzit në pushtet dhe ata që lavdëronin ata. Ndërkohë, publiku, “të drejtat e të cilëve në mënyrë të supozuar ishin mbrojtur” vuante nga uria deri në vdekje. Problemet ekonomie u bënë më të rënda, dhe kërkonin reforma fundamentale. Prap, çdo reformë vetëm shtonte mjerimin dhe çrregullimet sociale në vend. Secili dështim në reformat ekonomike kërkonte mijëra, madje miliona jetë. Në këtë vend të vendosur mbi një zonë të gjerë gjeografike, Mao kreu gjenocid masiv në njerëzit e tij, veçanërisht në minoritetet.

Hierarkia e Partisë Komuniste dhe diktatori i saj Mao, që mbante autoritet absolut në çdo fushë të jetës, mbylli Kinën ndaj të gjitha ndikimeve të jashtme dhe mbajti shtypin dhe komunikimin nën kontroll të rreptë. Çfarëdo kritikizmi ose proteste kundër politikave qeveritare mbaronte me ekzekutime. Autorët, artistët e shkencëtarët që kishin punuar në kulturë, histori e gjuhë të minoriteteve u mblodhën dhe u ekzekutuan nga ky regjim diktatorial. Edhe sot e kësaj dite, bota përfshirë KB-të nuk mund të mblodhin informata të bollshme për incidentet që zunë vend në Kinën e kuqe, siç është rasti i ekzekutimit të turqve Uigurë.

Eliminimi i besimeve fetare është qëllim kryesor i çdo regjimi komunist. Deri më sot, aplikohet politika sistematike e represionit dhe propagandës. Besimet fetare zëvendësohen me filozofitë e zhvilluara nga liderët e idolizuar. Ky poashtu ishte rast në Kinë, një ndër vendet më të mëdha anti-muslimane në Lindjen e Largët. Duke filluar nga koha e Maos, sunduesit në Kinë ndaluan çdo lloj praktike fetare. Imamët u nënshtruan torturave të rënda dhe xhamitë u mbyllën. Religjioni, i konsideruar si pengesa më e madhe për sistemin materialist, u bë temë diskutimi i së cilës u ndalua.

Njerëzit në Kinë ishin indoktrinuar vazhdimisht mbi pagabueshmërinë dhe superioritetin e liderit totalitar. Në shkollë, "Libri I Kuq", në të cilin Mao shpjegon gjerësisht filozofinë e tij bizare, që përfshirë në planprogram. Fëmijët dhe të rinjtë udhëzoheshin në filozofinë materialiste, që prezentonte konceptin e Zotit si një pengesë madhore të zhvillimit njerëzor. Njerëzit inkurajoheshin që të vrisnin njëri tjetrin, madje edhe nënat, nëse kjo ishte në interes të sistemit komunist.



Në përpjekje për të fshehur realitetin e tij të errët, Mao përdori posterë që qartazi e paraqisnin atë si idol.




Gjenerata e re qe indoktrinuar për të qenë armiqësore ndaj kombit, religjionit, kulturës e historisë, që e përbënin një pjesë të politikës shtetërore të marksizmit.



Ideologjia komuniste e sheh konceptin e familjes si diçka kundër qëllimeve të saja. Në këtë kuptim, miliona familje në Kinë u shkatërruan. Për të ashtuqajturin interes të ekonomisë shtetërore, familjet ndaheshin, fëmijët dërgoheshin në jetimore dhe anëtarët e familjeve mund të mblidheshin vetëm një herë në vit.

Këto të gjitha janë çështje të rëndësishme, sepse sot ende komunizmi propagandohet në botë. Fundi i një vendi ku adoptohet komunizmi nuk do të jetë më ndryshe nga fundi i Ruisë ose Kinës. Mënyra e vetme për të mbrojtur vendin nga ky sistem i shënuar nga masakrat, dhuna, uria e johumaniteti, është vetëdijësimi i njerëzve-veçanërisht i të rinjve-për religjionin. Njerëzit jobesimtarë që nuk janë të ndërgjegjshëm për religjionin e vërtetë dhe që për pasojë nuk dijnë për vlerat që sjell religjioni janë të prirur për komunizëm. Kjo është arsyeja se pse materialistët e konsiderojnë religjionin si fuqinë më të rëndësishme dhe më efikase kundër tyre. Shpjegimi i religjionit të pastruar nga çdo formë e fanatizmit si dhe ofrimi i evidencës sa i përket defekteve të filozofisë së komunizmit janë ndër parakushtet që mund të ndërmerren për të mbrojtur kombin prej një shkatërrimi të tillë.



Ekzekutimet masive te kryera nga Kmerët e Kuq në Kamboxha, një vend tjetër komunist, shpalosin natyrën mizore e johumane të komunizmit.

Regjimi komunist i mashtroi masat duke prezentuar komunizmin si “rrugën e vetme për shpëtim”. “Për të arritur qëllimin e komunizmit” ai imponoi torturë johumane të miliona njerëzve. Amnesty International shpesh raporton trajtimin e vazhdueshëm brutal dhe torturën e të ashtuquajturëve “komunitete etnike” e veçanërisht të pakicave muslimane që jetojnë Brenda kufinjve të Kinës. Të burgosurit nuk janë të lejuar të mbrohen dhe vazhdimisht janë të detyruar që të mbajnë kokën në pozitë të ulur. Dihet se muslimanët dënohen me metoda mizore dhe johumane.

Historianët tani orvaten të argumentojnë nëse komunizmi ka vrarë një milionë njerëz në përgjithësi ose “vetëm” tetëdhjetë milionë.

Dëmtimi i sistemeve anti religjioze për njerëzit

1. Të arsyetuarit e bazuar në vlera morale dhe ndërgjegje janë eliminuar dhe shoqëritë janë të shtypura nën regjime totalitare. Në këto regjime, njerëzit nuk kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre fundamentale. Vlerat morale janë refuzuar tërësisht dhe grupet me interes vetjak e dominojnë shoqërinë. Sistemi i mosbesimit nuk lejon asnjë aktivitet që nuk i shërben interesit të sistemit mbizotërues të mosbesimit.

2. Njerëzit janë të indoktrinuar në të besuarit se diktatori është i pagabueshëm dhe se vendimet e tij janë relevante. Në të gjitha regjimet anti religjioze (fashizmi e komunizmi), është e zakonshme praktika e çoroditur e idolizimit të liderit.

3. Liria e të menduarit dhe religjioni janë tërësisht të zvogëluara. Hyrja në xhami, kisha e sinagoga nuk lejohet, dhe komunikimi i religjionit është i ndaluar. Një fond i veçantë është ndarë nga buxheti kombëtar për të luftuar religjionin.²⁰

4. Shteti mban kontrollin e plotë mbi ekonominë. Investimi privat nuk lejohet. Fabrikat, mjetet e prodhimit, pajisjet prodhuese dhe bankat janë nacionalizuar.

5. Ushtarët komunistë konfiskojnë pronën e patundshme. Fushat dhe prodhimet e fshatarëve janë nacionalizuar “ në interes të vendit”

6. Uria dhe mosushqyeshmëria kërkojnë miliona jetë, përfshirë gratë, fëmijët e pleqtë. Sistemi krijoi njerëz të varfër e të dëmtuar, duke i imponuar jetë të rëndë secilit. Në këtë jetë, blerja e një cope bukë, për shembull, nënkupton pritjen me orë në rradhë.

7. Njerëzit internoheshin në kampe pune dhe ekzekutoheshin në masë. Ata që mbesnin shfrytëzohen për punë të dhunshme nën kushte shumë të rënda. Ata që nuk i adaptoheshin kushteve të punës dërgoheshin në ekzil në Siberi.

8. Rebelimet u shuan me gjakderdhje nga militantët komunistë. Kryengritësit vriteshin para syve të publikut.

9. Ata që i kundërviheshin sistemit ose që ofronin kritika, qoftë politikanë ose intelektualë, ekzekutoheshin.

10. Ata që mbanin pushtetin jetonin në ekstravagancë, derisa njerëzit e thjeshtë bënin jetë në mjerim. Për shembull, kur e mbante pushtetin Partia Komuniste, dallimi midis pagës së punëtorit dhe anëtarit të Partisë

Komuniste ishte ndërmjet 25-30 mijë rubla. Pagat e anëtarëve të Partisë Komuniste ishin 25-100 mijë rubla. Shumica e njerëzve kishin pagë prej vetëm 150 rublash. Për më tepër, anëtarët e Partisë Komuniste kishin pallate, vettura dhe qasje në kujdesin shëndetësor pa pagesë. Asnjë nga këto përfitime nuk ishte në dispozicion për publikun puna e të cilëve formoi shtyllën kurrizore të ekonomisë kombëtare.²¹

11. Forcat policore të regjimit shtypës terrorizonin publikun. Publiku jetonte nën frikë të vazhdueshme.

12. Partia Komuniste shndërroi vendin në një rreth të pambarim të konflikteve, trazirave e rrëmujës.

13. Sistemi shtypës e totalitar kishte ndikimin e vet edhe në shkolla. Sipas Leninit, edukimi nuk duhet të jetë objektiv, i ndarë dhe i izoluar nga politika. Në adresimin e tij në Kongresin e Parë të Arsimit Sovjetik, më 25 gusht 1918, ai deklaroi se qëllimi kryesor i arsimit është që të largohet borgjezia. Ai në mënyrë eksplicite deklaroi se nuk ka arsimim jashtë politikës dhe se të pohuarit e së kundërtës është përhapje e gënjeshtreve dhe hipokrizisë.²² Qëllimi i arsimit është që të ngritet pabesimi e që gjeneratat e dobësuara moralisht të vihen në shërbim dhe interes të komunizmit.

Rinisë i qe shpërlarë truri me mosbesim dhe sistemi, në vend të gjeneratave paqësore ngriti një gjeneratë militantësh.

15. Koncepti i familjes qe eliminuar. Foshnjat ndaheshin nga familjet e tyre dhe rriteshin si jetimë. Koncepti i familjes konsiderohej të ishte kundër “interesit të shtetit.” Në takimet e Partisë Komuniste, shpreheshin pikëpamjet si “revolucioni është i dënuar të mbetet i dobët përderisa lidhjet familjare dhe koncepti i familjes të ekzistojë”.²³

16. Në regjimet komuniste arti e shkenca nuk gjetën ambient ku do të lulëzonin. Një pjesë e madhe e buxhetit kombëtar ndahej për armatim, në të shumtën i përdorur për nënshtrim dhe ekzekutim të masave.

17. Rinia nuk pajisej me asnjë qëllim në jetë, që rezultonte në ngritjen e shkallës së vetvrasjeve. Vetë sistemi nxiste adoleshentët në varësi të drogës e alkoolit.

18. Liria e shtypit ishte tërësisht e zvogëluar. Publikimi dhe transmetimi lejohej vetëm, nëse lëvdëroheshin sistemi dhe lideri. Përndryshe, ato heshteshin.

Masakrat nga liderët komunistë



Bolshevikët të udhëhequr nga Leon Trotsky duke shtënë në anëtarët e Armatës së Bardhë (lart). Masakra e njohur si "E diela e përgjakshme" (në mes-majtas). Njerëz të pafajshëm të ekzekutuar gjatë regjimit të Stalinit (në mes-djathtas). Clergy u godit për vdekje gjatë komunës së Parisit. (djathtas)



Mjerimi i njerëzve në vendet komuniste



Në shoqëritë komuniste, jeta e përditshme e njerëzve është plot vështirësi e telashe. Fjala vjen, fëmija në fotografi provon të pijë ujë të ndotur meqë nuk mund të gjejë ujë të pijshëm. Në fotografitë e tjera, shihet qartë mjerimi që sjell mosbesimi.

Konkluzion

*Dhe nuk jemi të obliguar për tjetër, përveç t'ju kumtojmë ashtu qartë.
(Surah Ya Sin: 17)*





Nga uria në varfëri, nga droga te korrupsioni, në këtë libër u morëm me shumë probleme në botë që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. S'ka dyshim, secili është i njohur me këto probleme. Megjithatë, mbetet fakti se shumica e njerëzve kurrë nuk pranon përgjegjësinë për zgjidhjen e ndonjëres prej tyre. Përveç kësaj, ne madje edhe i shmangemi të menduarit për këtë. Disa, në anën tjetër, i kushtojnë mendim serioz këtyre problemeve, ia prezentojnë ato vëmendjes së publikut dhe seriozisht ndjejnë shqetësim shpirtëror ndaj neve që jemi aq jokompetentë për gjetjen e zgjidhjeve.

Dështimi i njerëzimit në gjetjen e zgjidhjeve për një kohë kaq të gjatë, gjendet në ideologjitë me të meta dhe sistemet e besimit ndaj të cilave ne drejtohem. Sidoqoftë, zgjidhja qëndron në të kthyerit nga Kurani e Suneti, rruga të cilën e ka zgjedhur Allahu për njerëzimin. Do të ishte krejtësisht e gabuar që të pranohet status quo-ja me të gjitha defektet e saja, që të heshtim ose të na duket e paarritshme që bota të mund të pastrohët nga tërë këto jopërsosmëri. Allahu, Krijuesi i njeriut, krijoi poashtu

rrugën, të cilën nëse e ndjekim do të ndjehemi të sigurtë dhe në paqë me veten dhe Ai e komunikon këtë sistem te ne përmes Kuranit. Siç thotë Allahu në ajet: **Ne ty të shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët.** (Surja Nahl: 89), Në të gjitha fushat e jetës, Kurani udhëzon njerëzimin për te e vërteta.

Këto gjëra do të marrin fund nëse njerëzit i zbatojnë Kuranin e Sunnah.



Të gjitha problemet e botës sot do të mbarojnë sikur vlerat e Kuranit e të Sunetit, t'i paraqiteshin njerëzimit në formën e tyre origjinale të pastruara nga fanatizmi e risitë.

Një pikë tjetër e rëndësishme që meriton të përmendet është kjo: Allahu i premtun njeriut jetë të bekuar si në këtë ashtu edhe në botën tjetër, dhe ky është sekreti i bindjes ndaj Kuranit. Rrjedhimisht, Kurani do të fshijë të gjitha problemet, dhe Allahu, i Gjithëmëshirshëm ndaj njeriut, do ta shpërblejë atë me jetë të bukur të pastruar nga të gjitha format e shqetësimeve dhe mjerimit në këtë botë:

Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është te All-llahu është e përjetshme. E Ne do t'u japim atyre që ishin të durueshëm shpërblimin më të mirë të asaj që vepruan. Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre. (Surja Nahl: 96-97)

Duke pasur zgjidhjen në vlerat e Kuranit, është përgjegjësi kryesore për besimtarët me ndërgjegje që t'ua komunikojnë Kuranin tërë njerëzimit:

Dhe nuk jemi të aobliguar për tjetër, përveç t'ju kumtojmë ashtu qartë. (Surah Jasin: 17)

Ideja e Gabuar e Evolucionit

*Ai është që krijoi shtatë
qiej palë mbi palë. Në
krijimin e Mëshiruesit
nuk mund të shohësh
ndonjë kontrast, andaj,
drejto shikimin se a sheh
ndonjë çarje?
(Surja Mulk: 3)*





Çdo detaj në këtë univers tregon për një krijim superior. Në kontrast, materializmi, i cili synon të mohojë faktin e krijimit të universit, është asgjë tjetër pos gabim joshkencor.

Kur njëherë darvinizmi të jetë zhvlerësuar, të gjitha teoritë e tjera të bazuara në këtë filozofi do të bëhen të pabaza. Kryesorja ndër to është darvinizmi, do të thotë, teoria e evolucionit. Kjo teori, që pohon se jeta ka filluar rastësisht nga një materje e pajetë, është rrëzuar nga njohja se universi është krijuar nga Allahu. Astrofizikienti amerikan Hugh Ross e shpjegon këtë sa vijon :

Ateizmi, Darvinizmi, dhe virtualisht të gjithë "izmat" që zunë fill në filozofitë e shekujve 18 e 19-të janë ndërtuar mbi supozime, supozime jokorrekte, se universi është i pafund. Veçantitë na kanë sjellë ballë për ballë me shkakun-ose shkaktarin-e matanësisë së universit dhe tërë asaj që ai përmban, përfshirë edhe vetë jetën.²⁴

Është Allahu ai që ka krijuar universin dhe i Cili e dizajnoi atë deri në detajet më të imta. Sëkëndejmë, është e pamundur që të jetë e vërtetë teoria e evolucionit, e cila thotë se qenjet e gjalla nuk janë krijuar nga Allahu, por janë produkte të vetëdijës.

Pa u befatur, kur shikojmë teorinë e evolucionit, shohim se kjo teori është denoncuar nga zbulime shkencore. Dizajni i jetës është jashtëzakonisht kompleks dhe i mrekullueshëm. Për shembull, në botën e pajetë nuk mund të vëzhgojmë se në çfarë dizajni kompleks këto atome janë bashkuar, dhe se sa të jashtëzakonshme janë mekanizmat dhe strukturat si proteinat, enzimet, e qelizat, që janë manifakturuar bashkë më to.



Çarls Darvini

Ky dizajn i jashtëzakonshëm në jetë ka zhvlerësuar darvinizmin në fund të shekullit të 20të.

Në disa nga studimet tona të mëhershme ne kemi shqyrtuar këtë temë në detaje dhe do të vazhdojmë të bëjmë këtë edhe më tutje. Sidoqoftë, ne mendojmë se, marrë parasysh rëndësinë e saj, do të ishte e dobishme të bëjmë një përmbledhje të shkurtër edhe këtu.

Rënja shkencore e darvinizmit

Edhe pse doktrinë që daton që nga Greqia antike, teoria e evolucionit ka shënuar përparim të gjerë në shekullin 19. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën numër një në botën e shkencës ishte libri i Çarls Darvinit i titulluar "*Origjina e Llojeve*" i publikuar në vitin 1859. Në këtë libër, Darvini mohon se llojet e ndryshme të qenjeve të gjalla në botë janë krijuar nga Allahu ndaras nga njëra tjetra. Sipas Darvinit, të gjitha gjallesat kanë një paraardhës të thjeshtë, dhe përmes ndryshimeve të vogla ata janë larmuar përgjatë kohës.

Teoria e Darvinit nuk qe bazuar në asnjë zbulim konkret shkencor; siç pohonte edhe ai i tëri ishte vetëm një "supozim." Për më tepër, siç deklaronte Darvini në një kapitull të gjatë të librit të tij të titulluar "Vështirësitë e teorisë" teoria po dështonte për shkak të shumë pyetjeve kritikuese.

Darvini investoi të gjitha shpresat në zbulimet e reja shkencore, të cilat priste të zgjidhnin "Vështirësitë e teorisë". Sidoqoftë, në kundërshtim me

pritjet e tij, zbulimet shkencore zgjeruan dimensionin e këtyre vështirësive. Mposhtja e darvinizmit kundër shkencës mund të rishikohet nën tri tema bazë:

- 1) nuk ka asnjë mënyrë që teoria të tregojë si u paraqit jeta në tokë.
- 2) nuk ka asnjë zbulim shkencor që tregon se "mekanizmi evolutiv" i propozuar nga teoria ka ndonjë fuqi për të evoluar.
- 3) të dhënat e fosileve provojnë tërësisht të kundërtën e asaj që sygjeron teoria e evolucionit.

Në këtë seksion, ne do të ekzaminojmë në plan të përgjithshëm këto tri pika bazë:

Hapi i parë i pakapërcyeshëm: Origjina e jetës

Teoria e evolucionit parashtron se të gjitha qenjet e gjalla kanë evoluar nga një qelizë e vetme që u shfaq në tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si mundet një qelizë e vetme të gjenerojë miliona lloje gjallesash komplekse dhe, nëse një evoluim i tillë ka ndodhur vërtetë, pse nuk mund të vëzhgohen gjurmët e saj në të dhënat e fosileve, këto janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk mund të përgjigjet. Sidoqoftë, së pari dhe ç'është më kryesore, nga hapi i parë i procesit të supozuar evolutiv duhet të hetohet: si u paraqit "qeliza e parë"?

Teoria e evolucionit mohon krijimin dhe nuk pranon asnjë lloj të intervenimit mbinatyror, duke pohuar se "qeliza e parë" ka origjinë të rastësishme brenda ligjeve të natyrës, pa ndonjë dizajn, plan ose aranzhim. Sipas teorisë, një materje e pajetë duhet të ketë prodhurar qelizën e gjallë, si rezultat i rastësisë. Sidoqoftë, madje edhe me rregullat më të pakundërshtueshme të biologjisë ky është një pohim jokonsistent.

"Jeta vjen nga jeta"

Në librin e tij, Darvini kurrë nuk iu referua origjinës së jetës. Kuptimi primitiv i shkencës në kohën e tij qëndronte në të supozuarit se qenjet e gjalla kishin një strukturë shumë të thjeshtë. Që nga koha e mesjetës, gjenerimi spontan, teori që pohonte se materiet jo të gjalla u bënë bashkë për të krijuar organizma të gjallë, qe pranuar në shkallë të gjerë. Në

përgjithësi besohej se insektet u krijuan nga të mbeturat e ushqimit, dhe minjtë nga gruri. U bënë eksperimente interesante për të dëshmuar këtë teori. Ca grurë qe vënë në një pjesë të ndotur të rrobave, dhe besohej se pas pak kohe aty do të krijohej miu.

Ngjashëm, krimbat që zhvilloheshin në mish supozohej se ishin një evidencë e gjenerimit spontan. Sidoqoftë, vetëm pas një kohe u kuptua se krimbat nuk u paraqitën spontanisht në mish, por se barteshin aty nga mizat, në formë të larvave të padukshme për syrin.

Madje edhe në kohën kur Darvini shkroi *Origjinën e Llojeve*, në botën e shkencës në mënyrë të gjerë qe pranuar besimi se bakterja mund të vinte në ekzistencë nga lënda jo e gjallë.

Sidoqoftë, pesë vjet pas publikimit të librit të Darvinit, zbulimi i Louis Pasteur e hodhi poshtë besimin që themeloi bazën e evolucionit. Pasteur përmbloodhi konkluzionin që arriti pas studimit kohëgjatë dhe pas eksperimenteve: "*Pohimi se materja jo egjallë ka filluar jetën është varrosur në histori dhe kjo është një e mirë.*"²⁵

Për një kohë të gjatë mbrojtësit e teorisë së evolucionit i rezistuan zbulimet e Pasteur. Sidoqoftë, meqë zhvillimi i shkencës shpleksi strukturën komplekse të qelizës së qenjes së gjallë, ideja se jeta mund të jetë krijuar aksidentalisht hasi në rrugë qorre.

Orvatjet jobindëse në shekullin 20

Evolucionisti i parë i cili ngriti temën e origjinës së jetës në shekullin e 20-të ishte biologjisti i njohur rus Alexander Oparin. Me teza të ndryshme që ngriti në vitet 1930, ai provoi të dëshmonte se qeliza e qenjes së gjallë mund të origjinojë nga rastësia. Këto studime, sidoqoftë, u dënuan për dështim, dhe Oparin u desh të bënte pranimin në vijim: "*Fatkeqësisht, origjina e qelizës mbetet pikëpyetje që në të vërtetë paraqet pikën më të errët të teorisë së evolucionit.*"²⁶



**Biologu Frances
Lui Paster**

Evolucionistët, pasues të Oparinit, u orvatën të kryejnë eksperimente për të zgjidhur problemin e origjinës së jetës. Eksperimenti më i njohur nga këto është kryer në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stanley Miller. Duke kombinuar gazet që ai pohonte të kishin ekzistuar në atmosferën primitive të tokës në një eksperiment të kryer, dhe duke i shtuar energji përzierjes, Miller sintetizoi disa molekula organike (amino acide) prezente në strukturën e proteinave.

Mezi kaluan disa vite para se të mirrej vesh se ky eksperiment, që atëbotë u prezentua si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte invalid, sepse atmosfera e përdorur në eksperiment kishte qenë shumë më ndryshe nga kushtet reale tokësore.²⁷

Pas një heshtjeje të gjatë, Miller pranoi se atmosfera mesatare që ai përdori ishte joreale.²⁸

Të gjitha orvatjet e evolucionistëve gjatë shekullit të 20-të shpjegojnë se origjina e jetës përfundoi në dështim. Geokimisti Jeffrey Bada nga Instituti Scripps në San Diego pranon këtë fakt në një shkrim të botuar në magazinën *Earth* në vitin 1998:

Sot kur po lëmë prapa shekullin e njëzetë, ne ende ballafaqohemi me problemin më të madh të pazgjidhur me të cilin hymë në këtë shekull. Si filloi jeta në Tokë?²⁹

Struktura komplekse e jetës

Arsyeja kryesore se pse teoria e evolucionit përfundoi në rrugë aq të madhe qorre lidhur me origjinën e jetës është se madje edhe organizmat e gjalla që mendohen si më të thjeshtat kanë strukturë jashtëzakonisht komplekse. Qeliza e qenjes së gjallë është më komplekse se të gjitha produktet teknologjike të prodhuara nga njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të zhvilluara në botë, qeliza e gjallë nuk mund të prodhohet duke sjellë materjet joorganike së bashku.

Kushtet që kërkohen për formimin e qelizës për nga sasia janë shumë të mëdha që të mund të shpejgohen përmes rastësisë. Probabiliteti i proteinave, blloqet ndërtuese të qelizës, të sintetizuara rastësisht, janë 1 në 10^{950} për një proteinë mesatare të përbërë nga 500 amino acide. Në matematikë,

probabiliteti më i vogël se 1 në 10^{50} praktikisht konsiderohet të jetë i pamundshëm.

Molekula e DNA-së, e cila është e vendosur në nukleus të qelizës dhe e cila pajis me informacion gjenetik, është një bankë e jashtëzakonshme e të dhënave. Është përlogaritur se sikur të shkurheshin informatat e koduara në DNA, ato do të përbënin një bibliotekë gjigante që do të përbëhej nga 900 volume të enciklopedive me nga 500 faqe.


Në këtë pikë lind një dilemë interesante: DNA mund të kopjohet vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimet).

Sintezat e këtyre enzimeve mund të realizohen vetëm nga informatat e koduara në DNA. Meqë të dyja këto procese varen nga njëra tjetra, që të mund të kopjohen ato duhet të ekzistojnë paralelisht. Kjo na sjell deri te skenari se jeta ka filluar nga vetvetja deri në stagnacion. Prof. Leslie Orgel, një evolucioniste me renome nga universiteti në San Diego, Kaliforni, pranoi këtë fakt, në shtator të vitit 1994, në botimin e magazinës *Scientific American*:

Është jashtëzakonisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, që të dyja komplekse, të shkaktohen spontanisht në të njëtin vend dhe në të njëjtën kohë. Poashtu duket e pamundshme që të kemi njëjërën pa e pasur tjetrën. Edhe kështu, në shikim të parë, mund të konkludojmë se jeta kurrë nuk do të mund të ketë filluar nga mjete kimike.³⁰

Pa dyshim, nëse për jetën është e pamundshme që të ketë filluar nga shkaqe natyrore atëherë duhet të pranohet

I gjithë informacioni për gjallesat është i ruajtur në molekulën e ADN-së. Kjo mënyrë tejet efikase e ruajtjes së informacionit vetvetiu është një dëshmi e qartë se jeta nuk u krijua rastësisht, por u projektua në mënyrë të qëllimshme, apo, më mirë të themi, u krijua në mënyrë të mrekullueshme.





se jeta është "krijuar" në një rrugë supernatyrore. Ky fakt qartazi e bën të pavlefshme teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është që të mohojë krijimin.

Mekanizmi joreal i evolucionit

Pika e dytë e rëndësishme që mohon teorinë e Darvinit është se, në realitet është kuptuar se, të dy konceptet e ngritura nga teoria si "mekanizma evolutive, nuk kanë fuqi evolutive.

Darvini i bazoi thënjet e tij evolutive tërësisht në mekanizmin e "selektimit natyror". Rëndësia që ai i dha këtij mekanizmi ishte evidente në emrin e librit të tij: *Origjina e llojeve*, sipas mjeteve të selektimit natyror...

Selektimi natyror mbështet teorinë se gjërat e gjalla që janë më të forta e më të përshtatshme ndaj kushteve natyrore të mjedisit do të mbijetojnë në luftën për jetë. Për shembull, në tufën e drerëve që kërcënohen nga sulmi i kafshëve të egra, shpëtojnë ato që mund të vrapojnë më shpejt. Sëkëndejmi, dreri do të tejkalohet nga kafshë më të shpejta e të fuqishme se ai. Padiskutueshëm, ky mekanizëm nuk do të ndikojë që dreri të evoluojë dhe transformojë veten në një lloj tjetër gjallesë, fjala vjen në kalë.

Kështu, mekanizmi i selektimit natyror nuk ka fuqi evolutive. Darvini ishte poashtu i ndërgjegjshëm për këtë fakt dhe u desh ta thoshte këtë në librin e tij *Origjina e llojeve*:

Selektimi natyror nuk mund të bëjë asgjë derisa të mos paraqiten shansat për ndryshime të favorshme.³¹

Ndikimi i Lamarkut

Pra, si mund të paraqiten këto "ndryshime të favorshme"? Darvini u orvat të përgjigjej në këtë pyetje nga pikëvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së



Lamarck

kohës së tij. Sipas biologut francez Lamarck, i cili jetoi para Darvinit, krijesat e gjalla i bartën tiparet që ata fituan gjatë jetës së tyre deri te gjenerata e re dhe këto tipare, duke u akumuluar nga një gjeneratë te tjetra, ndikuan që të formohen lloje të reja. Për shembull, sipas Lamarkut zhirafat evoluuan nga antilopat; derisa ato luftonin për të ngrënë mbetjet në drunjt e gjatë, qafat e tyre u zgjatën nga gjenerata në gjeneratë.

Darvini poshtu dha shembuj edhe në librin e tij *Origjina e llojeve*, - për shembull, ai tha se duke shkuar në ujë për të gjetur ushqim, disa arinj me kohë u transformuan në balena.³²

Sidoqftë, ligjet e trashëgimisë, të zbuluara nga Mendel dhe të verifikuara nga shkenca e gjenetikës që lulëzoi në shekullin 20-të, rrëzuan plotësisht legjendën që veçoritë e fituara janë pasuar në gjeneratat vijuese. Kështu, selektimi natyror u hodh poshtë nga të favorizuarit si një mekanizëm evolutiv.



Neo-Darvinizmi dhe mutacionet

Me qëllim të gjetjes së zgjidhjes, në fund të viteve 1930-ta, darvinistët përpuruan “teorinë sintetike moderne, ose siç njihet më shumë, neo-darvinizmin. Si “shkak për ndryshimet e favorshme” që janë shtesë ndaj mutacionit natyror, neo-darvinizmi i konsideroi mutacionet, që janë forma të shtrembëruara të formuara në gjene të qenjeve të gjalla si pasojë e faktorëve të jashtëm, siç është radiacioni ose gabimet e kopjimit..

Sot, modeli i qëndrueshëm për evolucionin në botë është neo-darvinizmi. Teoria pohon se miliona qenje të gjalla, të pranishme në tokë, janë formuar si rezultat i procesit ku një numër i organeve komplekse të këtyre organizmave siç janë veshët, sytë, mushkëritë, dhe krahët, iu janë nënshtruar “mutacioneve”, që është një çrregullim gjenetik. Megjithatë, ka një fakt të plotë shkencor që plotësisht e minon këtë teori: mutacionet nuk bëjnë që qenjet e gjalla të zhvillohen; përkundrazi, ato gjithmonë i dëmtojnë ato.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: DNA-ja ka një strukturë shumë komplekse dhe efektet e rastit mund vetëm t’i shkaktojnë dëme asaj. Gjenetisti amerikan B.G. Ranganathan e shpjegon këtë si në vijim:

Mutacionet janë të vogla, të rastit dhe të dhimbshme. Ato paraqiten rrallë dhe mundësia më e mirë është se ato do të jenë të padobishme. Këto katër karakteristika të mutacioneve lënë të kuptohet se mutacionet nuk mund të dërgojnë në një zhvillim evolutiv. Ndryshimi i rastësishëm në një organizëm të specializuar lartë është ose i padobishëm ose i dhimbshëm.



Mutacionet – çarjet apo zëvendësimet që ndodhin në molekulën e ADN-së – janë rezultat i efekteve të jashtme siç janë rrezatimi apo veprimi kimik. Ky fëmijë Vietnamez që ka pësuar mutacion është viktimë e armës bërthamore.

Ndryshimi i rastësishëm në orë nuk mund të përmirësojë orën. Sipas të gjitha gjasave ndryshimi vetëm do ta dëmtojë atë ose në më të mirën do të jetë i padobishëm. Një tërmet nuk e përmirëson qytetin, por përkundrazi sjell shkatërrim.³³

Deri më tani, nuk është parë asnjë shembull i mutacionit, që është i dobishëm për të zhvilluar kodin gjenetik. Është dëshmuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, që prezentohet si një “mekanizëm evolutiv”, në të vërtetë është një paraqitje gjenetike që dëmton qenjet e gjalla, dhe që i bën ato të paafta. (efekti më i zakonshëm i mutacionit në qenjet njerëzore është kanceri). S’ka dyshim, mekanizmi destruktiv nuk mund të jetë një “mekanizëm evolutiv”. Në anën tjetër, siç pranonte edhe vetë Darvini, selektimi natyror, “nuk mund të bëjë asgjë vetvetiu”. Ky fakt na tregon se në natyrë nuk ka “mekanizëm evolutiv”. Meqë mekanizmi evolutiv nuk ekziston, atëherë nuk mund të zerë vend asnjë proces imagjinar I quajtur evolucion.

Të dhënat e fosileve: asnjë shenjë e formave ndërmjetëse

Prova më e qartë se skenari i cili sygjerohet nga teoria e evolucionit nuk ka ndodhur, janë të dhënat mbi fosilet.

Sipas teorisë së evolucionit, secili lloj gjallese ka ndonjë të ngjarë me paraardhësit. Llojet që kanë ekzistuar më herët, janë shndërruar në diçka tjetër dhe me kohë të gjitha llojet kanë evoluuar në këtë mënyrë. Sipas teorisë, ky transformim është zhvilluar gradualisht për miliona vjet.

Sikur kjo të ishte e saktë, atëherë gjatë kësaj periudhe të gjatë të transformimit do të kishin ekzistuar lloje të shumta ndërmjetësuese.

Fjala vjen, në të kaluatën do të duhej të kishin jetuar disa gjysmë-peshqë/gjysmë-reptilë, të cilët do të kishin disa veçori të reptilëve, si shtesë ndaj veçorive të peshqve që tashmë i kishin. Ose do të kishin ekzistuar disa reptilë-zogj, të cilët do të kishin marrë disa veçori të zogjve, si shtesë ndaj veçorive të reptilëve të cilat tashmë i kishin. Meqë kjo do të duhej të ndodhte në fazën e transformimit, ato do ishin qenje të paafta, me të meta, e të gjymta. Këtyre krijesave të imagjinuara, për të cilat besohet



**Fosili i pilivesës i vjetër
150-200 milionë vjet
(Jurasik – periudha e
vonshme) nuk ndryshon
nga mostrat që jetojnë sot.**

të kenë jetuar në të kaluarën, evolucionistët i referohen si “forma kalimtare”.

Sikur kafshë të tilla të kishin ekzistuar vërtetë, atëherë do të kishte miliona, madje edhe miliarda sosh, si për nga numri ashtu edhe për nag llojlojshmëria. Ajo që është me rëndësi është se të mbeturat e këtyre krijesave të çuditshme do të ishin prezente në të dhënat e fosileve. Në “Origjina e llojeve”, Darwin ka sqaruar:

Nëse teoria ime është e vërtetë, duhet me siguri të kenë jetuar llojet e panumërta ndërmjetëse, që do të afronin sipas të gjitha gjasave të gjitha llojet e një grupi së bashku, ...si rrjedhojë, evidenca për ish ekzistimin e tyre mund të gjendet vetëm ndër të mbeturat e fosileve.³⁴

Shpresat e Darvinit shkatërrohen

Sidoqoftë, edhe pse evolucionistët, në tërë botën, kanë bërë orvatje të fuqishme për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit 19, ende nuk janë gjetur forma transformuese. Të gjitha fosilet e nxjerra nga gërmimet kanë treguar se, në kundërshtim me pritjet e evolucionistëve, jeta në tokë është paraqitur papritmas dhe në tërësi është e formuar.

Edhe pse evolucionist, panteologjist i njohur britanik, Derek V. Ager, e pranon këtë fakt:



Teoria e evolucionit pohon se gjallesat evoluon gradualisht njëra prej tjetrës. Të dhënat fosile, megjithatë, e përgënjeshtrojnë këtë pohim në mënyrë të qartë. Për shembull, në Periudhën Kambriane, diku rreth 550 milion vite më parë, dhjetëra gjallesa krejtësisht të veçanta u shfaqën papritur. Këto gjallesa të vizatuara në fotografitë më lartë kanë struktura shumë të ndërlikuara. Ky fakt, të cilit në literaturën shkencore i referohet si “Shpërthimi i Kambrianit”, është dëshmi e kulluar e krijimit.

Argumentet tregojnë se nëse ekzaminojmë në detaje të dhënat e fosileve, si në nivelin e gjendjes fizike ose të llojit, gjejmë — sërish e sërish — jo një evolucion gradual, por një eksplodim të papritur të një grupi në llogari të tjetrit.³⁵

Kjo do të thotë se bazuar në të dhënat e fosileve, të gjitha llojet u shfaqën papritmas si të formuara tërësisht, pa asnjë formë ndërmjetësuese në ndërkohë. Kjo është e kundërta e supozimit të Darvinit. Pokështu, është një evidencë e fortë se qenjet njerëzore janë krijuar. Shpjegimi i vetëm i shfaqjes së papritur e të kompletuar të çdo detaji të qenjeve të gjalla, pa ndonjë paraardhës evolutiv, është se këto qenje janë krijuar. Ky fakt është pranuar poashtu gjerësisht nga biologo- evolucionisti i njohur Douglas Futuyma:

Krijimi i evolucionit, i jap fund shpjegimit të mundshëm për origjinën e gjërave të gjalla. Organizmat janë shfaqur në tokë ose të formuara tërësisht ose jo. Nëse jo, ato duhet të jenë zhvilluar nga llojë paraekzistuese, si rezultat i një procesi të modifikimit. Nëse janë shfaqur në një gjendje të zhvilluar tërësisht, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga një inteligjencë e gjithëfuqishme.³⁶

Fosilet tregojnë se qenjet e gjalla u shfaqën tërësisht të zhvilluara dhe në formë të përkryer në tokë. Kjo do të thotë se "Origjina e llojeve", në kundërshtim me supozimet e Darvinit, është jo evoluim por krijim.

Tregimi për evoluimin njerëzor

Tema që më së shpeshti ngritet nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është origjina e njeriut. Darwinistët thonë se njeriu modern I së sotmes ka evoluar nga një lloj krijese- majmuni. Gjatë këtij procesi të supozuar evolutiv, që supozohet të ketë filluar 4-5 milionë vite më parë, thuhet se ndërmjet njerëzve modernë dhe paraardhësve të tij kanë ekzistuar disa "forma tranzicionale". Sipas këtij skenari tërësisht të imagjinuar, janë renditur katër "kategori" elementare:

1. Australopithecus
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens



Paraqitjet e trilluara të qenieve primitive njerëzore shpesh përdoren në tregimet e sjellura nga gazetatat dhe revistat që janë pro evolucionit. I vetmi burim për këto tregime, të bazuara në paraqitjet e trilluara, janë imagjinatat e autorëve të tyre. Prapseprap evolucionit ka pësuar disfatë të tillë përballë fakteve shkencore sa që gjithnjë e më pak raporte në lidhje me evolucionin tani paraqiten në revistat shkencore.

Evolucionistët e quajnë të ashtuquajturin lloj majmuni Australopithecus që do të thotë “majmuni nga Afrika e Jugut”, si paraardhës të parë të njeriut. Këto qenje të gjalla nuk janë asgjë më shumë se një lloj i vjetër i majmunëve të zhdukur. Hulumentimi i gjerë që është bërë në mostrat e ndryshme të Australopithecus nga dy anatomistët e njohur botërorë nga Anglia e Amerika, Lordi Solly Zuckerman e Prof. Charles Oxnard, kanë treguar se ata i kanë takuar një lloji të zakonshëm të llojit të majmunit që është zhdukur dhe se nuk kanë ndonjë gjasim me njerëzit.³⁷

Evolucionistët e klasifikojnë shkallën tjetër të evoluimit njerëzor si “homo”, që do të thotë “njeri”. Sipas pohimeve të evolucionistëve, qenjet e gjalla në seritë Homo janë më të zhvilluara se sa Australopithecus. Evolucionistët sajojnë një shemë të evolucionit imagjinar duke aranzhuar fosile të ndryshme të këtyre krijesave në renditje të veçantë. Kjo shemë është imagjinare sepse kurrë nuk është dëshmuar se ka një lidhje evolutive ndërmjet klasave të ndryshme. Ernst Mayr, një ndër mbrojtësit

më të njohur të teorisë së evolucionit gjatë shekullit të 20-të, e pranon këtë fakt duke thënë se "zinxhiri që mbërrin deri te Homo sapiens në të vërtetë është i humbur."³⁸

Duke skicuar zinxhirin lidhës si "Australopithecus > Homo habilis > Homo erectus > Homo sapiens", evolucionistët lënë të kuptohet se secila nga këto lloje është paraardhës i njëri tjetrit. Sidoqftë, zbulimet e vona të paleoantropologjistëve kanë shpalosur se Australopithecus, Homo habilis dhe Homo erectus kanë jetuar në pjesë të ndryshme të botës në të njëjtën kohë.³⁹

Për më tepër, një segment i caktuar i njerëzorëve të klasifikuar si Homo erectus ka jetuar deri në kohët moderne. Homo sapiens neandartali dhe Homo sapiens sapiens (njeriu modern) bashkëjetuan në rajonin e njëjtë.⁴⁰

Situata indikon dukshëm pavlefshëmrinë e pohimit se ata janë paraardhës të njëri tjetrit. Paleontologjisti nga univeristeti i Harvardit, Stephen Jay Gould, shpjegon këtë bllokim të teorisë së evolucionit edhe pse ai vetë është një evolucionist:

Çka bëhet nga prejardhja jonë nëse nga tri prejardhje hominidësh që bashkëjetuan (A. afrikanusi, australopithecines I fortë, dhe H. habilis), asnjëri qartas nuk rrjedh nga njëri tjetri? Për më tepër, asnjë nga këta të tre nuk paraqet ndonjë trend evolutiv gjatë kohëzgjatjes së tyre në tokë.⁴¹

Thënë shkurt, skenari i evoluimit njerëzor, që synon të mbështesë pohimin mbi krijesat e ndryshme "gjysmë majmun, gjysmë njeri", që paraqiten në media e libra kursesh, nga mjetet e propagandës, nuk është asgjë tjetër përveçse rrëfim pa bazë shkencore.

Lordi Solly Zuckerman, një ndër shkenctarët më të njohur e të respektuar në Britani të Madhe, i cili me vite kreu hulumtime në këtë temë, e veçanërisht studjoi fosilet e Australopithecus për 15 vjet, më në fund konkludoi, përkundër të qenit edhe vetë një evolucionist, se në fakt nuk ka ndonjë dru familjar që zgjerohet nga krijesat e ngjashme me majmunin në njeri.

Zuckerman bëri poashtu një "spektër interesant të shkencës". Ai formoi një spektër shkencash duke i radhitur ato sipas atyre që i

konsideronte shkencore e deri te ato që i konsideronte jo shkencore. Sipas spektrit të Zuckermanit, “më shkencoret”-do të thotë, ato që vare nga të dhëna konkrete të shkencës, janë kimia e fizika. Pas tyre vijnë shkencat biologjike e pastaj shkencat sociale. Në fundin e largët të spektrit, që konsiderohet të jetë pjesa më “joshkencore”, janë “përceptimet ekstra shqisore”-konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe përfundimisht “evoulimi njerëzor”. Zuckerman shpjegon arsyetimin e tij:

Kur ne i devijojmë regjistrin të së vërtetës objektive në fushat e supozuara të shkencës biologjike, siç është përceptimi ekstra shqisor ose interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku ndër evolucionistët çdo gjë është e mundur –besimtarët e flaktë (në evolucion) nganjëherë janë të gatshëm që të besojnë në të njëjtën kohë në disa gjëra kontradiktore.⁴²

Rrëfimi për evolucionin njerëzor reduktohet në asgjë por ka interpretime të paragjykuara të disa fosileve të nxjerra nga njerëz të caktuar, që verbërisht zbatojnë teorinë e tyre.

Teknologjia në sy e vesh


Një temë tjetër që mbetet pa përgjegje nga teoria e evolucionit është kualiteti i shkëlqyeshëm i përceptimit në sy e veshë.

Para se të kalojmë në temën e syrit, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes “si shohim”. Rrezet e lehta që vijnë nga një objekt bijnë në kontrast në retinën e syrit. Këtu, këto rreze të lehta transmetohen nga qelizat në sinjale elektrike dhe ato arrijnë një pikë të imtë në pjesën e prapme të trurit e cila quhet qendra e të shikuarit. Pas një serie procesesh këto sinjale elektrike përceptohen në këtë qendër të trurit si një imazh. Le të bëjmë diçka me këtë prapavijë teknike.

Truri është i izoluar nga drita. Kjo do të thotë që brendia e trurit është një errësirë solide, dhe drita nuk arrin lokacionin ku është i vendosur truri. Pjesa që quhet qendra e të shikuarit është një vend me një errësirë solide ku nuk arrin kurrë asnjë dritë; madje kjo mund të jetë pjesa më e errët që keni njohur ndonjëherë. Sidoqoftë, në këtë errësirë të pastër ju vëzhgoni një botë të shkëlqyer, të ndritshme.

Imazhi që formësohet në sy është aq i fortë dhe i dallueshëm sa që edhe teknologjia e shekullit të 20-të nuk ka qenë e aftë për ta arritur. Fjala vjen, shikojeni librin që e lexoni, duart me të cilat e mbani, pastaj ngriteni kokën e shikoni përreth jush. A keni parë në ndonjë vend tjetër ndonjëherë një imazh aq të fortë e të dalluar si ky? Madje edhe ekrani më i zhvilluar televiziv, i prodhura nga prodhuesi më i madh televiziv në botë, nuk mund të ofrojë një imazh aq të fortë për ju. Ky është një imazh tre dimensional, në ngjyra dhe imazh mjaft i fortë. Për më shumë se 100 vjet, mijëra inxhinjerë janë orvatur të arrijnë këtë mprehtësi. Fabrika, mjete gjigante janë krijuar, është bërë shumë hulumtim, janë bërë plane e dizajne për këtë qëllim. Sërish, shikoni në ekranin televiziv dhe në librin që mbani në duar. Do të shihni se ka një dallim të madh në mprehtësi e shkëlqim. Për më tepër, ekrani televiziv tregon një imazh dy dimensional, përderisa me sytë tuaj ju shihni një perspektivë me intensitet tre dimensionalësh.

Për shumë vite, dhjetëra mijëra inxhinjerë janë orvatur të bëjnë një televizion tredimensionalë, dhe të arrijnë kualitetin e të parit të syrit. Ata kanë bërë një sistem tre dimensional të televizionit, por nuk është e mundur që ai të shihet pa i vënë syzet; për më tepër është vetëm një dimension artificial tre dimensionalë. Prapavija është mjegulluar, kurse në plan të parë



Krahasuar me kamerat dhe makinat që regjistrojnë zërin, syri dhe veshi janë shumë më kompleks, shumë më të suksesshëm dhe posedojnë projekte shumë më superiore në raport me këto produkte të teknologjisë së avancuar.


duket sikur suazë letre. Kurrë nuk ka qenë e mundur të prodhohet një vizion i mprehtë e i dalluar si i syrit. Si në kamerë ashtu edhe në televizion, ka një humbje të kualitetit të imazhit.

Evolucionistët thonë se mekanizmi që prodhon këtë mprehtësi e dallueshmëri është formuar në saje të rastësisë. Tani, çfarë do të mendonit ju sikur dikush t'ju thotë se televizioni në dhomat tuaja është krijuar si rezultat i një rastësie, se të gjitha atomet që e përbëjnë atë rastësisht ka ndodhur që të bëhen bashkë dhe të krijojnë këtë aparat që prodhon imazh? Si mund të bëjnë atomet diçka që s'mund ta bëjnë mijëra njerëz?

Nëse një aparat që mund të prodhon imazhe më primitive se sa syri nuk mund të jetë krijuar rastësisht, atëherë është mjaft evidente se syri dhe imazhi I parë përmes syrit nuk është e mundur të jetë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i mbledh të gjithë zërat e disponueshëm nga të dëgjuarit dhe i drejton ato në veshin e mesëm; veshi i mesëm i transmeton vibracionet e zërit duke i intensifikuar ato; ndërkohë që veshi i brendshëm i dërgon këto vibracione në tru duke i përkthyer ato në sinjale elektrike. Ashtu sikur edhe me syrin, akti i të dëgjuarit finalizohet në qendrën e të dëgjuarit në tru.

Situata në sy është e vërtetë edhe për vesh. Kjo do të thotë, që truri është i izoluar nga zëri sikurse edhe nga drita: nuk lejon asnjë zë brenda. Prandaj, pavarësisht se sa zhurmshëm është jashtë, brendësia e trurit është krejtësisht e qetë. Pa marrë parasysh, në tru përceptohen zërat e mprehtë. Në trurin tuaj, i cili është i izoluar nga zëri, ju dëgjoni foninë e një orkestre, e dëgjoni të gjithë zërat e një vendi me turmë. Sidoqoftë, sikur në atë moment shkalla e zërit në trurin tuaj të jetë matur nga një aparat i saktë, do të shihej se aty është duke mbretëruar një qetësi absolute.

Ashtu siç ishte rasti me imagjinaren, për të provuar dhe riprodhuar zërin që është i besuar të jetë sikur origjinali janë bërë orvatje me dekada të tëra. Rezultat i këtyre orvatjeve janë regjistrat e zërit, sistemet me transmetim të lartë (Hi-Fi), dhe sistemet për dëgjimin e zërit. Përkundër tërë kësaj teknologjie dhe mijëra inxhinjerëve e ekspertëve që kanë punuar në këtë përpjekje, nuk është fituar asnjë zë që kishte të njëjtën



Dikush që shikon një fokë e përfytyron atë në trurin e tij. Ngjashëm, në trurin e tij ai hulumton dhe studion tiparet e kësaj krijese që ai sheh në trurin e tij. Gjërat që ai mëson ia zbulojnë atij përsosmërinë e krijimit të Zotit dhe superioritetin e urtësisë dhe dijenisë së Tij.

mprehtësi e qartësi sikur zërat e përceptuar nga veshi. Mendoni për sistemet e kualitetit më të lartë HI-FI të prodhuara nga kompania më e madhe në industrinë e muzikës. Madje edhe në këto aparate, kur inçizohet zëri, një pjesë e tij humbet; ose kur e lëshoni në HI-FI, para se të fillojë muzika gjithmonë dëgjohet një zë fishkëllues. Sidoqoftë, zërat që janë produkt i teknologjisë së trupit njerëzor janë jashtëzakonisht të mprehta e të qarta. Veshi njerëzor kurrë nuk e përcepton zërin të shoqëruar nga zëra fishkëllues ose zërin atmosferikë siç bën HI-FI; ai e përcepton zërin ashtu siç është, të mprehtë e të qartë. Kështu ka qenë që kur është krijuar njeriu.

Deri më tani, asnjë aparat vizuel ose inçizues i prodhuar nga njeriu nuk ka qenë më i ndjeshëm e i suksesshëm në përceptimin e të dhënave ndijore, si syri e veshi.

Sidoqoftë, sa i përket të dëgjuarit e të shikuarit, një fakt shumë më i madh qëndron matanë tyre.

Kujt i përket ndërgjegjia që sheh e dëgjon Brenda trurit?

Kush ai që shikon një botë joshëse në trurin e vet, që dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve, dhe nuhatë trëndafilin?

Stimulimi vjen nga sytë, veshët, dhe hunda e qenjes njerëzore të cilët udhëtojnë në tru si impulse nervore elektro-kemikale. Në librat e biologjisë, psikologjisë, e të biokimisë, ju mund të gjeni shumë detaje lidhur me atë se si formohen këto imazhe në tru. Sidoqoftë, ju kurrë nuk do të hasni në faktet më të rëndësishme lidhur me këtë temë: kush është ai që i përcepton këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, zëra, aroma dhe ngjarje ndijore në tru? Ka një ndërgjegje në tru që i përcepton këto pa pasur nevojën për sy, veshë e hundë. Kujt i përket kjo ndërgjegje? S ka dyshim se kjo ndërgjegje nuk i takon nervave, shtresës së trashë dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse materialistët darvinistë, që besojnë se çdo gjë është përbërë nga rasti, nuk mund të japin asnjë përgjigje në këto pyetje.

Prandaj ndërgjegjia është shpirti i krijuar nga Allahu. Shpirtit nuk i duhet as syri për të parë imazhet, e as veshi për të dëgjuar zërat. Për më tepër, trurit nuk i nevojitet as të menduarit.

Secili që lexon këtë fakt eksplot e shkencor duhet të mendoj për Allahun e Plotëfuqishëm, duhet t'i frikësohet e të kërkojë shpëtim te Ai, Ai që ngjesh tërë universin si një errësirë pis të zezë në disa centimetra kub në formë tre dimensionale, të ngjyrosur, e të shkëlqyer.

Besimi materialist

Informata që kemi prezentuar deri më tani na tregojnë se teoria e evolucionit është pretendim i evidentuar në mospërputhje me zbulimet shkencore. Pretendimi i teorisë mbi origjinën e jetës është në papajtueshmëri me shkencën, mekanizmi evolutiv që propozon nuk ka fuqi evolutive, dhe fosilet demonstrojnë se format ndërmjetësuese që kërkohen nga teoria nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, kjo me siguri përcjell se teoria e evolucionit duhet të lihet anash si një ide joshkencore. Kjo tregon se si shumë ide, siç është modeli i universit me qendër në tokë është nxjerrë jashtë nga agjenda e shkencës përgjatë historisë.

Siqodoftë, teoria e evolucionit është mbajtur me këmbëngulje në agjendën e shkencës. Disa njerëz madje provojnë që të paraqesin kritikën e drejtuar kundër teorisë si një "sulm ndaj shkencës". Pse?

Arsyeja është se teoria e evolucionit është një besim-dogmë e detyrueshme për disa qarqe. Këto qarqe janë verbërisht të përkushtuara ndaj filozofisë materialiste dhe kanë adoptuar darvinizmin sepse është shpjegimi i vetëm materialist që mund të çojë përpara punët e natyrës.

Është mjaft interesante, se ata rrëfejnë këtë fakt nga koha në kohë. Gjenetisti i njohur dhe evolucionisti i sinqertë, Richard C. Lewontin nga Universiteti i Harvardit, rrëfen se ai është "së pari materialist i shquar e pastaj shkencëtar":

Nuk është se metodat dhe institucionet e shkencës na detyrojnë për të pranuar një shpjegim material të fenomenit botëror, por, në të kundërtën, ne jemi të detyruar që të ndjekim a priori shkaqet materiale për të krijuar një aparaturë të hetimit dhe një seri konceptesh që prodhojnë shpjegime materiale, pa marrë parasysh se sa janë ato në kundërshtim me intuitën, pavarësisht se sa janë ato të mistershme ndaj të painicuarës. Për më tepër, materializmi është absolut, prandaj ne mund të lejojmë Dorën Hyjnore në derë.⁴³

Kjo është një deklaratë eksplicite se darvinizmi është një dogmë që mbahet në jetë vetëm për hir të ndjekjes së filozofisë materialiste. Kjo dogmë pohon se s ka qenje që mbron çështjen.. Prandaj, kjo tregon se si gjoja një shkas i pajetë, i pandërgjegjshëm e ka krijuar jetën. Insiston se miliona lloje të ndryshme që jetojnë: për shembull, zogjtë, peshqit, zhirafat, tigrat, insektet, drunjtë, lulet, balenat e qenjet njerëzore rrjedhin si rezultat i një interaksioni ndërmjet lëndëve siç janë shiu që bie, vetëtimja, etj., jashtë arsyes së pajetë. Ky përceptim është në kundërshtim me arsyen dhe shkencën. Sërish darvinizmi vazhdon ta mbrojë atë "për të mos lejuar Dorën Hyjnore Divine në derë."

Kushdo që nuk shikon me paragjykime materialiste në origjinën e qenjeve jetësore, do të shohë këtë të vërtetë evidente: të gjitha qenjet që jetojnë janë punë e Krijuesit, i Cili është i Plotëfuqishëm, i gjithëditur dhe i gjithëinformuar. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë universin nga asgjëja, të dizajnuar në mënyrën më të përsosur dhe i dha formë të gjitha qenjeve të gjalla.

SHËNIME

1. Muslim Vol. 4 Hadith 6309
2. Muslim Vol. 3 Hadith 4264
3. UNESCO the COURIER, mars 1999, p.22
4. The Economist, 8 shkurt 1997,
5. <http://www.uia.org/uiademo/pro/ d5980.htm>
6. <http://www.uia.org/uiademo/pro/ d4966.htm>
7. Ramuz al-Hadith, vol 1, p. 17, Salman al-Farisi (ra)
8. Time, prill 15, 1996, p.36-39
9. Time, prill 15, 1996, p.36-39
10. Nando Times, 1 korrik 1998
11. Philip Johnson, Darwin në gjyq, 2.b. Illinois: Intervarsity Press, 1993, f. 126
12. At-Tirmidhi, raportuar nga Abu'd-Darda
13. <http://www.nida.nih.gov/Infobox/costs.html>
14. http://www.thewinds.org/arc_editorials/government/world_crisis08-98.html
15. http://www.thewinds.org/arc_editorials/government/world_crisis08-98.html
16. Carlls Darwin, Prejardhja e njeriut, botimi i dytë, New York, A L. Burt Co., 1874, p. 178
17. Alaeddin Şenel, Irk ve Irkçılık Düşüncesi (Ideja e racës dhe e racizmit), Ankara: Bilim ve Sanat Yayınları, 1993, f.62-6
18. Karl Kohen, Komunizmi, Fashizmi dhe Demokracia, New York: Shtëpia botuese Random, 1972, f.408
19. Sahih Muslim, Libri 32, Numri 6248
20. Ali Bulac, Çağdaş Kavramlar ve Düzenler (Konceptet bashkëkohore dhe rregullat), f.108
21. Mahmud Ahmet, Islam Iktisadi (Ekonomia Islamike), f.80
22. Alija Ali Izetbegovic, Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit, f. 102
23. Ali Bulac, Çağdaş Kavramlar ve Düzenler (Konceptet bashkëkohore dhe rregullat), f.114
24. Hugh Ross, Dora e Zotit, f. 50
25. Sidney Fox, Klaus Dose, Evolucioni molekular dhe origjina e jetës, New York: Marcel Dekker, 1977. f. 2
26. Alexander I. Oparin, Origjina e jetës, (1936) New York, Publikimet Dover, 1953 (Ribotim), f.196
27. "Të dhëna të reja mbi evolucionin e atmosferës së hershme dhe jetës", Buletini i shoqërisë meteorologjike amerikane, vol 63, nëntor 1982, f. 1328-1330.
28. Stanley Miller, Evolucioni molekulari jetës: Statusi aktual i sintezave Sinteza prebiotike e molekulave të vogla, 1986, f. 7
29. Jeffrey Bada, Toka, shkurt 1998, f. 40
30. Leslie E. Orgel, " Origjina e jetës në tokë", Scientific American, Vol 271, tetor 1994, f. 78
31. Charles Darwin, Origjina e llojeve: Faksimil i botimit të parë, Shtypi i Universitetit të Harvardit, 1964, f. 189
32. Charles Darwin, Origjina e llojeve: Faksimil i botimit të parë, Shtypi i Universitetit të Harvardit, 1964, w. 184.
33. B. G. Ranganathan, Origjinat?, Pensilvani: Flamuri i besimit të vërtetë, 1988.
34. Charles Darwin, Origjina e llojeve: Faksimil i botimit të parë, Shtypi i Universitetit të

Harvardit, 1964, f. 179

35. Derek A. Ager, "Natyra e të dhënave të fosileve", Veprimi i shoqatës gjeologjike britanike, vol 87, 1976, f. 133

36. Douglas J. Futuyma, Shkenca në gjykim, Nju Jork: Pantheon Books, 1983. p. 197

37. Solly Zuckerman, Matanë kullës Ajvori, Nju Jork: Botimet Toplinger, 1970, f. 75-94; Charles E. Oxnard, "Vendi i Australopithecinëve në evoluimin njerëzor: bazat për dyshim", Nature, Vol 258, f. 389

38. J. Rennie, "Bulldogu actual i Darvinit: Ernst Mayr", Scientific American, dhjetor 1992

39. Alan Ĕalker, Shkenca, vol. 207, 1980, f. 1103; A. J. Kelso, Antropologjia fizike botimi i parë., Nju Jork: J. B. Lipincott Co., 1970, p. 221; M. D. Leakey, Olduvai Gorge, vol. 3, Kembrixh: Shtypi i Universitetit të Kembrixhit, 1971, f. 272

40. Time, nëntor 1996

41. S. J. Gould, Natural History, vol. 85, 1976, f. 30

42. Solly Zuckerman, Matanë kullës Ajvori, Nju Jork: Botimet Toplinger, 1970, f. 19

43. Richard Leöntin, "Bota e gjuetisë së demonëve", The New York Review of Books, 9 janar, 1997, f. 28

*(engjëjt) Thanë: "Ti je i pa të meta,
ne nuk kemi dije tjetër përveç atë
që na e mësove Ti.*

Vërtetë, Ti je i Gjithëdijshëmi, i Urti!"

(Surja Bekare: 32)